



sondazh i opinionit publik

2019
BESIMI NË QEVERISJE



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Sondazh i opinionit publik

BESIMI në QEVERISJE 2019

Raporti i sondazhit



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



Empowered lives.
Resilient nations.

Sondazh i opinionit publik 2019: Besimi në qeverisje

Raporti i sondazhit

Autorët:

Leonie Vrugtman

Blerjana Bino

Editor:

Gjergji Vurmo

Koordinatorët e punës në terren:

Diori Angjeli, Sheila Hafizi

Përkthimi nga anglishtja:

Durim Tabaku

Design dhe Layout:

Eduart Cani

© 2020 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim.

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)

Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd. 35, H.1 1017

Tiranë, Shqipëri

E-mail: info@idmalbania.org

Web: www.idmalbania.org

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Programit të Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (PNUD) ose të partnerëve të zhvillimit.

Besimi në qeverisje 2019 përmbledhje

Në edicionin e tij të shtatë vjetor, sondazhi i opinionit publik “Besimi në qeverisje” u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2019 në të 61 bashkitë e vendit, duke përdorur një kampion përfaqësimi prej 2,500 të anketuarish të zgjedhur në mënyrë rastësore në rang kombëtar. Gjetjet grupohen në 9 seksione kryesore.



Besimi në institucione

- Institucionet/organizatat ndërkombëtare si **NATO, OKB** dhe **BE** renditen si **institucionet më të besuara** nga pjesa më e madhe e qytetarëve shqiptarë.
- **Institucionet fetare (65.6%) janë institucionet shqiptare më të besuara**, ndjekur nga forcat e armatosura (59.4%), Policia e Shtetit (54.6%), institucionet arsimore (57.3%) dhe sistemi shëndetësor (51.4%).
- Edhe pse **prokuroria dhe gjykatat perceptohen si më pak të besuara, niveli i besimit tek to është rritur këto vitet e fundit.**
- Për pjesën më të madhe të institucioneve, **niveli i besimit është rritur në vitet 2015-2017, por ka rënë në periudhën 2017-2019.**
- Shqiptarët e moshës **mbi 66 vjeç, të punësuarit në sektorin publik** apo të anketuarit me diplomë universitare **shprehin në përgjithësi më shumë besim tek institucionet** krahasuar me grupet e tjera demografike.
- **52.7% e qytetarëve** shqiptarë besojnë se **reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit**, por 31.5% besojnë se reforma në drejtësi nuk po zbatohet siç duhet.
- **Televizioni (57.2%) mbetet burimi mediatik më popullor për marrjen e informacionit për aktualitetin**, veçanërisht tek brezi i të moshuarve. Megjithatë, te grupmoshat e reja dhe te qytetarët me nivel të lartë të ardhurash, mediat sociale dhe portalet e lajmeve janë po aq popullore. Shumica e shqiptarëve shprehin se nuk besojnë që media jep informacion të saktë.



Transparenca dhe llogaridhënia

- **Shumica e qytetarëve shqiptarë e konsiderojnë qeverinë qendrore dhe vendore si jo transparente apo të përgjegjshme.**
- **Gjatë periudhës 2016-2019, rënia e perceptuar në transparencë është me 6 pikë përqindje (p.p.) për qeverinë qendrore dhe me 7 p.p. për njësinë e qeverisjes vendore.**
- **Që nga viti 2017, përqindja e shqiptarëve që e konsiderojnë qeverinë si llogaridhënëse ka rënë me 11 p.p. për qeverisjen vendore dhe 8 p.p. për qeverinë qendrore.**
- **Shumica e shqiptarëve (66.7%) janë të informuar për Ligjin për të Drejtën e Informimit.** Shqiptarët me arsim universitar, të punësuarit në sektorin publik apo ata me të ardhura të larta duket se janë më të informuar për Ligjin për të Drejtën e Informimit.
- **Shqiptarët besojnë se organizatat ndërkombëtare (78.9%) janë më efikase për llogaridhënien ndaj qeverisë në krahasim me institucionet në vend, si Kontrolli i Lartë i Shtetit (63.7%) dhe Parlamenti (53.4%).**
- **Mekanizmat më efektivë të llogaridhënies vertikale, sipas të anketuarve, janë media (58%) dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) (47.8%).**



Korrupsioni në institucionet publike

- Pjesa më e madhe e **qytetarëve shqiptarë e perceptojnë korrupsionin e nivelit të ulët (87.5%) dhe korrupsionin e nivelit të lartë (85.2%) si fenomen të përhapur** ose shumë të përhapur në shoqërinë shqiptare.
- **Gjykatat/gjyqësori, sistemi shëndetësor, prokuroria dhe qeveria** shihen si **institucionet më të korruptuara** nga të anketuarit.
- Shqiptarët janë **skeptikë për ndëshkimin e rasteve të korrupsionit. 6 nga 10 të anketuar nuk kanë besim në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët dhe 7 nga 10 të anketuar nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë.**
- **Në vitin 2019, 15% e shqiptarëve kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit të qeverisë në nivel qendror dhe 25.2% në nivel vendor.**
- Nga **34.8%** e të anketuarve **që morën një shërbim në nivel qendror, 19.1% kanë paguar ryshfet për atë shërbim. Në nivel vendor, nga 64.1%** e të anketuarve që morën një shërbim në 2019, **35.8% kanë paguar ryshfet për marrjen e atij shërbimi.**
- Të anketuarit thanë se **kanë paguar ryshfet, sepse u është kërkuar të japin ryshfet (41.3%),** për të marrë një shërbim më të mirë herës tjetër (31.2%), si mirënjohje për shërbimin e marrë (17.9%) ose sepse “nëse nuk paguan, [zyrtarët] të gënjejnë duke të thënë se nuk mund të më ndihmojnë dot.”



Ndikimi politik

- Për të katërtin vit radhazi, shqiptarët i perceptojnë institucionet fetare si institucionet më pak të ndikuara politikisht: **vetëm 10.3% besojnë se institucionet fetare janë “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht të ndikuara” nga interesat politike.**
- **Prokuroria e Përgjithshme dhe gjykatat shihen si institucionet më pak të pavarura për të tretin vit me radhë.** Plot 60.5% e shqiptarëve besojnë se axhenda e gjykatave ndikohet “shumë” ose “jashtëzakonisht shumë” nga interesat politike, ndërsa 59% e shqiptarëve e konsiderojnë Prokurorinë si “shumë të ndikuar” ose “jashtëzakonisht të ndikuar” nga interesat politike.



Angazhimi qytetar

- **56.5%** e të anketuarve **shprehën interesin për të marrë pjesë në procesin vendimmarrës të institucioneve publike**, veçanërisht ata të grupmoshës 18-35 vjeç (64%), të arsimuarit (67%), dhe ata të punësuar në sektorin publik (71%).
- **Pjesëmarrja në takimet konsultuese mbetet e ulët**, veçanërisht **në nivel qendror (10.7%)**. Në nivel vendor, **24.6%** kanë marrë pjesë në një takim konsultues publik. Arsyeja kryesore për një pjesëmarrje të tillë të ulët ishte mungesa e besimit në procese të tilla.
- Shumica e shqiptarëve besojnë se qytetarët **kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq (68.3%)**.
- Të paktën **6 nga 10** të anketuar besojnë se **dëgjuesat publike vendore janë takime formale** me ndikim të kufizuar në vendimet që merr bashkia dhe se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit për projektligjet nuk merren parasysh.
- **Pjesëmarrja e shqiptarëve në demonstrata, tubime dhe peticione mbetet relativisht e ulët**. Qytetarët nga zonat urbane dhe ata që janë anëtarë të partive politike kanë më shumë gjasa të marrin pjesë në një demonstratë/tubim apo të nënshkruajnë një petition.
- **Qytetarët shqiptarë në përgjithësi kanë dëshirë të angazhohen në punë vullnetare**, veçanërisht të rinjtë apo ata me arsim universitar.
- Pothuajse **1 në 2** shqiptarë **duan të largohen nga Shqipëria**. Shqiptarët me nivel të lartë të ardhurash, me arsim universitar, gratë dhe të papunët kanë më shumë gjasa të largohen nga Shqipëria.



Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

- Sipas të anketuarve, **ofrimi i shërbimeve të domosdoshme publike nuk është në nivelin e kënaqshëm**. Mesatarisht, 41.5% e shqiptarëve e konsiderojnë ofrimin e shërbimeve si të kënaqshëm, ndërkohë që 50.8% e të anketuarve thanë se ofrimi i shërbimeve është i pakënaqshëm.
- Shqiptarët mendojnë se **ofrimi i shërbimeve administrative nuk është i kënaqshëm**: mesatarisht 34.5% e të anketuarve e konsiderojnë ofrimin e shërbimeve si të kënaqshëm. Megjithatë, kur qytetarët morën një shërbim administrativ në 2019, atë ishin përgjithësisht më të kënaqur; 44.1% e përdoruesve kishin mendim pozitiv.
- **71% e shqiptarëve nuk kanë parë përmirësim të cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre.**
- **Shqiptarët me nivel të ardhurash mbi 70,001 lekë janë më shumë të prirur të paraqesin ankesë** kur shërbimet publike nuk përmbushnin pritshmëritë e tyre krahasuar me grupet e tjera demografike.
- **37% e njerëzve që kanë bërë ankesë nëpërmjet platformës shqiperiaqeduam.al në vitin 2019 deklarojnë se ankesa e tyre ishte trajtuar deri në kohën e realizimit të anketimit**, ndërsa për 63% ankesa nuk ishte trajtuar (ende).
- **23.9% e shqiptarëve kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në vitin 2019**, nga të cilët 70% janë “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimin e ofruar.
- **Shumica e shqiptarëve (65%) pohojnë se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme**. Shqetësimet kryesore lidhen me krimin, probleme të kujdesit shëndetësor, padrejtësinë, dhe pasigurinë për vendin e punës.



Performanca e institucioneve publike

- Ashtu si në vitet e kaluara, **shqiptarët e shohin performancën e institucioneve fetare (43.7%) dhe forcat e armatosura (35.7%) kryesisht si pozitive krahasuar me institucionet e tjera.**
- **Performanca e gjykatave (23.6%), e prokurorisë (22.1%), e partive politike (30%) dhe e Parlamentit (21.1%) konsiderohet si më pak pozitive.**
- **Performanca e qeverisë qendrore dhe vendore perceptohet si paksa më e mirë** nga shqiptarët që janë të punësuar në sektorin publik, që kanë arsim universitar, që jetojnë në zonat urbane apo që janë të moshës mbi 65 vjeç.
- Rreth **gjysma e popullsisë në vend është e kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj** në Shqipëri.



Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

- Të anketuarit janë **përherë e më të ndërgjegjësuar se bashkia e tyre ka një faqe interneti**. Për herë të parë këtë vit, më shumë se gjysma e të anketuarve janë të informuar për faqen e internetit të bashkisë së tyre.
- Faqja e internetit e bashkisë përdoret më së shumti për të marrë informacion për aktivitete apo programe në vendbanimin e tyre apo për të parë nëse ofrohen shërbime. **Në tre vitet e fundit, shumica e të anketuarve e vlerësojnë faqen e bashkisë si të saktë, të përditësuar vazhdimisht dhe të pasur me informacione.**
- **71.2%** e shqiptarëve deklarojnë se **janë të informuar për shërbimet online në vend që ofrohen nëpërmjet portalit e-Albania**. Gjithsesi, ka mungesë ndërgjegjësimi mes shqiptarëve të moshuar, veçanërisht atyre mbi 65 vjeç.
- **Shumica e njerëzve që kanë përdorur portalin e-Albania e konsiderojnë atë si funksional dhe të lehtë për t'u përdorur**. Plot **60%** e të anketuarve thanë se **platforma ofron mundësi** të mjaftueshme për të bërë komente apo për të dhënë sugjerime.



Përfshirja gjinore dhe sociale

- **Më shumë burrat sesa gratë besojnë se ka barazi gjinore në Shqipëri.**
- **60.4% e meshkujve të anketuar janë të mendimit se “Në shoqërinë shqiptare ka barazi midis burrave dhe grave”** krahasuar me 48.5% të femrave. Në fakt, më shumë se gjysma (51.9%) e të anketuarve femra nuk ishin dakord ose aspak dakord me këtë pohim.
- **71.1% e të anketuarve meshkuj janë dakord me pohimin “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”,** ndërkohë që 66.4% e të anketuarve femra janë dakord me këtë pohim.
- **70.8% e burrave të anketuar deklarojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave,** ndërsa përqindja e femrave që deklarojnë të njëjtën gjë është 64.3%
- **12.6% e shqiptarëve deklarojnë se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo zyrtar publik në 2019 për shkak të gjinisë, moshës, etnisë, orientimit seksual, paaftësisë fizike apo diçkaje tjetër.** Nga të anketuarit që janë diskriminuar në 2019, shumica e tyre janë trajtuar ndryshe për shkak të moshës (35.6%) apo gjinisë (27.1%).
- Shumica e shqiptarëve (76.5%) thonë se gratë janë po aq ta afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike.
- **6 nga 10 shqiptarë mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë ka një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.**

Lista e tabelave

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe madhësia e kampionit për secilin qark	20
Tabela 2. Grupmoshat	23
Tabela 3. Statusi i punësimit	25
Tabela 4. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	27
Tabela 5: Besimi në institucione në vitet 2015–2019	33
Tabela 6: Ndarja demografike e besimit, shumatore e “ Kam shumë besim” dhe “Kam besim”	41
Tabela 7: Ndarja demografike për reformën në drejtësi	42
Tabela 8: Ndarja demografike për median	43
Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies (2016–2019)	59
Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2019)	60
Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale	61
Tabela 12. Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2017–2019)	65
Tabela 13: Arsytet e pagimit të ryshfetit (2019)	73
Tabela 14: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016–2019)	78
Tabela 15: Ndarja demografike e institucioneve që ndikohen shumë nga interesat politike sipas të anketuarve (2019)	79
Tabela 16: Llojet e takimeve të konsultimi që kanë marrë pjesë të anketuarit në vitin 2019	87
Tabela 17: Arsytet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2019	87
Tabela 18: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2019)	96
Tabela 19: Ndarja demografike e procesit të konsultimit në 2019 – vetëm përgjigjet në kategorinë ‘Po’	97
Tabela 21. Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve administrative 2019	104
Tabela 22. Niveli i kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike (2016–2019)	107
Tabela 23. Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2019)	118
Tabela 24. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike sipas ndarjeve demografike (2019)	120
Tabela 25: Performanca e institucioneve (2017–2019)	126
Tabela 26: Ndarja demografike – performanca e institucioneve publike (2019)	129
Tabela 27: arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (2019)	135
Tabela 28: Diskriminim nga institucioni (2019)	149

Lista e figurave

Figura 1. Përfaqësimi gjinor	22
Figura 2. Përfaqësimi gjeografik	23
Figura 3. Niveli i arsimit të përfunduar	24
Figura 4. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)	26
Figura 5: Besimi në institucione 2019	29
Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2019	35
Figura 7: 'Ndikimi pozitiv' përkundër 'zbatimit me korrektësi' të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit 2016–2019	37
Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin	38
Figura 9: Perceptimi i saktësisë së informacionit të dhënë, sipas burimit më të përdorur mediatik 2019	39
Figura 10: Saktësia e informacionit të dhënë nga mediat 2016–2019	40
Figura 11: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2019	45
Figura 12: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2019	47
Figura 13: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2019	49
Figura 14: Kërkesat për informacion të dërguara (2019)	50
Figura 15: Marrja e informacionit të kërkuar (2019)	50
Figura 16: Bënë kërkesë për informacion dhe morën informacionin e kërkuar 2016–2019	52
Figura 17: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2019	53
Figura 18: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies (2016–2019)	55
Figura 19: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale dhe vertikale (2019)	56
Figure 20: Perceived effectiveness of vertical accountability mechanisms (2019)	58
Figura 21: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2019)	64
Figura 22: Perceptimi i ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit (2019)	66
Figura 23. Përvoja personale me korrupsionin (2019)	68
Figura 24: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor 2015-2019	69
Figura 25. Shërbimet e marra në nivel qendror (2019)	70
Figura 26. Ryshfet i paguar në nivel qendror (2019)	70
Figura 27. Shërbimet e marra në nivel vendor (2019)	71
Figura 28. Ryshfet i paguar në nivel vendor (2019)	71

Figura 29. Përhapja e ryshfetit (2016–2019)	72
Figura 30: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në axhendën e institucioneve (2019)	75
Figura 31: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike (2019)	82
Figura 32: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2019)	83
Figura 33: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2016–2019)	84
Figura 34: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2019)	85
Figura 35: Pjesëmarrja në takime konsultimi (2019)	86
Figura 36: Përdorim i portalit “Konsultimipublik.gov.al” në 2019	88
Figura 37: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2019)	89
Figura 38: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar (2019)	90
Figura 39: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2019	92
Figura 40: Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare (2019)	94
Figura 41: Largimi nga vendbanimi aktual (2019)	94
Figura 42. Kënaqshmëria me shërbimet publike (2019)	102
Figura 43. Cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia (2019)	108
Figura 44. Të anketuarit që kishin paraqitur ankesë tek institucionet (2016–2019)	110
Figura 45. A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’? (2019)	111
Figura 46. A mendoni se institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët? (2019)	113
Figura 47. Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2019	115
Figura 48. Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit me një ndalesë në zyrat e ADISA në 2019	116
Figura 49. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016 –2019)	117
Figura 50: Performanca e institucioneve publike (2019)	123
Figura 51: Kënaqshmëria me ndikimin e donatorëve të huaj në Shqipëri (2019)	127
Figura 52. A ka Bashkia juaj një faqe interneti? (2019)	132
Figura 53: A e dinit se bashkia juaj ka faqe interneti? (2015–2019)	133
Figura 54: Përqindja e të anketuarve që kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë (2019)	134
Figura 55: Cilësia e informacionit në faqen e internetit të bashkisë (2016–2019)	135

Figura 56: Dijenja për portalin e-Albania (2019)	136
Figura 57: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik gjatë vitit 2019 nëpërmjet e-Albania? (2019)	138
Figura 58: Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2019)	139
Figura 59: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2019)	141
Figura 60: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016–2019)	142
Figura 61: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2019)	143
Figura 62: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2016–2019)	144
Figura 63: Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2019)	145
Figura 64: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2016–2019)	146
Figura 65: Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik (2016-2019)	149
Figura 66: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike (2019)	150
Figura 67: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë (2016–2019)	151

Tabela e përmbajtjes

BESIMI NË QEVERISJE 2019 PËRMBLEDHJE	3
1. HYRJE	18
2. METODOLOGJIA	19
2.1 Metodologjia statistikore dhe përshkrimi statistikor i kampionit	19
2.2 Instrumenti i sondazhit	20
2.3 Fokus grupet	21
2.4 Kufizimet	21
2.4 Limitations	21
3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT	22
4. REZULTATET E SONDAZHIT	28
4.1 Besimi në institucione	28
4.2 Transparenca dhe llogaridhënia	44
4.3 Korrupsioni në institucionet publike	63
4.4 Ndikimi politik	74
4.5 Pjesëmarrja qytetare	81
4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike	100
4.7 Performanca e institucioneve publike	122
4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	131
4.9 Gjinia dhe përfshirja sociale	140
5. BIBLIOGRAFIA	153
6. Shtojca 1. Karakteristikat e kampionit 2013–2019	155

1. HYRJE

Që nga rënia e komunizmit, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë kaluar një tranzicion të vështirë drejt një shoqërie të hapur dhe demokratike. Vitet e fundit, axhenda e reformave është nxitur edhe më shumë nga kushtet për anëtarësim në Bashkimin Evropian (BE), kushte që janë përcaktuar nga Komisioni Evropian. Në Shqipëri, funksionimi i institucioneve demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor dhe zhvillimi ekonomik janë në zemër të këtyre reformave.¹ Zbatimi i duhur i këtyre reformave dhe hapja e bisedimeve të anëtarësimit në BE janë aktualisht tregues të rëndësishëm të perceptimit të publikut për qeverinë shqiptare. Së bashku me tregues të tjerë afatgjatë, si besimi në qeverisje, ofrimi i shërbimeve publik dhe llogaridhënia publike, këta janë faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë mbështetjen për status quo-në në shoqërinë shqiptare.

Sondazhi i Opinionit është një instrument që bën të mundur monitorimin çdo vit të besimit dhe perceptimit të publikut për qeverisjen dhe angazhimin e qytetarëve në Shqipëri. Qëllimi kryesor i tij është të shqyrtojë perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështje të tilla si besimi tek institucionet publike, transparencja dhe llogaridhënia institucionale, korrupsioni, niveli i angazhimit të qytetarëve në politikë-bërje dhe vendimmarrje, kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jo-diskriminuese. Për më tepër, Sondazhi i Opinionit siguron të dhëna që ndihmojnë në përmirësimin e reformave madhore që lidhen me qeverisjen e mirë, antikorrupsionin, reformën në gjyqësor dhe çështjet që ndikojnë tek të gjithë sektorët, siç janë barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Në këtë raport prezantohen gjetjet nga Sondazhi i Opinionit Publik “Besimi në Qeverisje”, realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës 15 nëntor – 6 dhjetor 2019 në të 61 bashkitë e vendit. Ky është viti i shtatë radhazi që realizohet ky sondazh (2013-2019) ku përdoret i njëjti instrument vëzhgimi.²

Raporti fillon me një përshkrim të metodologjisë dhe karakteristikave social-demografike të të anketuarve dhe më pas ndiqet nga gjetjet që grupohen në nëntë seksione kryesore: besimi në institucione; transparencja dhe llogaridhënia; korrupsioni dhe institucionet publike; ndikimi i interesave politikë; pjesëmarrja qytetare; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; performanca e institucioneve publike; përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe përfshirja gjinore dhe sociale.

• • • • •

- 1 Institucionet demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor, zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria konsiderohen si “bazat” e acquis nga Komisioni Evropian.
- 2 Që nga viti 2016, ai është realizuar në kuadrin e projektit “Mbështetje për inovacionin kundër korrupsionit: Ngritja e një modeli shërbimesh me në qendër qytetarin në Shqipëri” (ISDA Support Project), një fond i përbashkët donatorësh me kontribut nga qeveria italiane, qeveria austriake dhe Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (UNDP), i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me UNDP-në.”.

2. METODOLOGJIA

2.1 Metodologjia statistikore dhe përshkrimi statistikor i kampionit

Për Sondazhin e Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” 2019 u përdor një kampion përfaqësues i popullatës shqiptare në të cilën të anketuarit u përzgjedhën nga të gjitha bashkitë e vendit dhe njësitë e tyre administrative. Përdorimi i një kampioni përfaqësues kombëtar të ponderuar na bën të mundur të përgjithësojmë dhe t’i aplikojmë gjetjet e sondazhit tek e gjithë popullata si një e tërë. Kështu, niveli i vlefshmërisë statistikore i kampionit përshkruhet si vijon: për popullsinë në moshë madhore prej 2,213,610 banorësh,³ me madhësi kampioni prej 2,500 të anketuarish, për nivel besimi prej 95%, marzhi i gabimit është ± 1.96 ; për nivel besimi prej 99%, marzhi i gabimit është ± 2.58 .

Për të përcaktuar madhësinë e kampionit për secilin qark, u morën të dhëna për popullsinë nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT).⁴ Për të llogaritur madhësinë e kampionit për secilën bashki dhe, për më shumë detaje, për secilën njësi administrative brenda bashkisë u përdorën të dhënat sasiore nga regjistri civil i datës 1 janar 2019. Kampioni prej 2,500 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë nga 12 qarqet e vendit.

Më pas, shpërndarja sipas qarqeve u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (të moshës 18 vjeç e lart) dhe për të përdorur kontrolle të kuotave sipas gjinisë. Meqenëse INSTAT nuk përcakton grupmoshat nën 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, u përdor një teknikë lineare interpolimi. Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë për meshkujt shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2019 u përcaktua në 0.768076985 dhe për femrat mbi 18 vjeç në 0.778576952. Koeficienti i përgjithshëm i përfaqësimit të popullsisë për shqiptarët mbi 18 vjeç ishte 0.773333171.⁵ Për të ilustruar këtë, në Tabelën 1 jepen shpërndarja sipas qarkut të popullatës rezidente shqiptare të moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit për secilin qark.

• • • • •

3 Shih Tabelën 1 për më shumë hollësi.

4 INSTAT e përcakton popullsinë rezidente shqiptare si “të gjithë personat që banojnë apo synojnë të banojnë në vend për të paktën 12 muaj, pavarësisht shtetësisë së tyre.” Për qëllime të këtij studimi, u përjashtuan qytetarët jo-shqiptarë.

5 Kjo do të thotë se rreth 77% e popullsisë shqiptare janë të moshës mbi 18 vjeç në 1 janar 2019.

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe madhësia e kampionit për secilin qark

Qarku	Popullsia	Popullsia mbi moshën 18 vjeç	Madhësia e kampionit për çdo qark		
			Burra	Gra	Gjithsej
Berat	125,157	96,788	54	55	109
Dibër	118,948	91,986	54	50	104
Durrës	290,126	224,364	127	126	253
Elbasan	274,982	212,653	119	121	240
Fier	294,747	227,938	130	127	257
Gjirokastrë	61,423	47,500	26	28	54
Korçë	207,889	160,767	90	92	182
Kukës	76,594	59,233	34	33	67
Lezhë	125,195	96,817	54	55	109
Shkodër	202,895	156,905	86	91	177
Tiranë	895,160	692,257	384	399	783
Vlorë	189,311	146,400	82	83	165
Gjithsej	2,862,427	2,213,610	1,240	1,260	2,500

Pyetësorët u administruan nga 12 grupe intervistuesish të trajnuar për intervistat ballë-për-ballë duke përdorur teknikën PAPI (intervistë personale me laps dhe letër).⁶ Të dhënat u përpunuan dhe u analizuan për të paraqitur statistika përshkruese dhe relacionale, duke përdorur programin SPSS.

2.2 Instrumenti i sondazhit

Çdo vit, instrumenti i sondazhit ka të njëjtat pyetje bazë për besimin në qeverisje, korrupsionin, angazhimin qytetar, përdorimin e TIK siç evidentohet edhe në raportet e mëparshme që janë hartuar duke filluar që nga viti 2013. Megjithatë, përmbajtja e instrumentit shqyrtohet nga një ekip ekspertësh në fushat e qeverisjes së mirë dhe shkencave sociale për të ruajtur ritmin me zhvillimet dhe tendencat më të fundit në debatin

• • • • •

6 Duhet theksuar se rreth 60% e anketimit u bë në periudhën pas tërmetit të 26 nëntorit 2019. Nga ky tërmet me magnitudë 6.4 ballë vdiqën 51 vetë, u plagosën 3,000 të tjerë dhe u shkakjuan dëme të konsiderueshme në mbi 14,000 ndërtesa. Zhvillimet shoqërore dhe veprimet e qeverisë pas kësaj ngjarjeje mund të kenë ndikuar në një farë mase tek gjetjet e sondazhit të vitit 2019.

publik. Këtë vit, u shtuan dy pyetje për qendrat e shërbimit të integruar ADISA. Një tjetër pyetje, që fokusohet te llogaridhënia e institucioneve publike dhe mendimi i qytetarëve, u hartua për të vlerësuar portalin shqiperiaqeduam.al.

Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, në këtë sondazh zgjerohet numri i institucioneve që vlerësohen për ofrimin e shërbimeve publike. Tek 13 shërbimet ekzistuese që ofrohen nga institucionet publike u shtuan edhe shërbimet e sigurimeve shoqërore, shërbimet e gjendjes civile dhe ato të transportit rrugor.

2.3 Fokus grupet

Në metodologjinë e sondazhit të opinionit publik “Besimi në qeverisje” 2019 u përdorën një larmi metodash kërkimore. Janë organizuar disa diskutime në fokus grupe për të vleftësuar dhe për të kontekstualizuar rezultatet e sondazhit. Pjesëmarrësit u përzgjedhën sipas moshës, arsimit, nivelit të të ardhurave, përfaqësimit gjeografik, duke qenë se u vëzhguan perceptime të ndryshme në lidhje me pyetjet bazë të sondazhit. Në secilin fokus grup, pjesëmarrësve iu kërkua të validojnë dallimet e dukshme për grupin e tyre demografik dhe të japin perceptimet e tyre për besimin tek institucionet, për transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve, për korrupsionin, kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike dhe motivet që i shtyjnë për t’u larguar nga Shqipëria.

Në datat 13, 14 dhe 15 janar 2020 u organizuan 5 fokus grupe me tetë deri në dhjetë pjesëmarrës secili që ishin: ‘nën moshën 30 vjeç; ‘mbi moshën 55 vjeç; ‘me diplomë universitare/më lart; ‘pa të ardhura ose me të ardhura më pak se 24,000 lekë; dhe ‘banor në zonat rurale’. Për secilin fokus grup u kontrolluan të dhënat demografike përveç atyre me të cilat u përzgjedhën pjesëmarrësit.

2.4 Kufizimet


Rezultatet e Sondazhit të Opinionit Publik 2019 mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë duke përdorur ponderimet e përfaqësimit të kampionit statistikor për të gjithë popullatën. Megjithatë, krahasimi i rezultateve statistikore të vitit 2019 me vitet e mëparshme (2013-2018), në të cilat është përdorur kampionimi me kuotë, mund të sjellin një nivel pasigurie statistikore.

3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT

Për Sondazhin e Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” 2019 u anketuan në total 2,500 vetë në moshë madhore në të gjithë vendin. Karakteristikat demografike kryesore të kampionit përfundimtar të të anketuarve jepen më poshtë në lidhje me gjininë, përfaqësimin gjeografik, moshën, arsimin, statusin e punësimit, nivelin e të ardhurave individuale, paaftësinë, dhe përfaqësimin e minoritetit.

Nga 2,500 të anketuar, 50.6% ishin femra dhe 49.4% meshkuj. Shpërndarja gjeografike ishte 69.8% banorë të zonave urbane dhe 30.2% të zonave rurale. Si për krahasim, të dhënat nga INSTAT tregojnë se in 2011, 58.2% e shqiptarëve jetonin në zonat urbane,⁷ ndërkohë që ky numër vazhdon të rritet.


Figura 1. Përfaqësimi gjinor



Baza: $N = 2500$

.....

7 INSTAT, Klasifikimi i ri urban–rural i popullsisë në Shqipëri (maj 2014). Aksesuar nëpërmjet adresës: http://www.instat.gov.al/media/2919/a_new_urban-rural_classification_of_albanian_population.pdf

Figura 2. Përfaqësimi gjeografik

Baza: $N = 2500$

Për sa i përket shpërndarjes moshore, të anketuarit duhet të ishin të paktën në moshë për të votuar. Kështu, të gjithë të anketuarit janë të moshës 18 deri në 84 vjeç. Pjesa më e madhe (64.8%) janë të moshës 18 deri në 45 vjeç: 19% ishin mes 18 dhe 25 vjeç, 26.3% mes 26 dhe 35 vjeç, dhe 19.4% mes 36 dhe 45 vjeç.⁸ Një tjetër përqindje, 35.2%, e të anketuarve ishin të moshës mes 46 dhe 84 vjeç. Për të parë shpërndarjen e të anketuarve sipas secilës grupmoshë referojuni Tabelës 2.

Tabela 2. Grupmoshat

Mosha (në grupe)	Përqindja
18–25 vjeç	19.0%
26–35 vjeç	26.3%
36–45 vjeç	19.4%

• • • • •


8 Shpërndarja sipas moshës e kampionit është e njëjtë me atë të viteve të mëparshme. Ashtu si popullsia rezidente shqiptare (shih INSTAT), përqindja e të anketuarve të moshës 25-34 vjeç është më e madhe se ajo e grupmoshave të tjera.

Mosha (në grupe)	Përqindja
46–55 vjeç	16.2%
56–65 vjeç	12.0%
Mbi 65 vjeç	7.0%
Gjithsej	100.0%

Baza: N = 2500

Shumica e të anketuarve (78%) kishin mbaruar shkollën e mesme ose kishin diplomë universitare apo pasuniversitare. Plot 44.4% kishin përfunduar arsimin e mesëm; ndërkohë që 33.6% ose kishin përfunduar ose ishin duke ndjekur arsimin terciar (d.m.th., arsimin universitar apo pasuniversitar). Plot 18.2% e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e detyrueshëm nëntëvjeçar dhe vetëm 3.9% nuk kishin fare arsim ose kishin përfunduar vetëm atë fillor.

Figura 3. Niveli i arsimit të përfunduar



Baza: N = 2467

Nga të anketuarit, 54.4% ishin të punësuar në kohën që u realizua ky sondazh, ndjekur nga të papunët që përbën 25.1% të kampionit. 10.8% e të anketuarve ishin pensionistë dhe 6.9% ishin studentë. 2.7% e të anketuarve raportuan një status të ndryshëm punësimi, për shembull sepse janë të vetëpunësuar, punojnë si vullnetarë, shtëpiakë, ose sepse punojnë jashtë vendit (p.sh. punë sezonale).

Tabela 3. Statusi i punësimit


Statusi i punësimit	Nr.	Përqindja
Të punësuar	1,340	54.4%
Sektori publik		24.4%
Sektori privat		72.2%
Tjetër		3.4%
Gjithsej		100%
I/e papunësuar	619	25.1%
Student	171	6.9%
Pensionist	266	10.8%
Tjetër	67	2.7%
Gjithsej	2,463	100.0%

Baza: N = 2463

Shpërndarja e të ardhurave mujore individuale të të anketuarve jepet në grafikun e mëposhtëm. Rreth një e treta e kampionit (31.9%) thanë se nuk kishin të ardhura të rregullta mujore në kohën kur u intervistuan, ndërsa 27.2% raportuan të ardhura neto deri në 24,000 lekë në muaj. Plot 31.2% merrnin 24,001-50,000 lekë në muaj, 7.8% fitonin 50,001-70,000 lekë në muaj dhe vetëm 2% e kampionit kishin të ardhura të rregullta individuale mujore mbi 70,000 lekë.

Ka dallime të konsiderueshme të të ardhurave mes të anketuarve femra dhe meshkuj. 33.2% e të anketuarve femra nuk kishin të ardhura të rregullta mujore përkundër 24.1% të të anketuarve meshkuj. Po ashtu, 41.3% e meshkujve të anketuar kishin të ardhura të rregullta mujore më shumë se 24,001 lekë, krahasuar me vetëm 32.6% të femrave të anketuara. 2.7% e të anketuarve meshkuj kishin të ardhura mesatare mujore më shumë se 70,001 lekë, ndërsa vetëm 0.9% e femrave të anketuara kishin të ardhura më shumë se 70,001 lekë.

Figura 4. Të ardhurat e rregullta individuale mujore (Neto)



Baza: N = 2252

Të pyetur nëse e konsiderojnë veten me paaftësi, vetëm 7% e të anketuarve vetë-raportuan se kanë aftësi të kufizuara (N = 161). Në fund, të anketuarit u pyetën nëse i përkasin një pakice kombëtare. 6.2% e të anketuarve deklaruan se i përkasin një pakice. Nga kjo përqindje, 23.7% u identifikuan si grekë, 25% si romë, 15.1% si egjiptianë dhe 13.8% si maqedonas. 92.8% e të anketuarve nuk u identifikuan si anëtarë të asnjë pakice kombëtare. Në Tabelën 4 jepen shifrat për të anketuarit që i përkasin grupeve të pakicave. Për shkak të përqindjes së vogël të të anketuarve që raportojnë se i përkasin një pakice kombëtare, kjo karakteristikë demografike do të përfshihet vetëm në analizën e rezultateve të sondazhit, kur ka lidhje të drejtpërdrejta me pyetjen përkatëse (p.sh. diskriminimi ose pyetjet që lidhen me sigurinë).

Tabela 4. A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	Nr.	Përqindjet
Po	152	6.2%
Greke	36	1.5%
Maqedonase	21	0.9%
Arumune	6	0.2%
Rome	38	1.5%
Egjiptiane	23	0.9%
Malazeze	3	0.1%
Boshnjake	5	0.2%
Serbe	1	<0.1%
Bullgare	7	0.3%
Refuzim/pakicë tjetër	12	0.5%
Jo	2291	92.8%
Refuzim	26	1.0%
Gjithsej	2469	100.0%

Baza: N = 2469

4. REZULTATET E SONDAZHIT

4.1 Besimi në institucione

Besimi është një dukuri e ndërlikuar, dinamike, e kushtëzuar, dhe e varur nga konteksti. Besimi është pritshmëria se objekti i besimit do të prodhojë rezultate pozitive (Levi dhe Stoker, 2000). Besimi tek institucionet publike konsiderohet kështu si qëndrim (Hoskings, 2017). Besimi në institucione interpretohet si besimi tek organizmat shtetërorë si parlamenti, qeveria, policia, gjykatat, institucionet publike të pavarura dhe tek organizatat jo-shtetërore si media, organizatat fetare dhe ato joqeveritare (Eurofound, 2018: 5). Hulumtimi i besimit tek institucionet ka rëndësi, sepse perceptohet si tregues kryesor i mirëqenies së individit dhe shoqërisë dhe një kusht themelor i veprimit dhe bashkëpunimit kolektiv (Eurofound, 2018; OECD, 2013). Përveçse është thelbësore për kohezionin social, besimi tek institucionet dhe veçanërisht besimi tek qeveria vlerësohet si një nga themelet më të rëndësishme mbi të cilat ngrihen ligjshmëria dhe qëndrueshmëria e sistemeve politike (OECD, 2013). Besimi përcaktohet nga një sërë faktorësh: në nivelin makro, situata ekonomike, klima politike dhe kultura e përgjithshme e besimit në shoqëri konsiderohen si ndryshore (variabla) kryesore; në nivelin mikro, disa nga variablat që evidentohen më së shumti janë arsimi, mosha, të ardhurat, besimi fetar, vlerat personale, perceptimet dhe përvojat (Eurofound, 2018; OECD, 2013).

Besimi në institucione përbën një nga shtyllat kryesore të Sondazhit të Opinion Publik “Besimi në qeverisje”. Të anketuarve iu kërkohet të vlerësojnë në një shkallë prej katër pikësh nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim) se sa i besojnë aktorëve kryesorë shtetërorë dhe institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor si dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm jo-shtetërorë në Shqipëri. Supozimi bazë këtu është se shkalla e besimit në institucione të caktuara që tregohet nga të anketuarit në këtë sondazh të opinionit publik buron nga kombinimi i faktorëve në nivel makro dhe mikro. Implikimi këtu është se të anketuarit tregojnë shkallën e besimit të tyre si qytetarë bazuar në perceptimin e përgjithshëm dhe përvojat që kanë me institucionet e përmendura pa pasur nevojë të kenë njohuri dhe informacion për funksionimin e institucioneve përkatëse.


Besimi në institucione, rezultatet e 2019

Në 2019, shqiptarët vazhduan t'i besonin më shumë institucioneve fetare (65.6%) dhe forcave të armatosura (59.4%), institucione që ndiqen nga ato arsimore (57.3%), organizatat e shoqërisë civile (56.3%), policia e shtetit (54.6%), institucionet e kujdesit shëndetësor (51.4%), dhe media (50.7%). Qeveria qendrore dhe vendore, parlamenti, prokuroria, presidenti dhe gjykatat vazhdojnë të marrin vlerësime të ulëta për nivelin e besimit, ku partitë politike kanë nivelin më të ulët të këtij besimi (22.5%). Ekzekutivi, krahasuar me legjislativin dhe gjyqësorin, ka një nivel më të lartë besimi. Në kontrast me institucionet në vend, institucionet/organizatat ndërkombëtare, si NATO, OKB, dhe BE renditen si institucionet më të besuara.

Në 2019, institucionet vendase që morën vlerësime të larta besimi⁹ nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: institucionet fetare (65.6%), forcat e armatosura (59.4%), institucionet e sistemit arsimor (57.3%), organizatat e shoqërisë civile (56.3%), policia e shtetit (54.6%), institucionet e kujdesit shëndetësor (51.4%), dhe media (50.7%).

Institucionet fetare jo vetëm që janë institucionet më të besuara në vend, por ato kanë marrë edhe vlerësimin më të lartë të alternativës “Kam shumë besim” mes institucioneve të tjera në vend (23.4%). Forcat e armatosura renditen si institucioni i dytë më i besuar me vlerësim total të besimit në to nga 59.4% e popullatës së anketuar.

Figura 5: Besimi në institucione 2019



9 Në të gjithë këtë kapitull, vlerësimet verbale më të larta (1–2) dhe më të ulëta (3–4) përmbledhen në dy kategori kryesore: ‘prirë për t’i besuar’ dhe ‘prirë për të mos i besuar’.

Institucionet e sistemit arsimor (57.3%) dhe organizatat e shoqërisë civile (56.3%) u renditën si institucionet e treta dhe të katërta më shumë të besuara në vend. 11.6% e të anketuarve deklaruan se kishin besim të madh tek organizatat e shoqërisë civile në krahasim me institucionet e sistemit arsimor me 8.2%. Më tej, policia kishte besimin e 54.6% e popullsisë së anketuar, e ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor (51.4%) dhe media (50.7%).

Institucionet vendase që kanë marrë vlerësimet më të ulëta të besimit nga më shumë se gjysma e të anketuarve janë: qeveria vendore (42%), qeveria qendrore (41.3%), parlamenti (28.4%), prokuroria (27.4%), presidenti (27.6%), gjykatat (27.1%) dhe partitë politike (22.5%). Si për kontrast, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare, si NATO, OKB dhe BE, renditen si institucionet më të besuara (me 78.2%, 75.2%, 73.4% të besimit të publikut për secilën prej tyre).

Krahasimi social-demografik i besimit në institucione

Popullsia rezidente në moshë raporton më së shpeshti se ka besim tek institucionet publike krahasuar me popullsinë rezidente në moshë të re, veçanërisht për sa i përket tre degëve të qeverisjes: ekzekutivi, gjyqësori dhe legjislativi. Të punësuarit dhe ata me nivel të lartë arsimor kishin disi më shumë besim tek institucionet, ndërsa të anketuarit me nivel të lartë të ardhurash raportonin nivel më të ulët besimi tek institucionet në vend dhe nivel mjaft më të lartë të besimit tek institucionet si BE, OKB dhe NATO.

Në këtë nënkapitull shqyrtohet nëse besimi në institucione të caktuara ndryshon në segmente të ndryshme social-ekonomike të popullatës së anketuar duke marrë parasysh gjininë, moshën, nivelin e arsimit, statusin e punësimit, të ardhurat dhe përfaqësimin gjeografik. Të kombinuar së bashku,¹⁰ ka pak dallim mes gjinive për sa i përket besimit tek institucionet. Sidoqoftë, femrat e anketuara (53%) kishin më shumë të ngjarë të besonin te media sesa meshkujt e anketuar (49%). Po ashtu, 29% e femrave të anketuara kanë besim te gjykatat krahasuar me 26% të meshkujve të anketuar.

Në përgjithësi, vihet re se të anketuarit nga grupmoshat e mëdha priren të raportojnë nivele më të larta besimi tek institucionet krahasuar me grupmoshat e reja të popullatës së anketuar. Të anketuarit e grupmoshës mbi 65 vjeç priren të kenë besim tek institucionet fetare (66%), forcat e armatosura (65%), policia (60%), qeveria vendore (48%), parlamenti (38%), prokuroria (35%) dhe gjykatat (33%). Megjithatë, besimi i tyre te qeveria qendrore ishte në të njëjtin nivel (43%) me nivelin e përgjithshëm të besimit që evidentohet te e gjithë popullata e anketuar (41%). Brezat e rinj priren të raportojnë nivele më të ulëta besimi tek institucionet, veçanërisht për sa i përket tre degëve të qeverisjes: ekzekutivi, gjyqësori dhe

• • • • •

10 Përqindja e të anketuarve që thonë se 'Kam shumë besim' apo 'Kam besim'.

legjislativi. Vetëm 23% e të anketuarve në grupmoshën 18-25 vjeç priren të kenë besim te parlamenti, nivel që është më i ulët se besimi në përgjithësi që raportohet nga popullata e anketuar (28%). Ky grup shfaq besim të ulët edhe tek institucionet fetare (29%) krahasuar me 66% të nivelit në përgjithësi të besimit të raportuar nga kampioni i anketuar.

Nivelet e ulëta të besimit priren të rriten paksa sipas nivelit arsimor të të anketuarve. Të anketuarit me arsim universitar ishin më të prirur të tregonin besim tek institucionet fetare (63%), forcat e armatosura (60%), institucionet arsimore (60%), organizatat e shoqërisë civile (57%), policia (56%), qeveria vendore (47%) dhe qeveria qendrore (44%) krahasuar me të anketuarit me nivel arsimi 9-vjeçar apo me arsim të mesëm. Përfundimisht bën media, ku kjo prirje kthehet nga ana e kundërt: 55% e të anketuarve me nivel arsimor deri 9-vjeçar¹¹ kishin besim te media, në krahasim me 44% të të anketuarve me nivel arsimor universitar apo pasuniversitar. Po ashtu, kjo është më e ulët se niveli i përgjithshëm i besimit te media (51%) të treguar nga popullata e anketuar.

Për sa i përket statusit të punësimit, të anketuarit e punësuar duket se kanë më shumë besim te institucionet se ata të papunët. Të anketuarit që punojnë në sektorin publik raportuan nivele më të larta besimi tek institucionet e sistemit arsimor (74%), forcat e armatosura (72%), qeveria vendore (68%), institucionet e sistemit shëndetësor (66%) dhe te qeveria qendrore (65%). Kjo është në kontrast të madh me nivelin e besimit që raportohet nga të anketuarit që punojnë në sektorin privat dhe në mënyrë të veçantë nga të anketuarit e papunë. Këta të fundit thanë se nuk kanë besim te qeveria qendrore (40%), qeveria vendore (39%), policia (30%), institucionet e sistemit të kujdesit shëndetësor (36%) dhe institucionet e sistemit arsimor (31%).

Në përgjithësi, nuk ka dallime në nivelin e besimit kur krahasohen të anketuarit nga qendrat urbane me ato të zonave rurale. Niveli i besimit të tyre prirët të jetë i njëjtë me atë të raportuar nga e gjithë popullata e anketuar. Ka dy përjashtime: popullsia rurale prirët të besojë më shumë te forcat e armatosura (65%) dhe institucionet fetare (71%) në krahasim me popullsinë e zonave urbane (përkatesisht me 57% dhe 64%).

Niveli i besimit tek institucionet vendase prirët të bie nëse i anketuari ka të ardhura mesatare më të larta (mbi 70,001 lekë/muaj). Për shembull, të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë/muaj kanë nivel më të ulët besimi te qeveria qendrore prej 32%, qeveria vendore (37%), presidenti (23%), parlamenti (23%), prokuroria (21%), gjykatat (25%) dhe partitë politike (18%). Megjithatë, niveli i besimit të kësaj kategorie duket se ishte pak më i lartë për policinë (59%) krahasuar me nivelin e përgjithshëm të besimit të popullatës së anketuar (55%). Media në mënyrë të konsiderueshme është më pak e besuar nga të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë/muaj (19%) në krahasim me nivelin e besimit të të anketuarve në përgjithësi (51%). 93% e këtyre të anketuarve i besonin BE-së, 93% NATO-s dhe 82% OKB-së, që është një vlerësim më i lartë në krahasim me atë të shprehur në total nga e gjithë popullata e anketuar (me nivel besimi përkatësisht 73%, 78% dhe 75%).

.....

11 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Po ashtu, të anketuarit pa të ardhura raportuan nivele më të ulëta besimi tek institucionet publike, p.sh., 31% e tyre besojnë tek qeveria vendore dhe ajo qendrore, 26% te presidenti dhe vetëm 19% te parlamenti dhe gjykatat. Kjo kategori shprehu nivel më të lartë besimi tek forcat e armatosura, policia dhe media: 54%, 47%, dhe 51% përkatësisht. Ndërkohë, të anketuarit me të ardhura mujore 24,001 – 50,000 lekë raportuan nivel më të lartë besimi: 51% kishin besim te qeveria qendrore dhe 53% te qeveria vendore. Të anketuarit me të ardhura mujore 50,001–70,000 lekë shfaqën nivel më të lartë besimi, ku gjysma e tyre kishin besim te qeveria qendrore dhe ajo vendore dhe një shumicë e konsiderueshme tek institucionet fetare (70%), institucionet e sistemit arsimor (64%), forcat e armatosura (64%) dhe policia (61%). Shih Tabela 6 në fund të këtij kreu për një ndarje të hollësishme sipas treguesve social-demografikë për besimin në institucione.

Pjesëmarrësit në fokus grupe të kategorisë “nuk kam të ardhura” apo “deri në 24,000 lekë në muaj” e lidhën besimin me aftësinë e institucioneve për t’iu përgjigjur problemeve konkrete të komunitetit, veçanërisht në zonat periferike krahasuar me qendrën. Disa pjesëmarrës argumentuan se besimi tek institucionet është i ulët sepse “shteti është i varfër dhe nuk mund t’u përgjigjet nevojave [të qytetarëve]” dhe se “shohim përmirësime në infrastrukturën e shëndetësisë për shembull, por është shumë pak dhe pa ndikim të dukshëm në jetën tonë të përditshme dhe në mirëqenien tonë.”

Kur analizojmë anëtarësinë në parti politike me nivelin e besimit tek partitë politike, shumica e të anketuarve (59%) që deklaruan se ishin anëtarë të partive politike shprehën nivel të ulët besimi tek to: 35% thanë se nuk kishin besim te partitë politike dhe 24% nuk kishin aspak besim te to.

Kur vjen puna te besimi në institucionet publike, të gjithë pjesëmarrësit e fokus grupeve, pavarësisht se kanë prejardhje të ndryshme, theksuan se, për ta, besimi në institucione buron nga ndershmëria e perceptuar e individëve që drejtojnë dhe punojnë në këto institucione dhe nga integriteti e aftësia e tyre për të vepruar më shumë në interes të publikut sesa për interesat e tyre. Një nga pjesëmarrësit e grupmohës mbi 55 vjeç, theksoi: “Edhe sikur të doja t’i besoja qeverisë, si mund ta bëj këtë kur gjithmonë më gënjejnë: shumë premtime, shumë pak veprime. Kam jetuar në qeveri të ndryshme, parti të ndryshme politike dhe për mua ata janë të gjithë njësoj, janë të gjithë shumë zhgënjyes.” Një pjesëmarrës tjetër theksoi: “ata [zyrtarët publikë dhe politikanët] i bëjnë punët vetëm për interesin e tyre, por i paraqesin ato sikur të ishin për të mirën tonë.”

Besimi në institucione në vite

Për pjesën më të madhe të institucioneve, niveli i besimit u rrit në vitet 2015 - 2017, por është ulur disi që nga ajo periudhë. Kjo është e vërtetë edhe për organizatat ndërkombëtare: BE (7 p.p.), OKB (4 p.p.) dhe NATO (3 p.p.)

I që patën një ulje të nivelit të perceptuar të besimit në vitet 2017 - 2019. Prokuroria dhe gjykatat, institucionet të perceptuar si me nivelin më të ulët të besimit, kanë pasur një rritje të nivelit të besimit tek to në vitet 2015 - 2019.

Sondazhi i vitit 2019 shënon vitin e pestë radhazi të matjes së perceptimit të besimit tek një kampion i madh të anketuarish. Të dhënat e pesë sondazheve të opinionit publik zbulojnë disa tendenca interesante në lidhje me nivelin e besimit tek institucionet shqiptare dhe ndërkombëtare. Për shembull, të dhënat tregojnë se për shumicën e institucioneve, niveli i besimit është rritur mes viteve 2015 dhe 2017, por ky nivel ka rënë disi që pas vitit 2017. Për institucionet vendase, si qeveria qendrore (+13 p.p.), parlamenti (+12 p.p.), forcat e armatosura (+17 p.p.), kujdesi shëndetësor (+26 p.p.), sistemi arsimor (+30 p.p.), institucionet fetare (+ 24 p.p.) dhe shoqëria civile (19 p.p.), niveli i besimit u rrit ndjeshëm mes viteve 2015 dhe 2017. Megjithatë, në periudhën 2017 - 2019, niveli i besimit tek to ra nga 1 p.p. (për shoqërinë civile) deri në 10 p.p. (për institucionet fetare). Po ashtu, në lidhje me organizatat ndërkombëtare, Sondazhi i Opinionit për vitin 2019 është raporti i dytë radhazi që eidenton një rënie të nivelit të besimit tek BE, OKB dhe NATO (7 p.p., 4 p.p. dhe 3 p.p. përkatësisht). Kjo është në kontrast me periudhën 2015-2017, gjatë së cilës BE e NATO shënuan një rritje të besimit.

Për institucionet e tjera, sondazhi i opinionit 2019 shënoi vitin e tretë radhazi në të cilin bie niveli i besimit. Presidenti, i besuar në vitin 2016 nga 36% e të anketuarve, kishte besimin e vetëm 28% të të anketuarve në vitin 2019. Për më tepër, institucionet që vlerësoheshin si më pak të besueshme, prokuroria dhe gjykatat, kanë pasur në të vërtetë një rritje të besimit tek to që nga Sondazhi i Opinionit i vitit 2015. Matur si pjesë e “gjyqësorit” në vitin 2015, këto institucione gëzonin besimin e vetëm 17% të të anketuarve, ndërsa në vitin 2019 si prokuroria ashtu edhe gjykatat u konsideruan si të besueshme nga 27% e të anketuarve.

Tabela 5: Besimi në institucione në vitet 2015–2019

	2015	2016	2017	2018	2019
Qeveria qendrore	34%	44%	47%	42%	41%
Qeveria vendore	X	49%	49%	47%	42%
Presidenti	29%	36%	33%	30%	28%
Parlamenti	22%	27%	34%	30%	28%
Gjyqësori*	17%	23%	X	X	X
Prokuroria	X	X	22%	28%	27%
Gjykatat	X	X	21%	28%	27%
Policia	46%	61%	53%	58%	55%
Forcat e armatosura	46%	55%	63%	63%	59%
Partitë politike	15%	23%	21%	22%	23%

	2015	2016	2017	2018	2019
Institucionet e shëndetit publik	27%	50%	53%	54%	51%
Institucionet e arsimit publik	33%	59%	63%	64%	57%
Media	39%	58%	54%	56%	51%
Institucionet fetare	52%	58%	76%	73%	66%
Organizatat e shoqërisë civile	38%	46%	57%	57%	56%
Bashkimi Evropian	72%	80%	85%	80%	73%
Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB)	X	80%	85%	79%	75%
NATO	74%	79%	84%	81%	78%

Baza: N=2499 in 2019; N=1647 in 2018, 2017, 2016.

* Që nga viti 2017 e më tej “gjyqësori” është ndarë në “prokurori” dhe “gjykata”.

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e përcaktimit të kampionit ndryshoi në krahasim me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kreun “Metodologjia”.

Për të tretin vit radhazi, pyetjet bazë për besimin në institucione u plotësuan me disa pyetje të reja – për të shqyrtuar pikëpamjet e publikut për tematikën e reformës në drejtësi, ndikimin e saj në zhvillimin e vendit, median dhe besueshmërinë e saj.


Reforma në drejtësi – rezultatet e vitit 2019

Rreth 1 në 2 shqiptarë besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit (52.7%). Megjithatë, perspektivat për zbatimin efikas të reformës në drejtësi në praktikë vazhdojnë të jenë të ndara – me rreth gjysmën e të anketuarve (48.5%) që besojnë se reforma nuk po zbatohet me korrektësi.

Në vitin 2016, Shqipëria ndërmori një proces jashtëzakonisht sfidues të reformimit të sistemit të saj të drejtësisë, duke synuar të luftojë korrupsionin e përhapur dhe ndikimin politik si dhe të (ri)ndërtojë besimin e publikut tek sistemi gjyqësor. Kjo paketë komplekse reformash nisi me procesin e vetingut për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët dhe me ngritjen e institucioneve të reja siç janë Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara, së bashku me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, i mbështetën fuqimisht reformat dhe, nga ana tjetër, kanë evidentuar përparimin me zbatimin e tyre, veçanërisht me procedurën e vetingut (Progres Raporti i KE për Shqipërinë, 2019). Si BE ashtu dhe SHBA i kanë kërkuar qeverisë dhe aktorëve politikë në Shqipëri të ruajnë dhe thellojnë ritmin e reformës, veçanërisht në fushën e gjyqësorit dhe shtetit ligjor.

Në vitin 2019, 52.7% besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Megjithatë, vetëm 31.5% besojnë se reforma po zbatohet siç duhet. Edhe pse pritshmëritë pozitive për reformën në drejtësi shihen tek pak më shumë se gjysma e popullatës së anketuar (52.7%), perspektivat për zbatimin efikas të reformës në drejtësi në praktikë vazhdojnë të jenë të ndara. Plot 48.5% e të anketuarve besojnë se reforma nuk po zbatohet siç duhet. Vetëm 31.5% besojnë se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi.

Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2019



Baza: N=2498 për zbatimin e reformës në drejtësi; N=2494 për ndikimin e reformës në drejtësi

Krahasimi social-demografik për reformën në drejtësi

Rreth gjysma e shqiptarëve, pavarësisht moshës apo gjinisë, besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Gjithsesi, brezat e rinj priren të jenë më mosbesues në lidhje me zbatimin efektiv të reformës. Reforma në drejtësi konsiderohet më së shumti se ka ndikim pozitiv dhe se po zbatohet me korrektësi nga të anketuarit që punojnë në sektorin publik ose të anketuarit që janë me diplomë universitare. Qytetarët shqiptarë me nivel më të lartë të ardhurash janë më pak besimplotë në lidhje me ndikimin pozitiv dhe me zbatimin me korrektësi të reformës në drejtësi.

Nuk ka ndonjë dallim të konsiderueshëm në perceptimet e grave dhe burrave në lidhje me ndikimin pozitiv të reformës në drejtësi. Pak më shumë se gjysma e të anketuarve meshkuj (54%) dhe femra (51%) besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv. Burrat priren të jenë më pozitivë në lidhje me zbatimin e reformës, ku 34% kanë deklaruar se reforma po zbatohet me korrektësi në krahasim me gratë (29%). Referojuni tek Tabela 7 në fund të këtij kapitulli për të dhënat më të hollësishme në lidhje me ndarjet social-demografike për reformën në drejtësi.

Perceptimet për sa i përket ndikimit pozitiv të reformës në drejtësi në zhvillimin e Shqipërisë nuk ndryshonin sipas grupmoshave dhe mbeteshin në pothuajse të njëjtat nivele me perceptimet e raportuara në përgjithësi nga e gjithë popullata e anketuar (53%). Megjithatë, të anketuarit në moshë të re (18-25 vjeç) prireshin të ishin më mosbesues në lidhje me zbatimin e kësaj reforme, ku 58% thanë se reforma nuk po zbatohet me korrektësi krahasuar me 41% të të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç.

Të anketuarit me nivel arsimor deri në arsim 9-vjeçar¹² (47%) prireshin të ishin më pak entuziastë për ndikimin pozitiv të reformës në drejtësi krahasuar me të anketuarit me arsim universitar ose pasuniversitar (59%).

Mes të anketuarve në marrëdhënie pune dhe ata të papunë vihet re dallim i konsiderueshëm për sa i përket ndikimit të reformës: 59% e të anketuarve të punësuar besojnë se reforma do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit, por vetëm 42% e të anketuarve të papunë besojnë të njëjtën gjë. Po ashtu, shumica dërrmuese e të anketuarve që punojnë në sektorin publik (70%) besojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Plot 54% e të anketuarve që punojnë në sektorin privat deklaruan të njëjtën gjë.

Për sa i përket të ardhurave, të anketuarit me nivel më të lartë të ardhurash (mbi 70,001 lekë në muaj) prireshin të ishin më mosbesues në lidhje me ndikimin dhe zbatimin e reformës në drejtësi në krahasim me ata që kanë më pak të ardhura (50,001–70,000 lekë në muaj): 49% besonin se reforma do të ketë ndikim pozitiv dhe vetëm 20% besonin se kjo reformë po zbatohet me korrektësi, krahasuar me 64% dhe 38% të të anketuarve me nivel më të ulët të ardhurash, përkatësisht.

Për sa i përket reformës në drejtësi, të anketuarit në moshë të re në fokus grupe (përfshirë edhe studentë të juridikut dhe persona në fillimet e karrierës së tyre profesionale) shprehën mosbesimin e tyre për procesin dhe rezultatet e tij. Pjesëmarrësit në fokus grupin e moshës “nën 30 vjeç” i bënë jehonë komentit të një bashkëfolësi në grup: “reforma po bëhet thjesht vetëm sa për sy e faqe; nuk ka ndikim të vërtetë. Kjo reformë është proces selektiv. Po ndëshkohen disa për t’u shërbyer atyre që kanë mbështetje të fuqishme.” Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në moshë të re pranuan edhe informacionin e kufizuar që kanë për thelbin e procesit dhe për mënyrën se si po realizohet reforma.

12 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Sipas diskutimeve në fokus grupe, mund të thuhet se perceptimet e mosbesimit për reformën në drejtësi, si për procesin ashtu edhe për rezultatet, vijnë jo domosdoshmërisht nga njohuria dhe ekspertiza, por kryesisht nga një qëndrim i përgjithshëm mosbesimi dhe pakënaqësie me politikën. Në këtë kuptim, reforma në drejtësi perceptohet si proces politik dhe jo thjesht si proces ligjor.


Përveç kësaj, pjesëmarrësit “mbi 55 vjeç” raportuan ndikim të kufizuar pozitiv të reformës, sepse sipas tyre: “procesi është i lidhur me interesa të caktuara politike.” Po ashtu, ky grup evidentoi mosbesimin e tij te komuniteti ndërkombëtar: “ata [komuniteti ndërkombëtar] nuk mund të bëjnë shumë në këtë drejtim, sepse edhe ata janë korruptuar ashtu si shqiptarët.” Çështja e besimit tek institucionet publike dhe te reforma në drejtësi lidhet veçanërisht me perceptimet e qytetarëve për korrupsionin e supozuar jo vetëm të politikanëve dhe institucioneve shqiptare por edhe të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri.

Reforma në drejtësi në vite

Pritshmëritë e publikut për ndikimin pozitiv të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit dhe të zbatimit të saj me korrektësi kanë rënë me kalimin e viteve (2016-2019).

Të dhënat e sondazheve të realizuara në vitet 2017 dhe 2018 kanë ritheksuar pritshmërinë e publikut për ndikimin pozitiv që do të ketë zbatimi i reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit. Pavarësisht kësaj, përqindja e pritshmërive pozitive ka rënë nga 71% në vitin 2016 në 66% në 2017 dhe në 53% në 2018. Të dhënat për vitin 2019 tregojnë të njëjtin nivel besimi (53%) se reforma në drejtësi do të sjellë zhvillimin e vendit. Ka pasur një rritje paksa të lehtë të pasigurisë për ndikimin pozitiv të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit nga 16% e të anketuarve në 2017 që thonë se nuk e dinë në 22% në vitin 2018 dhe në 23% në 2019.

Figura 7: ‘Ndikimi pozitiv’ përkundër ‘zbatimit me korrektësi’ të reformës në drejtësi në zhvillimin e vendit 2016–2019




Baza: Për ndikimin e reformës në drejtësi, 2016 (N=1639); 2017 (N=1644); 2018 (N=1642); 2019 (N=2494), Për zbatimin e reformës në drejtësi 2016 (N=1641); 2017 (N=1646); 2018 (N=1645); 2019 (N=2498).

Media

Televizioni (57.2%) mbetet burimi mediatik më popullor për marrjen e të rejave më të fundit për aktualitetin, veçanërisht për brezat në moshë të madhe, të punësuarit apo për banorët e zonave rurale. Megjithatë, televizioni humbet terren, veçanërisht te grupmoshat e reja dhe te qytetarët me nivel të lartë të ardhurash. Të anketuarit nga të gjitha grupet demografike shpesh shprehën se nuk besojnë që media jep informacion të saktë.

Në vitin 2019, 57.2% e të anketuarve përdornin televizionin për të marrë informacione për aktualitetin, pasuar nga mediat sociale (25.1%), portalet (12.5%), gazetatat (3.4%) dhe radio 1.1%. Vetëm 0.8% e të anketuarve zgjodhën opsionin “tjetër” dhe nuk përdornin asnjë nga mediat e mësipërme.

Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin




Baza: N = 2490

Në vitin 2019, 38.9% e të anketuarve besojnë se informacioni që jepet nga media është i saktë. 33.9% besojnë se informacioni që jepet nga media nuk është i saktë dhe 27.2% thonë se nuk e dinë.

Të anketuarit që raportuan se kishin televizionin si median më të përdorshme për informacion dukeshin se ishin më pak mosbesues për saktësinë e informacionit që jepet nga ky medium krahasuar me ata që përdorin më shumë portalet. P.sh., 44.3% e të anketuarve që përdorin më së shumti TV besojnë se informacioni që jepet nga media është i saktë/vërtetë. 31.8% e të anketuarve që përdorin më së shumti portalet deklaruan se informacioni i dhënë nga media është i saktë.

Figura 9: Perceptimi i saktësisë së informacionit të dhënë, sipas burimit më të përdorur mediatik 2019



Baza: N=2489


Nuk u evidentuan dallime në përdorimin e mediave prej të anketuarve meshkuj dhe femra (Shih Tabela 8 në fund të këtij kapitulli). Gjithsesi, mund të vihen re dallime të qarta kur bëhet fjalë për grupmoshat. Më shumë se gjysma e të anketuarve të rinj në moshë ('18-25 vjeç') përdorin kryesisht mediat sociale (52%) dhe portalet (19%). Si për kontrast, vetëm 1% e të anketuarve në grupmoshën "mbi 65 vjeç" përdornin kryesisht media sociale dhe vetëm 3% merrnin informacion nga portalet. Kjo grupmoshë e të anketuarve përdornin më shpesh televizionin si burim informacioni: 88% e të anketuarve në grupmoshën '18-25 vjeç' deklaruan se përdorin më shumë televizionin.

Numri i lexuesve të gazetave mbetet i ulët tek brezi i të moshuarve, me 5%. Edhe pse përdorimi i gazetave është shumë i ulët, ata të moshës mbi '65 vjeç' i konsiderojnë gazetat si burim kryesor më shumë se brezi i ri, ku vetëm 1% e të anketuarve '18-25 vjeç' raportuan se përdornin gazetat si burim informacioni. E njëjta tendencë vlen edhe për përdorimin e radios si burim informacioni. Mediat sociale dhe portalet përdoren kryesisht nga të anketuarit me arsim universitar ose pasuniversitar apo nga ata që kanë të ardhura mesatare mujore mbi 70,001 lekë. Të anketuarit e zonave rurale thanë se TV është burim kryesor i informacionit për ta. Për një zbrëthim të hollësishëm të përdorimit të medias sipas grupeve demografike, shih Tabelën 8 në fund të këtij kapitulli.

Edhe pse televizioni mbetet burimi më i përdorur për informim për aktualitetin të të anketuarit, ky medium ka regjistruar një rënie të madhe në krahasim me vitin 2017 kur 70% e të anketuarve deklaruan se televizioni ishte mediumi i tyre më i përdorur. Të dhënat nga Sondazhi i Opinioneve të vitit 2019 tregojnë një rritje të përdorimit të mediave sociale nga 18% në 2017 në 25% në 2019. Po ashtu, përdorimi i portaleve është rritur nga 7% në 2018 në 12.5% në 2019.

U vu re edhe një rënie prej 11 p.p. të besueshmërisë së mediave. Rreth 39% e të anketuarve të Sondazhit të Opinioneve 2019 besojnë se informacioni i dhënë nga media është i saktë, krahasuar me 42% dhe 50% në 2018 dhe 2017.

Figura 10: Saktësia e informacionit të dhënë nga mediat 2016–2019



Baza: 2016 (N=1639); 2017 (N=1646); 2018 (N=1643); 2019 (N=2496)

Në diskutimet në fokus grupe pjesëmarrësit e moshës nën 30 vjeç dhe ata me diplomë universitare ose pasuniversitare treguan jo vetëm një nivel të lartë mosbesimi ndaj tre degëve të qeverisjes, por veçanërisht ndaj mediave, të cilat u perceptuan si zëdhënës të aktorëve të fuqishëm ekonomikë dhe politikë.

Ndonëse pranojnë rëndësinë e medias për informim, analizë dhe edukim, pjesëmarrësit në moshë të re dhe ata të mirë-arsimuar vunë re edhe mangësitë e medias në Shqipëri, të tilla si pavarësia e kufizuar dhe cilësia e raportimit të tyre. Siç thekson edhe një pjesëmarrës “Mendoj se jemi shumë konfuz ditët e sotme, sepse nuk dimë kujt t’i besojmë... presim nga media për të vërtetën por më kot. Gjithçka që marrim është më shumë PR, më shumë propagandë në fakt. Në fund të gjithë bëhemi më cinikë dhe më pasivë, asgjë nuk ndryshon.” Pjesëmarrësit raportuan se përdorin përherë e më shumë mediat online por ishin të lodhur nga fenomeni i lajmeve të rreme (fake news) dhe shprehën shqetësime se jo çdokush ka aftësitë, njohuritë dhe teknikat e duhura për të verifikuar përmbajtjen e mediave. Pjesëmarrësit në moshë të re dhe ata të mirë-arsimuar theksuan se mesazhi që përçojnë mediat përforcon cinizmin, mosbesimin dhe ndjenjën e ankthit. Në fakt, rritja e ankthit për të ardhmen mund të vihet re tek të pesë fokus grupet, pavarësisht karakteristikave social-ekonomike, si mosha, arsimi, gjinia apo niveli i të ardhurave.

Tabela 6: Ndaria demografike e besimit, shumatore e “Kam shumë besim” dhe “Kam besim”

	Qeveria qendrore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armato-sura	Partitë politike	Institucionet e shëndetit publik	Institucionet e arsimit publik	Media	Institucio-net fetare	OSHC	BE	OKB	NATO
GJITHSEJ (besimi*)	41%	42%	28%	28%	27%	27%	55%	59%	23%	51%	57%	51%	66%	56%	73%	75%	78%
Gjinia																	
Meshkuj	41%	41%	27%	30%	26%	26%	54%	59%	24%	51%	57%	49%	65%	56%	73%	76%	78%
Femra	42%	43%	28%	28%	28%	29%	55%	60%	21%	51%	58%	53%	67%	56%	74%	74%	78%
Mosha																	
18–25 vjeç	38%	38%	28%	23%	24%	25%	51%	58%	13%	42%	38%	33%	29%	50%	63%	75%	80%
26–35 vjeç	39%	40%	25%	26%	26%	26%	52%	57%	17%	41%	51%	52%	63%	48%	61%	72%	62%
36–45 vjeç	45%	45%	30%	30%	28%	31%	58%	62%	24%	51%	58%	57%	68%	58%	68%	70%	74%
46–55 vjeç	42%	41%	27%	31%	29%	25%	54%	60%	21%	52%	56%	53%	67%	56%	75%	76%	79%
56–65 vjeç	43%	47%	30%	30%	28%	26%	58%	59%	24%	52%	59%	44%	63%	57%	76%	77%	81%
mbi 65 vjeç	43%	48%	27%	38%	35%	33%	60%	65%	23%	52%	57%	51%	66%	56%	73%	75%	78%
Niveli arsimor																	
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	35%	37%	29%	28%	27%	27%	53%	57%	23%	50%	56%	55%	66%	56%	67%	71%	73%
Shkollë të mesme	42%	41%	28%	27%	27%	27%	54%	60%	21%	52%	56%	53%	67%	56%	75%	76%	79%
Diplomë universitare	44%	47%	27%	31%	29%	28%	56%	60%	24%	52%	60%	44%	63%	57%	76%	77%	81%
Statusi i punësimit																	
I/E punësuar	Gjithsej	46%	47%	28%	32%	31%	57%	61%	25%	54%	61%	51%	67%	57%	76%	77%	81%
	Publik	65%	68%	30%	47%	41%	69%	72%	33%	66%	74%	49%	69%	62%	77%	79%	83%
	Privat	40%	40%	28%	27%	28%	54%	58%	22%	50%	57%	51%	65%	56%	74%	76%	79%
I/E papunë	Student	32%	30%	26%	22%	18%	20%	46%	54%	44%	51%	51%	67%	55%	70%	71%	74%
	Pensionist	39%	42%	26%	19%	22%	20%	53%	20%	53%	50%	47%	56%	57%	65%	69%	74%
		42%	44%	31%	34%	32%	58%	61%	27%	52%	58%	55%	67%	57%	75%	79%	80%
Vendbanimi																	
Urban		41%	42%	27%	28%	26%	27%	54%	22%	51%	57%	49%	64%	56%	73%	74%	77%
Rural		43%	43%	29%	31%	31%	28%	58%	24%	53%	59%	55%	71%	58%	76%	79%	81%
Niveli i të ardhurave																	
Nuk kam të ardhura	31%	31%	26%	19%	19%	19%	47%	54%	16%	45%	51%	51%	65%	55%	70%	71%	74%
Deri në 24.000 lekë/muaj	41%	40%	30%	28%	29%	29%	56%	59%	23%	52%	58%	55%	67%	58%	73%	74%	79%
24.001-50.000 lekë/muaj	51%	53%	27%	36%	35%	33%	60%	63%	27%	56%	63%	53%	68%	60%	78%	81%	82%
50.001-70.000 lekë/muaj	50%	50%	28%	33%	34%	34%	61%	64%	30%	55%	64%	55%	70%	55%	77%	79%	81%
Mbi 70.001 lekë/muaj	32%	37%	23%	23%	21%	25%	59%	59%	18%	50%	56%	19%	52%	61%	93%	82%	93%

* Rrumbullakosur në përqindjen më të afërt. Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 7: Ndarja demografike për reformën në drejtësi

		Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi (% 'Po')	Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (% 'Po')
Gjithsej		53%	32%
Gjinia			
Femër		51%	29%
Mashkull		54%	34%
Mosha			
18 - 25 vjeç		53%	26%
26 - 35 vjeç		54%	32%
36 - 45 vjeç		53%	34%
46 - 55 vjeç		50%	30%
56 - 65 vjeç		52%	34%
mbi 65 vjeç		53%	38%
Niveli arsimor			
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar		47%	29%
Shkollë e mesme		51%	32%
Diplomë universitare		59%	33%
Statusi i punësimit			
I/E punësuar	Gjithsej	59%	35%
	Publik	70%	49%
	Privat	54%	30%
I/E papunë		42%	24%
Student		53%	28%
Pensionist		50%	35%
Niveli i të ardhurave			
Nuk kam të ardhura		44%	23%
Deri në 24,000 Lekë		50%	32%
24,001 – 50,000 Lekë		62%	41%
50,001 – 70,000 Lekë		64%	38%
Mbi 70,001 Lekë		49%	20%
Vendbanimi			
Urban		52%	32%
Rural		54%	31%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 8: Ndarja demografike për median

		Burimi më i përdorur mediatik				
		TV	Radio	Gazetat	Portalet	Media sociale
Gjithsej		57%	1%	3%	13%	25%
Gjinia						
Femër		58%	1%	2%	12%	26%
Mashkull		57%	2%	4%	13%	24%
Mosha						
18 - 25 vjeç		27%	0%	1%	19%	52%
26 - 35 vjeç		40%	1%	3%	18%	38%
36 - 45 vjeç		63%	2%	4%	13%	18%
46 - 55 vjeç		79%	1%	4%	7%	8%
56 - 65 vjeç		86%	2%	5%	3%	3%
mbi 65 vjeç		88%	3%	5%	3%	1%
Niveli arsimor						
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar		77%	2%	4%	6%	10%
Shkollë e mesme		61%	1%	3%	11%	23%
Diplomë universitare		39%	1%	4%	18%	38%
Statusi i punësimit						
I/E punësuar	Gjithsej	53%	1%	4%	13%	28%
	Publik	53%	1%	1%	16%	29%
	Privat	52%	1%	4%	13%	29%
I/E papunë		62%	2%	2%	14%	20%
Student		22%	-	1%	19%	58%
Pensionist		88%	3%	5%	2%	2%
Niveli i të ardhurave						
Nuk kam të ardhura		55%	1%	2%	14%	27%
Deri në 24,000 Lekë		70%	1%	4%	7%	16%
24,001 – 50,000 Lekë		54%	1%	3%	13%	29%
50,001 – 70,000 Lekë		42%	1%	6%	17%	34%
Mbi 70,001 Lekë		32%	-	5%	18%	43%
Vendbanimi						
Urban		54%	1%	4%	14%	26%
Rural		65%	1%	3%	8%	23%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve..

4.2 Transparenca dhe llogaridhënia

Transparenca dhe llogaridhënia janë dy parime të rëndësishme të qeverisjes së mirë, e cila nga ana e saj lidhet shpesh me funksionim e duhur të sistemit të demokracisë. Transparenca dhe llogaridhënia forcojnë njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë u bëjnë të mundur qytetarëve të ndikojnë në procesin vendimmarrës dhe t'u kërkojnë llogari pushtetarëve. Si transparenca ashtu edhe llogaridhënia janë pjesë e Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së (OKB, OZHQ 2019); në mënyrë më specifike 'Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësinë për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet' dhe 'Objektivi 16.6.: Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet'.

Në themel të konceptit të transparencës është supozimi kryesor se qeveria vepron në mënyrë të hapur. Kjo përfshin ndër të tjera transparencën e qeverisë për mënyrën si vepron, për veprimtarinë dhe shpenzimet e saj, për operacionet e saj dhe për vendimet që merr. Element kyç i transparencës është e drejta për akses tek informacioni që është në pronësi të autoriteteve publike. Megjithatë, transparenca përfshin edhe elementë të tjerë, si ofrimi i mundësive që takimet e institucioneve publike vendimmarrëse të jenë të hapura për publikun.¹³

Llogaridhënia presupozon se qeveria duhet të marrë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e saj. Llogaridhënia ka dy dimensionë: përgjegjësia për t'u përgjigjur – ose detyrimi i autoriteteve publike për t'i dhënë informacion dhe shpjegime publikut në lidhje me veprimtaritë e tyre; dhe zbatimi ose mekanizmat, me anë të të cilave merret informacioni nëpërmjet përgjegjësisë për t'u përgjigjur, mund të bëhen efikase në sigurimin e llogaridhënies. Kjo e fundit mund të jetë vertikale – drejtpërdrejtë me publikun – ose horizontale – mundësohet nëpërmjet mekanizmave që veprojnë ndërmjet institucioneve publike.¹⁴

Pyetjet për transparencën dhe llogaridhënien në Sondazhin e Opinioneve të vitit 2019 janë të njëjtat si ato të vitit 2018, me një shtesë: në vitin 2019, të anketuarve u kërkuar që të shprehin mendimin e tyre në lidhje me rolin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në llogaridhënien e qeverisë.

• • • • •

13 Shpjegimi i koncepteve bazohet kryesisht në kumtesën “Standardet Ndërkombëtare për Transparencën dhe Llogaridhënien”. Qendra për Ligj dhe Demokraci (2014). Marrë nga adresa http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_Mar14.pdf


14 Po aty.

Transparenca

Të dhënat nga Sondazhi i vitit 2019 tregojnë një rënie të nivelit të praktikave të perceptuara të transparencës në nivel qendror ashtu edhe vendor. Megjithatë, qeveria vendore priret të perceptohet si paksa më transparente se institucionet e qeverisë qendrore.

Në 2019, të anketuarit në përgjithësi nuk ishin dakord (46.1%), ose aspak dakord (18.6%) se qeveria qendrore është transparente, ndërsa 41.9% në përgjithësi nuk ishin dakord, dhe 20.2% nuk ishin aspak dakord se bashkitë janë transparente.

Figura 11: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2019



Baza: Për qeverinë qendrore (N = 2492), për qeverinë vendore (N = 2489)

Krahasimi social-demografik i perceptimit të transparencës

Shqiptarët e rinj në moshë e konsiderojnë qeverinë qendrore dhe vendore si më pak transparente në krahasim me brezin e të moshuarve. Shqiptarët e mirë-arsimuar apo ata që kanë nivel më të lartë të ardhurash e perceptojnë

qeverinë qendrore dhe vendore si më pak transparente në krahasim me ata që punojnë në sektorin publik. Një numër i vogël të anketuarish që nuk kanë të ardhura e perceptojnë qeverinë qendrore dhe vendore si transparente.

Kur bëjmë krahasim mes grupeve demografike (shih Tabela 10 në fund të këtij kapitulli), të dhënat tregojnë se perceptimet e të anketuarve për transparencën e qeverisë ndryshojnë mes meshkujve dhe femrave. Të anketuarit meshkuj raportuan një përqindje më të lartë të perceptimit të transparencës (36%) për qeverinë qendrore krahasuar me të anketuarit femra (27%). Megjithatë, nuk ka dallime të mëdha për perceptimin e transparencës së qeverisë vendore mes të anketuarve meshkuj dhe femra.

Për sa i përket dallimeve sipas grupmoshave, vetëm 27% e të anketuarve të grupmoshës 18-25 vjeç dhe 31% e atyre në grupmoshën 26-35 vjeç ishin dakord se qeveria qendrore është transparente. Ndërsa të anketuarit në moshë më të madhe, veçanërisht ata që i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç, prireshin ta perceptonin qeverinë në të dy nivelet si transparente, me 43% dhe 40% përkatësisht, të cilët ishin dakord se qeveria qendrore dhe qeveria vendore janë transparente.

Për sa i përket nivelit arsimor dhe perceptimit të transparencës, sondazhi i vitit 2019 tregon se të dy nivelet e qeverisjes perceptohen si transparente nga një numër i vogël njerëzish. Vetëm 37% e atyre të anketuar me diplomë universitare ishin dakord se qeveria qendrore është transparente dhe 39% ishin dakord se qeveria vendore është transparente.

Parë nga këndvështrimi i statusit të punësimit, vetëm 26% e të anketuarve të papunë besonin në përgjithësi se qeveria qendrore është transparente dhe vetëm 29% besonin kryesisht se qeveria vendore është transparente. Ndërkohë që të anketuarit në marrëdhënie pune në përgjithësi prireshin të perceptonin të dy nivelet e qeverisjes si transparente, ata në sektorin publik janë më shumë të prirur të besojnë një gjë të tillë, ku 54% thonë se janë dakord që qeveria qendrore është transparente dhe 57% besojnë se qeveria vendore është transparente. Nuk ka dallime të konsiderueshme në perceptimin e transparencës së qeverisë qendrore e vendore kur krahasojmë të anketuarit nga zonat urbane dhe ato rurale.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave, të dhënat tregojnë se të anketuarit pa të ardhura (255) dhe ata me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë (27%) e perceptojnë qeverinë qendrore si më pak transparente krahasuar me të anketuarit me të ardhura mujore 50,001–70,000 Lekë (43%) dhe ata me të ardhura 24,001–50,000 lekë në muaj (41%). E njëjta prirje vihet re edhe për perceptimet për qeverinë vendore: të anketuarit pa të ardhura (26%) apo me nivel më të lartë të ardhurash (30%) priren ta perceptojnë qeverinë vendore si më pak transparente në krahasim me të anketuarit e grupit me të ardhura mujore 50,001–70,000 lekë (43%) dhe ata me të ardhura 24,001–50,000 lekë (43%).

- Në lidhje me transparencën e institucioneve publike, të anketuarit që vijnë nga zonat rurale dhe që morën pjesë në fokus grupe evidentuan një trend pozitiv në transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore, por theksuan në mënyrë të veçantë përpjekjet e qeverisë vendore në këtë drejtim, si rritja e informacionit që ofrohet në faqet e internetit të bashkive apo mediat lokale, organizimin e takimeve konsultuese dhe dëgjësave publike në këshillat

bashkiakë. Shembuj konkretë që u dhanë nga pjesëmarrësit që punojnë me organizata të shoqërisë civile apo me biznese të reja u raportuan disa forma me anë të të cilave fushatat e advokacisë kanë ndihmuar në përmirësimin e shërbimeve që ofrohen nga pushteti vendor dhe në rritjen e presionit ndaj kryetarëve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë për të qenë më transparentë.


Edhe pse pjesëmarrësit e fokus grupeve me arsim universitar apo pasuniversitar evidentuan po ashtu disa ndryshime pozitive për sa i përket transparencës, të mundësuar veçanërisht me përdorimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, ata ende deklaruan se “niveli i zhgënjimit të publikut është i lartë dhe masat që janë marrë për trajtimin e zhgënjimit janë të pakta.” Zhgënjimi i publikut shoqërohej kryesisht me nivelin e perceptuar të korrupsionit të zyrtarëve publikë dhe politikanëve, gjë që kontribuon në nivelin e ulët të besimit.

Transparenca në vite

Qeverisja në Shqipëri, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, ka shfaqur rënie të nivelit të transparencës së perceptuar në katër vitet e fundit, ku qeveria qendrore perceptohet si më pak transparente sesa qeveria vendore. Krahësuar me vitet e mëparshme, ka pasur një rënie të perceptimit për transparencën e tyre: -6 p.p. për qeverinë qendrore dhe -7 p.p. për qeverinë vendore gjatë periudhës 2016 - 2019.

Ka një rënie prej 6 p.p. të nivelit të perceptuar të transparencës së qeverisë qendrore nga 2016 në 2019. Nga ana tjetër, ka një rënie prej 8 p.p. të transparencës së qeverisë vendore nga 2017 në 2019.

Figura 12: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2019



Baza: 2016, qeveria qendrore (N = 1647) dhe qeveria vendore (N = 1645); 2017, qeveria qendrore (N = 1636) dhe qeveria vendore (N = 1637); 2018, qeveria qendrore (N = 1644) dhe qeveria vendore (N = 1642); 2019, qeveria qendrore (N = 2492) dhe qeveria vendore (N = 2489).

Ushtrimi i të drejtës për informim

Edhe pse pjesa më e madhe e shqiptarëve (66.7%) janë të informuar për ligjin e të drejtës për informim, vetëm 19.9% e atyre që e kanë përdorur atë në të vërtetë gjatë vitit 2019. Shqiptarët me diplomë universitare, ata të punësuar në sektorin publik, ose ata me nivel të lartë të ardhurash duket se kanë më shumë gjasa të jenë të informuar për ligjin e të drejtës për informim. Tendencat e kërkesave të dërguara për informacion ruajtën një numër të ngjashëm gjatë gjithë periudhës 2016–2019. Ndërsa tendencat e marrjes së informacionit të kërkuar kanë shënuar një rënie prej 11 p.p. nga 2016 në 2019.


Një element kryesor për transparencën është aksesimi në informacion që gjendet te autoritetet publike, të rregulluara tashmë me Ligjin Nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”. Ushtrimi i së drejtës për informim bazohet në dy dimensionë: ndërgjegjësimi i qytetarëve për të drejtën e tyre për të marrë informacione dhe paraqitja nga ana e tyre e një kërkesë për informacion.

Në vitin 2019, 66.7% e anketuarit kishin dijeni se e drejta për informim garantohet me ligj në Shqipëri, ndërkohë që 33.3% thanë se nuk kishin informacione për këtë ligj. Nuk pati diferenca të mëdha sipas gjinisë në lidhje me ndërgjegjësimin për këtë ligj. Megjithatë, dallimi evidentohet kur krahasohen grupmoshat: 71% e të anketuarve të grupmoshës 18-25 vjeç dhe 73% e të anketuarve të grupmoshës 26-35 vjeç thanë se kishin informacion për këtë ligj, ndërsa vetëm 52% e të anketuarve të grupmoshës mbi 65 vjeç thanë se kishin dijeni për këtë ligj.

Po ashtu, 77% e atyre me arsim universitar ose pasuniversitar deklaruan se ishin të informuar për Ligjin për të Drejtën e Informimit, krahasuar me 52% të atyre me arsim deri 9-vjeçar.¹⁵ Shumica dërmuese (78%) e të anketuarve që punojnë në sektorin publik ishin të informuar për këtë ligj në krahasim me 71% të atyre që punojnë në sektorin privat. 58% e të anketuarve me të ardhura mujore deri në 24,000 lekë kishin dijeni për të drejtën e informimit në krahasim me 80% të të anketuarve me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë. Gjithashtu, njerëzit që banojnë në zonat rurale (61%) janë më pak të informuar për këtë ligj krahasuar me të anketuarit që jetojnë në zonat urbane (69%).

.....

15 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Figura 13: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2019

Baza: $N = 2491$

Ligji “Për të drejtën e informimit” përcakton se çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë arsyet. Procedura kërkon që kërkesa për informim të bëhet me shkrim dhe të dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuar dhe nënshkrimin e tij. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj (Ligji Nr. 119/2014).


Të anketuarit që ishin të informuar për Ligjin “Për të drejtën e informimit” u pyetën më tej nëse e kishin ushtruar të drejtën për të marrë informacione publike gjatë vitit 2019. Vetëm 19.9% e të anketuarve të informuar për këtë të drejtë thanë se kishin bërë një kërkesë tek autoritetet publike. Ndërkohë, 59.3% e atyre që thanë se kishin bërë kërkesë për informacion deklaruan se e kishin marrë informacionin e kërkuar.

Nuk ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes gjinive për sa i përket kërkesave për informim drejtuar një institucioni publik në 2019. Nga pikëpamja e grupmoshave, të dhënat tregojnë se të anketuarit e rinj në moshë janë më të predispozuar të bëjnë kërkesë për informim me 24% të të anketuarve në grupmoshën 26-35 vjeç, të cilët deklaruan se kishin bërë një kërkesë për informim, ndërkohë që vetëm 14% e të anketuarve të grupmoshës mbi 65 vjeç kishin bërë një kërkesë të tillë. Po ashtu, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar kanë përdorur Ligjin “Për të drejtën e informimit” duke bërë një kërkesë për informacion tek institucionet publike në 2019 më shpesh (26%) se të anketuarit me nivel arsimor deri në arsim 9-vjeçar (12%).

Plot 33% e të anketuarve që punojnë në sektorin publik thanë se kishin bërë kërkesë për informim dhe 79% e atyre që thanë se kishin bërë kërkesë deklaruan se e kishin marrë informacionin që kishin kërkuar krahasuar me 19% të të anketuarve nga sektori privat që deklaruan se kishin bërë kërkesë dhe nga të cilët vetëm 62% e kishin marrë informacionin e


kërkuar. Parë nga niveli i të ardhurave mujore, të anketuarit pa të ardhura rrallëherë kishin bërë ndonjë kërkesë për informim: vetëm 17% kishin bërë një kërkesë në 2019 krahasuar me 41% të të anketuarve me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë. Duhet theksuar, gjithsesi, se vetëm 47% e të anketuarve pa të ardhura raportuan se e kishin marrë informacionin e kërkuar përkundër 94% të të anketuarve me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë që thanë se e kishin marrë informacionin e kërkuar.

Figura 14: Kërkesat për informacion të dërguara (2019)



Baza: N = 491

Figura 15: Marrja e informacionit të kërkuar (2019)




Baza: N = 479

Nukekzistojnë dallime të konsiderueshme për sa i përket marrjes së informacionit të kërkuar. Analizuar sipas grupmoshave, të rinjtë ishin më të prirur për të marrë informacionin e kërkuar krahasuar me grupet në moshë më të madhe: 68% e të anketuarve të grupmoshës 26-35 vjeç thanë se e kishin marrë informacionin që kishin kërkuar krahasuar me më pak se gjysmën e të anketuarve të grupmoshës mbi 64 vjeç (46%). Për sa i përket nivelit arsimor, 45% e të anketuarve me arsim deri 9-vjeçar thanë se e kishin marrë informacionin që kishin kërkuar krahasuar me ata me arsim universitar ose pasuniversitar (67%). Për më tepër, 79% e të anketuarve në sektorin publik thanë se e kishin marrë informacionin e kërkuar krahasuar me 62% e atyre që punojnë në sektorin privat. Po ashtu, të anketuarit që ishin anëtarë të partive politike duket se kishin më shumë gjasa për të marrë informacionin e kërkuar (69%) krahasuar me të anketuarit që nuk ishin anëtarë të partive politike (57%).

Gjetjet nga diskutimet në fokus grupe treguan se paraqitja e kërkesave për informim lidhej me besimin tek institucionet. Pjesëmarrësit që kishin dijeni për Ligjin “Për të drejtën e informimit”, veçanërisht ata të mirë-arsimuar, nxorën në pah se nuk bënë kërkesa për informacion sipas parashikimeve të ligjit, sepse nuk kishin besim se institucioni do t’u jepte atyre informacionin e kërkuar. Një nga pjesëmarrësit tha: *“I kam bërë një kërkesë për informim drejtorisë rajonale të arsimit para disa muajsh në lidhje me njohjen e shkollës që kam bërë jashtë, madje edhe Ministrisë, por nuk kam marrë përgjigje dhe nuk pres përgjigje në fakt. Më duhet të gjej ‘mik nga brenda’ për të më ndihmuar me këtë gjë.”*

Siç mund të vihet re edhe nga ky shembull, pjesëmarrësit nuk mund të bëjnë dallimin mes paraqitjes së kërkesës për informim sipas dispozitave ligjit të dhe aplikimit për një shërbim publik ose administrativ. Gjithsesi, përvojat personale që u treguan nga pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet e identifikojnë se në disa raste, informimi i kufizuar për mënyrën e bërjes së një kërkesë për informim dhe marrjes së informacionit nga institucionet publike në përgjithësi është një nga faktorët e vonësive, sorollatjeve dhe në fund e mosmarrjes së informacionit të kërkuar - duke përforcuar kështu zhgënjimin me institucionet dhe përfundimisht mungesën e besimit tek to.

Tendencat për dorëzimin e kërkesave për informacion ruajtën të njëjtin ritëm gjatë gjithë periudhës 2016-2019. Ndërkohë, tendencat e marrjes së përgjigjeve dhe informacionit të kërkuar kanë rënë nga 70% në 2016 në 59% në 2019, me një rënie prej 11 pikë përqindje.


Figura 16: Bënë kërkesë për informacion dhe morën informacionin e kërkuar 2016–2019

Baza: Për dërgimin e kërkesave për informim 2016 (N = 935); 2017 (N = 962); 2018 (N = 979); 2019 (N = 491). Për marrjen e informacionit të kërkuar 2016 (N = 238); 2017 (N = 205); 2018 (N = 186); 2019 (N = 479)

Llogaridhënia

Plot 36.7% e shqiptarëve e perceptojnë qeverinë vendore si të përgjegjshme (që jep llogari) dhe 32.8% thanë se e perceptojnë qeverinë qendrore si të përgjegjshme. Shqiptarët me arsim universitar apo ata të punësuar në sektorin publik shpesh e perceptojnë qeverinë si të përgjegjshme krahasuar me grupet e tjera demografike.

Në përgjithësi, të anketuarit e konsiderojnë qeverinë qendrore dhe vendore si të papërgjegjshme, edhe pse një përqindje pak më e madhe e popullatës së anketuar (36.7%) i konsiderojnë bashkitë si të përgjegjshme krahasuar me perceptimin që kanë për qeverinë qendrore (32.8%). Në vitin 2019, 61.3% e të anketuarve në përgjithësi nuk ishin dakord ose aspak dakord se bashkitë japin llogari dhe 65.3% e tyre thanë se përgjithësisht nuk ishin dakord ose aspak dakord se qeveria qendrore jep llogari.

Figura 17: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2019

Baza: Për qeverinë qendrore, $N = 2491$, Për qeverinë vendore, $N = 2485$

Ndarja demografike e përgjigjeve të sondazhit të vitit 2019 (shih Tabela 10 në fund të këtij kapitulli) nuk tregon ndonjë dallim të konsiderueshëm mes gjinive apo vendbanimit të të anketuarve në lidhje me perceptimin e tyre për llogaridhënien e qeverisë qendrore dhe vendore. Ka një dallim të vogël në këtë perceptim mes grupmoshave të të rinjve që janë më pak të prirur të besojnë se qeveria qendrore jep llogari: 28% e të anketuarve të grupmoshës '18–25 vjeç' dhe 31% në grupmoshën '26–35 vjeç' që thanë se qeveria qendrore është e përgjegjshme (jep llogari) krahasuar me të anketuarit në grupmoshën 'mbi 65 vjeç' (40%). Gjithsesi, nuk ka dallime të mëdha mes grupmoshave për perceptimin e llogaridhënies së qeverisë vendore.

Kur i shohim shifrat sipas nivelit arsimor të përgjigjedhënësve, 36% e të anketuarve me arsim universitar e konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme krahasuar me 30% të atyre me arsim deri 9-vjeçar.¹⁶ Nuk vihen re diferenca të mëdha në lidhje me llogaridhënien e perceptuar të qeverisë vendore tek të anketuarit me nivele të ndryshme arsimore.

• • • • •

16 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Për sa i përket statusit të punësimit, të anketuarit në marrëdhënie pune dhe ata në pension ishin më të prirur ta perceptonin qeverinë qendrore e vendore si të përgjegjshme krahasuar me të anketuarit e papunë. Vetëm 24% e të anketuarve që ishin të papunë thanë se e konsiderojnë qeverinë qendrore si të përgjegjshme (që jep llogari) krahasuar me të anketuarit në marrëdhënie pune (37%) dhe pensionistët (37%). Po ashtu, ata që punojnë në sektorin publik priren ta perceptojnë qeverinë qendrore dhe vendore si të përgjegjshme krahasuar me ata që punojnë në sektorin privat.

Të anketuarit pa të ardhura dukej se e perceptojnë qeverinë qendrore dhe vendore si të papërgjegjshme, ku vetëm 24% deklarojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 27% thonë se pushteti vendor është i përgjegjshëm. Këto vlerësime janë më të ulëta se vlerësimi i përgjithshëm i popullatës së anketuar. Gjithashtu, të anketuarit me nivel më të lartë të ardhurash (mbi 70,001 lekë në muaj) e perceptuan qeverinë qendrore dhe vendore si të papërgjegjshme: vetëm 25% deklarojnë se qeveria qendrore është e përgjegjshme dhe 27% thonë se pushteti vendor është i përgjegjshëm. Plot 41% e të anketuarve me të ardhura mujore 24,001 – 50,000 lekë në muaj e perceptojnë qeverinë qendrore si transparente dhe të përgjegjshme. Ndërsa, 41% e të anketuarve me të ardhura mujore 24,001 – 50,000 lekë e perceptojnë qeverinë vendore si transparente dhe 44% mendojnë se qeveria vendore jep llogari.

Për sa i përket llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore, të rinjtë (pjesëmarrës në fokus grupin e moshës nën 30 vjeç) nuk kanë evidentuar ndonjë progres të madh në këtë drejtim. Gjithsesi, këta pjesëmarrës pranuan se kishin mungesë informacioni në lidhje me aksesin te proceset e vendimmarrjes vendore dhe se perceptimi i tyre bazohej kryesisht në mendimin e përgjithshëm të publikut se “si pushteti qendror ashtu edhe ai vendor nuk japin llogari para votuesve dhe qytetarëve, por mendojnë vetëm për ‘xhepin’ e tyre”, siç tha një nga pjesëmarrësit. Pjesëmarrës në moshë të re dhe të mirë-arsimuar theksuan se ndjekin profilet e ministrave, kryetarëve të bashkive dhe figurave të tjera politike në mediat sociale, por theksuan se këto platforma nuk janë mënyra e duhur për të komunikuar çështje serioze të politikave në nivel vendor dhe qendror, përkundrazi, siç theksoi edhe një pjesëmarrës “bëhet thjesht për të qenë në modë dhe trendy në internet, por jo për të dhënë llogari”.


Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore 2016–2019

Që nga viti 2016, përqindja e shqiptarëve që e perceptojnë qeverinë vendore si të përgjegjshme ka rënë me 12 p.p. në 31% në vitin 2019. Për qeverinë qendrore, përqindja u rrit në vitin 2017, por ra që prej atij viti me 8 p.p. në 31% në vitin 2019.

Të dhënat tregojnë për një ndryshim në perceptimin e llogaridhënies për periudhën 2016-2019. Për pushtetin vendor ka pasur një rënie të përgjithshme të perceptimit për

llogaridhënien me 12 pikë përqindje. Në vitin 2016, 43% e të anketuarve e konsideronin qeverinë vendore si të përgjegjshme, ndërsa në 2019 vetëm 31% e të anketuarve kishin të njëjtin mendim. Edhe perceptimi për llogaridhënien e qeverisë qendrore ka rënë nga 36% në 2016 në 31% në 2019. Vetëm në vitin 2017 u vu re një rritje prej 3 p.p. në perceptimin e llogaridhënies së qeverisë qendrore, por kjo u pasua më tej nga një rënie me 5 p.p. në 2018 dhe një tjetër rënie prej 3 p.p. në 2019.

Figura 18: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies (2016–2019)




Baza: 2016, qeveria qendrore (N = 1646) dhe qeveria vendore (N = 1645); 2017, qeveria qendrore (N = 1635) dhe qeveria vendore (N = 1633); 2018, qeveria qendrore (N = 1644) dhe qeveria vendore (N = 1643); 2019, qeveria qendrore (N = 2491) dhe qeveria vendore (N = 2485).

Llogaridhënia horizontale dhe vertikale

Shqiptarët besojnë se mekanizmi më efikas i llogaridhënies është Kontrolli i Lartë i Shtetit (63.7%), i ndjekur nga Parlamenti (53.4%), Avokati i Popullit (44.3%) dhe partitë e opozitës (42%). 42.6% besojnë se deputetë të caktuar mund t'i kërkojnë llogari qeverisë. Për sa i përket llogaridhënies vertikale, media (58%) u perceptua se luante rolin më të madh në llogaridhënien e qeverisë, ndjekur nga shoqëria civile (47.8%). Shumica dërmuese e qytetarëve shqiptarë besojnë se organizatat ndërkombëtare (78.9%) i kërkojnë llogari qeverisë shumë më tepër se organizatat vendase.

Llogaridhënia mund të klasifikohet sipas llojit të kërkesës së llogarisë që bëhet dhe/ose personit, grupit apo institucionit para të cilit përgjigjet zyrtari publik dhe këto mund të grupohen më tej në dy forma kryesore: llogaridhënia horizontale dhe llogaridhënia vertikale. Llogaridhënia horizontale ka të bëjë me kapacitet e institucioneve shtetërore (si parlamenti dhe gjyqësori) për të mbikëqyrur politikat e qeverisë duke i kërkuar asaj informacione, duke kontrolluar zyrtarët dhe duke ndëshkuar shkeljet apo sjelljet e gabuara. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale ka të bëjë me instrumentet me të cilat qytetarët, masmedia, dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë nga zyrtarët e qeverisë.

Figura 19: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmeve të llogaridhënies horizontale dhe vertikale (2019)



Baza: Parlamenti (N = 2485); KLSH (N = 2485); Partitë opozitare (N = 2481); Avokati i Popullit (N = 2478); Komisioneri për të Drejtën e Informimit (N = 2485); Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (N = 2485); Deputetë të veçantë (individualisht) (N = 2484)

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) vazhdon të konsiderohet si institucioni me rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (63.7%), ndjekur nga Parlamenti (53.4%), Avokati i Popullit (44.3%), partitë opozitare (42%), Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (40.9%), dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (38.9%). Më shumë se gjysma e të anketuarve (53.8%) besonin se deputetë të caktuar e bëjnë qeverinë të japë llogari.

Nuk ekzistojnë diferenca të mëdha në perceptimin e llogaridhënies horizontale mes meshkujve dhe femrave të anketuar në këtë sondazh (shih Tabela 11 në fund të këtij kapitulli). Megjithatë, të anketuarit në grupmoshën ‘mbi 65 vjeç’ mendonin se deputetë të veçantë kishin më shumë gjasa t’i kërkonin llogari qeverisë (52%) krahasuar me të anketuarit më të rinj në moshë në grupmoshën ‘18–25 vjeç’ (38%). E njëjta tendencë mund të vihet re kur bie fjala për rolin e partive të opozitës. Një përqindje më e lartë e të anketuarve të grupmoshës ‘mbi 65 vjeç’ (46%) mendonin se partitë e opozitës janë më shumë të prirura për t’i kërkuar llogari qeverisë, krahasuar me të anketuarit në grupmoshën ‘18–25 vjeç’ (36%). Vetëm 41% e atyre me arsim universitar apo pasuniversitar besonin se partitë e opozitës i kërkonin llogari qeverisë, krahasuar me 46% të atyre me arsim deri 9-vjeçar.¹⁷


Të anketuarit me arsim universitar ose pasuniversitar mendonin se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (43%) dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (44%) mund t’i kërkojnë llogari qeverisë. 39% e atyre me arsim deri 9-vjeçar janë të mendimit se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mund t’i kërkojnë llogari qeverisë.

Më shumë se gjysma e të anketuarve në marrëdhënie pune (55%) besojnë se Parlamenti i kërkon llogari qeverisë, ndërsa vetëm 48% e të anketuarve të papunë deklaruan të njëjtën gjë. Një pjesë më e vogël e të anketuarve të papunë (55%) besuan se Kontrolli i Lartë i Shtetit mund të bëjë që qeveria të japë llogari në krahasim me të anketuarit e punësuar (67%) dhe perceptimin e të gjithë popullatës së anketuar (63.7%).

Sa i përket mekanizmave të llogaridhënies vertikale, media u perceptua se kishte rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (58%), e ndjekur nga shoqëria civile (47.8%). Më pak se gjysma e të anketuarve thanë se sindikatat (41.1%) dhe bizneset (39.5%) i kërkonin llogari qeverisë. Shumica dërmuese e qytetarëve shqiptarë besojnë se organizatat ndërkombëtare (78.9%) i kërkojnë llogari qeverisë.

• • • • •

17 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Figura 20: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale (2019)

Baza: Media (N = 2485); Bizneset (N = 2483); Sindikatat (N = 2484); Organizatat e shoqërisë civile (N = 2482); Organizatat ndërkombëtare (N = 2484)

Gratë (60%) priren ta perceptojnë më shumë rolin e medias në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë krahasuar me burrat (56%) (shih Tabela 11). Më shumë se gjysma e të anketuarve në secilin grupmoshe besonin se media mund ta bëjë qeverinë të japë llogari, me një numër më të vogël të anketuarish (54%) në grupmoshën ‘18–25 vjeç’ që besojnë një gjë të tillë krahasuar me të anketuarit e grupmoshës ‘mbi 65 vjeç’ (62%).

Shumica e të anketuarve në secilin grup dhe nivel arsimor besonin se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë. Plot 82% e të anketuarve me arsim universitar ose pasuniversitar besonin se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë. 46% e atyre me arsim deri 9-vjeçar¹⁸ besonin se organizatat e shoqërisë civile i kërkojnë llogari qeverisë, ndërsa 39% e atyre me arsim universitar ose pasuniversitar kishin të

• • • • •

18 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

njëtin perceptim. Të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më të prirur të besonin se OSHC-të (53%) dhe media (62%) ishin në gjendje të bënin që qeveria të tregonte përgjegjshmëri.

Plot 57% e të anketuarve me të ardhura mujore 50,001–70,000 lekë besojnë se Parlamenti mund të bëjë që qeveria të japë llogari krahasuar me 47% e të anketuarve pa të ardhura. Ndërkohë, 45% e të anketuarve me këtë nivel të ardhurash besonin se partitë e opozitës mund t'i kërkojnë llogari qeverisë krahasuar me 38% e të anketuarve pa të ardhura.

Me kalimin e viteve, KLSH vazhdon të perceptohet si institucioni që është në gjendje t'i kërkojë llogari qeverisë më shumë se institucionet e tjera në vend. KLSH ndiqet nga media sipas mendimit të më shumë se gjysmës së të anketuarve që thonë se kjo media është në gjendje të bëjë që qeveria të japë llogari, ndonëse roli i saj ka rënë me 7 p.p. që nga viti 2017.

Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies (2016–2019)

	2016	2017	2018	2019
KLSH	63%	67%	61%	64%
Media	62%	65%	58%	58%
Avokati i Popullit	54%	55%	59%	44%
Parlamenti	51%	63%	54%	54%
Partitë opozitare	51%	54%	43%	42%
Organizatata e Shoqërisë Civile	46%	51%	49%	48%
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	46%	45%	44%	41%
Bizneset	43%	44%	40%	39%
Sindikatat	39%	46%	42%	41%
Deputetë të veçantë (individualisht)	X	X	X	44%
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	X	X	X	39%
Organizatata Ndërkombëtare	X	X	X	79%

Në përgjithësi, pjesëmarrësit nga grupe të ndryshme demografike që morën pjesë në diskutimet në fokus grupe argumentuan se institucionet ndërkombëtare kanë qenë në gjendje t'i kërkojnë llogari qeverisë. Një nga pjesëmarrësit në fokus grupin “mbi 55 vjeç” tha se: “Politikanët tanë as që duan t’ia dinë për ne, për qytetarët, se çfarë mendojnë ata. Ata e dinë që ne gjithësesi i votojmë, se kështu kemi bërë përherë, sepse jemi të varfër dhe të pashpresë. Por mendoj se shqetësohen pak kur vjen puna të ‘ndërkombëtarët’, kështu që nëse ka ndonjë mundësi mbetet vetëm komuniteti ndërkombëtar për të bërë diçka për ne.” Megjithatë, pjesa më e madhe e pjesëmarrësve iu referua më shumë politikanëve sesa zyrtarëve publikë kur diskutonin për mungesën e llogaridhënies publike.

Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien (2019)

	Qeveria qendrore është transparente	Bashkia ime është transparente	Qeveria qendrore është e përgjegjshme (jep llogari)	Bashkia është e përgjegjshme (jep llogari)
Gjithsej	33.4%	35.9%	32.8%	36.7%
Gjinia				
Femra	31%	35%	32%	36%
Meshkuj	35%	37%	34%	37%
Mosha				
18–25 vjeç	27%	30%	28%	33%
26–35 vjeç	31%	33%	31%	35%
36–45 vjeç	36%	40%	36%	38%
46–55 vjeç	33%	38%	32%	40%
56–65 vjeç	39%	39%	35%	39%
mbi 65 vjeç	43%	40%	40%	39%
Niveli arsimor				
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	30%	35%	30%	37%
Shkollë e mesme	33%	34%	32%	35%
Diplomë universitare	37%	39%	36%	39%
Statusi i punësimit				
I/E Gjithsej punësuar	36%	40%	37%	41%
Publik	54%	57%	55%	58%
Privat	30%	34%	31%	35%
I/E papunë	26%	29%	24%	29%
Student	30%	26%	30%	32%
Pensionist	40%	39%	37%	38%
Niveli i të ardhurave				
Nuk kam të ardhura	25%	26%	24%	27%
Deri në 24,000 Lekë	34%	38%	33%	38%
24,001–50,000 Lekë	41%	43%	41%	44%
50,001–70,000 Lekë	43%	43%	43%	43%
Mbi 70,001 Lekë	27%	30%	25%	27%
Vendbanimi				
Urban	33%	35%	33%	36%
Rural	34%	39%	33%	38%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferenat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale

	Parlamenti	Deputetë të veçantë (individualisht)	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Partitë opozitare	Avokati i Popullit	Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Organizatat e shoqërisë civile	Media	Bizneset	Sindikatat	Organizatat ndërkombëtare
Gjithsej (% që kërkojnë llogari)	53.4%	43.6%	63.7%	42.0%	44.3%	38.9%	40.9%	47.8%	58%	39.5%	41.1%	78.9%
Gjinia												
Femra	53%	43%	66%	42%	45%	39%	41%	47%	60%	39%	42%	80%
Meshkuj	53%	44%	62%	42%	44%	38%	41%	49%	56%	40%	40%	78%
Mosha												
18-25 vjeç	49%	38%	62%	36%	39%	37%	42%	51%	54%	38%	42%	76%
26-35 vjeç	51%	41%	63%	40%	41%	41%	43%	45%	55%	38%	40%	80%
36-45 vjeç	57%	47%	64%	43%	49%	39%	40%	50%	62%	40%	40%	79%
46-55 vjeç	54%	43%	65%	49%	50%	39%	39%	46%	58%	42%	43%	80%
56-65 vjeç	55%	48%	61%	43%	41%	38%	36%	48%	61%	40%	39%	78%
mbi 65 vjeç	58%	52%	70%	46%	51%	39%	46%	48%	62%	40%	43%	82%
Niveli arsimor												
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	52%	43%	59%	46%	42%	39%	39%	46%	61%	41%	47%	79%
Shkollë e mesme	52%	42%	64%	41%	46%	36%	40%	48%	57%	39%	39%	76%
Diplomë universitare	56%	46%	67%	41%	43%	43%	44%	49%	57%	39%	40%	82%

	Parlamenti	Deputetë të veçantë (individualisht)	Kontrolli i Lartë i Shtetit	Partitë opozitare	Avokati i Popullit	Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Organizatat e shoqërisë civile	Media	Bizneset	Sindikatat	Organizatat ndërkombëtare
Gjithsej (% që kërkojnë llogari)	53.4%	43.6%	63.7%	42.0%	44.3%	38.9%	40.9%	47.8%	58%	39.5%	41.1%	78.9%
Statusi i punësimit												
I/E punësuar	55%	45%	67%	43%	47%	41%	42%	50%	60%	42%	42%	81%
Publik	68%	55%	77%	50%	53%	49%	50%	53%	62%	48%	46%	83%
Privat	51%	42%	65%	40%	43%	38%	40%	47%	57%	41%	40%	80%
I/E papunë	48%	40%	55%	39%	41%	35%	36%	43%	55%	33%	38%	76%
Student	53%	38%	63%	40%	38%	35%	42%	50%	49%	34%	41%	73%
Pensionist	57%	49%	65%	47%	48%	42%	45%	48%	66%	43%	44%	80%
Niveli i të ardhurave												
Nuk kam të ardhura	47%	38%	55%	38%	40%	34%	36%	44%	54%	33%	38%	76%
Deri në 24,000 Lekë	54%	44%	65%	46%	45%	41%	45%	49%	60%	40%	45%	79%
24,001–50,000 Lekë	58%	48%	70%	44%	48%	43%	43%	51%	61%	45%	42%	80%
50,001–70,000 Lekë	57%	54%	69%	45%	49%	45%	45%	51%	57%	41%	43%	86%
Mbi 70,001 Lekë	43%	32%	66%	41%	43%	41%	32%	48%	55%	37%	41%	82%

* Grupi “me nivel arsimor deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

4.3 Korrupsioni në institucionet publike

Korrupsioni është një problem që ndodh kudo dhe në të gjitha nivelet e shoqërisë. Ai “gërryen demokracinë për të prodhuar një rreth vicioz, ku korrupsioni minon institucionet demokratike dhe kështu institucionet e dobëta janë më pak të afta ta kontrollojnë korrupsionin.”¹⁹ Organizata Transparency International e përcakton korrupsionin si abuzimi i pushtetit që i është besuar një zyrtari për përfitime private. Ky fenomen mund të klasifikohet në korrupsion i nivelit të lartë (korrupsioni i madh) dhe korrupsion i nivelit të ulët (korrupsioni i vogël), në varësi të sasisë së parave që humbet dhe nivelit të shoqërisë në të cilin ndodh ai.

Korrupsioni i madh është abuzimi i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grushti të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë. Korrupsioni i vogël, nga ana tjetër, është abuzimi i pushtetit që i është besuar zyrtarëve publikë në ndërveprimet e tyre me qytetarë të zakonshëm që duan të marrin të mira apo shërbimet bazë në sistemin e kujdesit shëndetësor, në arsim, në polici apo institucione të tjera.

Që nga viti 2017, Sondazhi i Opinioneve “Besimi në Qeverisje” e ka ndryshuar Kreun “Korrupsioni në Institucionet Publike” për të përfshirë një seri pyetjesh të reja që lidhen me përhapjen e llojeve të ndryshme të korrupsionit në Shqipëri, si korrupsioni i nivelit të ulët dhe korrupsioni i nivelit të lartë. Më pas, të anketuarit pyeten për nivelin e besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit – objektivi kryesor i reformës në drejtësi që po zbatohet aktualisht me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Në fund, të anketuarit pyeten për të treguar institucionin publik më të korrumpuar në Shqipëri në vitin e fundit nëpërmjet një pyetjeje të hapur.

Pas perceptimeve të korrupsionit në mbarë shoqërinë, të anketuarit pyeten për përvojat e tyre personale me fenomenin si në nivel vendor ashtu dhe atë qendror të qeverisjes, përfshirë këtu edhe pyetje nëse kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni apo kanë paguar ryshfet gjatë vitit. Pyetje të reja janë futur vazhdimisht në sondazh që nga viti 2015.

Perceptimet për përhapjen e korrupsionit


Shumica e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni i nivelit të lartë dhe ai i nivelit të ulët janë të përhapur në shoqërinë shqiptare. Krahësuar me vitet e mëparshme, përqindja e popullsisë rezidente që mendojnë se korrupsioni i madh dhe ai i vogël janë “shumë të përhapur” po rritet.

.....

19 Sipas Patricia Moreira, Drejtore e Transparency International në Raportin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit të 2018, ‘Si e dobëson demokracinë korrupsioni’, 29 janar 2019, në adresën e https://www.transparency.org/news/feature/cpi_2018_global_analysis

Të anketuarit u pyetën për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit të nivelit të lartë dhe atij të nivelit të ulët në një shkallë me katër pikë nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). Shumica e të anketuarve (87.5%) thanë se korrupsioni i nivelit të ulët (korrupsioni i vogël) është i përhapur (50.1%) ose shumë i përhapur (37.4%). Vetëm 1.5% e të anketuarve mendojnë se korrupsioni i vogël nuk është ‘aspak i përhapur’. Për sa i përket korrupsionit të madh, apo abuzimin me pushtetin në nivel të lartë, 85.2% e të anketuarve mendojnë se ai është ose i përhapur (42.6%) ose shumë i përhapur (42.6%). Vetëm 2.5% e të anketuarve e konsiderojnë korrupsionin e nivelit të lartë si ‘aspak të përhapur’.

Figura 21: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2019)



Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët (N = 2494); Korrupsioni i nivelit të lartë (N = 2495).

Nuk u vihen re dallime të mëdha në perceptimet e korrupsionit të vogël dhe të madh mes grupeve demografike, si gjinia, moshë, niveli arsimor, niveli i të ardhurave mesatare mujore apo vendbanimi. Megjithatë, një përqindje më e lartë e atyre që punojnë në sektorin privat (88.2%) mendonin se korrupsioni i vogël në Shqipëri është i përhapur ose shumë i përhapur në krahasim me ata që punojnë në sektorin publik (77.7%). Për korrupsionin e madh, të anketuarit që punojnë në sektorin privat kanë një perceptim pothuajse të njëjtë (85.6%) se fenomeni është i përhapur ose shumë i përhapur nëse krahasohen me të anketuarit që punojnë në sektorin publik (78.2%).

Viti 2019 shënon vitin e tretë radhazi në të cilin shqiptarët e perceptojnë korrupsioni si të përhapur dhe të gjithëpranishëm në shoqërinë e tyre. Krahasuar me vitet e mëparshme, përqindja e shqiptarëve që mendojnë se korrupsioni i nivelit të ulët dhe ai i nivelit të lartë janë ‘shumë të përhapur’ po rritet. Në vitin 2019, 37% mendonin se korrupsioni i vogël është ‘shumë i përhapur’, krahasuar me 34% në 2018 dhe 33% në 2017. Po ashtu, më shumë shqiptarë (43%) mendojnë se korrupsioni i madh është ‘shumë i përhapur’ në vitin 2019, krahasuar me 41% në 2018 dhe 40% në 2017.

Tabela 12. Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2017–2019)

		2017	2018	2019
Korrupsioni i nivelit të ulët	I përhapur	54%	53%	50%
	Shumë i përhapur	33%	34%	37%
Korrupsioni i nivelit të lartë	I përhapur	48%	48%	42%
	Shumë i përhapur	40%	41%	43%

Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët, 2017 (N = 1641); 2018 (N = 1644); 2019 (N = 2494). Korrupsioni i nivelit të lartë, 2017 (N = 1641); 2018 (N = 1644); 2019 (N = 2495).

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e përcaktimit të kampionit ndryshoi në krahasim me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shinin Kreun “Metodologjia”.


Të gjithë 2500 të anketuarit iu përgjigjën pyetjes së hapur: “Sipas mendimit tuaj, cili ishte institucioni më i korruptuar në vitin 2019?” Përgjigja më e zakonshme ishin gjykatat dhe/ose gjyqësori (N = 501), e ndjekur nga shëndetësia dhe/ose mjekët (N = 255), prokuroria (N = 249), qeveria (N = 220), parlamenti (N = 191), policia (N = 113), bashkitë (N = 81) dhe presidenti (N = 55). 128 të anketuar u përgjigjën se “të gjitha institucionet” ose “e gjithë politika” është e korruptuar, duke treguar një perceptim të korrupsionit të njëjtë në të gjitha institucionet. Është me interes të evidentohet se 71 të anketuar thanë se sektori i arsimit ishte institucioni më i korruptuar në vitin 2019 dhe 26 të anketuar thanë se ishte media.

Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsioni

Shumica e shqiptarëve nuk kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët dhe atyre të nivelit të lartë. Plot 6 nga 10 shqiptarë nuk kanë besim ose aspak besim në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të vogël, ndërsa 7 në 10 shqiptarë nuk kanë besim apo aspak besim në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të madh. Të punësuarit në sektorin publik priren të kenë më shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë dhe atij të ulët.

Pas pyetjeve për përhapjen e korrupsionit në Shqipëri, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin sa besonin në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit në një shkallë me katër pikë nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Shumica e të anketuarve (61.1%) thanë se nuk kishin besim ose nuk kishin aspak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët. Plot 31.5% e të anketuarve kishin besim dhe vetëm 5.8% kishin shumë besim se rastet e korrupsionit do të ndiqeshin penalisht. Në përgjithësi, të anketuarit janë më mosbesues në lidhje me ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të madh krahasuar me rastet e korrupsionit të vogël. Madje, 71% e të anketuarve thanë që nuk kanë besim ose nuk kanë aspak besim në ndjekjen e rasteve të korrupsionit të madh, me vetëm 26.6% që kanë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Në krahasim me vitet e kaluara, nuk ka pasur ndryshime thelbësore në përqindjen e të anketuarve që shprehën besim për ndëshkimin e rasteve të korrupsionit.

Figura 22: Perceptimi i ndjekjes penale të rasteve të korrupsionit (2019)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N = 2490); Korrupsioni i nivelit të ulët (N = 2461)

Për nivelin e besimit në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët, të dhënat nxjerrin në pah dallime të vogla sipas nivelit arsimor dhe sektorit të punësimit. Nga të

anketuarit me arsim deri 9-vjeçar²⁰, 34.7% kishin (shumë) besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël, krahasuar me 36.3% të të anketuarve që kishin mbaruar shkollën e mesme dhe 39.8% e atyre me arsim universitar. Për më tepër, një përqindje më e madhe e të anketuarve që punojnë në sektorin publik thanë se kishin (shumë) besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të vogël (58.9%) në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat (33.6%). Për sa i përket nivelit të besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të madh, e njëjta tendencë vihet re tek të anketuarit të punësuar sipas sektorëve. Ata që punojnë në sektorin publik kanë më shumë besim (43.8%) në ndëshkimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat (25.1%). Nuk u evidentuan diferenca të mëdha në opinionin e të anketuarve sipas gjinisë, moshës, nivelit të të ardhurave dhe vendbanimit.


Përvoja personale me rastet e korrupsionit

Edhe pse shqiptarët e perceptojnë korrupsionin si të përhapur dhe janë mosbesues për ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, jo shumë prej tyre duket se janë dëshmitarë të rasteve të tilla. Në vitin 2019, 15% e shqiptarëve kishin qenë vetë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror dhe 25.2% në nivel vendor. Krahasuar me tre vitet e fundit, ka një rritje të lehtë të përqindjes së shqiptarëve që kanë qenë personalisht dëshmitarë të korrupsionit.

Pas perceptimeve për korrupsionin dhe ndjekjen penale të rasteve të tij, të anketuarit u pyetën për përvojat e tyre personale me korrupsionin në nivel qendror dhe vendor. Edhe pse shqiptarët e perceptojnë korrupsionin si të përhapur dhe janë mosbesues për ndëshkimin e rasteve të korrupsionit, jo shumë prej tyre duket se janë dëshmitarë të rasteve të tij. Në nivel qendror, 15% e shqiptarëve kishin qenë vetë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror dhe 25.2% në nivel vendor. Për sa i përket ndarjes gjinore, u vunë re diferenca të vogla: 16.8% e të anketuarve meshkuj thanë se ishin dëshmitarë të korrupsionit në nivel qendror krahasuar me 13.3% të të anketuarve femra. Po ashtu, 27.3% e të anketuarve meshkuj thanë se ishin dëshmitarë të korrupsionit në nivel vendor, krahasuar me 23.1% të të anketuarve femra. Për më tepër, diferenca të vogla u vunë re edhe mes kategorive të ndryshme të grupmoshave. Të anketuarit në grupmoshën '56–65 vjeç' dhe 'mbi 66 vjeç', ishin më pak të ekspozuar ndaj korrupsionit në nivel vendor (përkatësisht 20% dhe 15.9%) në krahasim me të anketuarit e moshës nën 35 vjeç (26.8% e grupmoshës 18-25 dhe 28.4% e grupmoshës 26-35 vjeç). Nuk u vunë re dallime të mëdha për përvojat personale me korrupsionin sipas karakteristikave të tjera social-demografike, si niveli arsimor, niveli i të ardhurave dhe sektori i punësimit.


• • • • •

20 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Figura 23. Përvoja personale me korrupsionin (2019)

Baza: Qeveria qendrore (N = 2487); Qeveria vendore (N = 2487)

Për sa i përket tendencave të përvojave personale me korrupsionin gjatë këtyre viteve, të dhënat e sondazhit nxjerrin në pah se niveli më i lartë i ekspozimit ndaj korrupsionit është raportuar në vitin 2015 (41% në nivelin vendor dhe 34% në nivelin qendror), i ndjekur nga niveli më i ulët në 2016 (15% në nivelin vendor dhe 10% në nivelin qendror). Në vitin 2017, 21% e të anketuarve u përballën me korrupsionin e nivelit vendor dhe 15% në nivelin qendror. Në vitin 2018, përqindja e të anketuarve që personalisht ishin dëshmitarë të korrupsionit ishte e njëjtë me vitin 2017 (21% në nivel vendor dhe 14% në nivel qendror).

Figura 24: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor 2015-2019

Baza: Për qeverinë qendrore: 2015 (N = 1585); 2016 (N = 1633); 2017 (N = 1638); 2018 (N = 1631); 2019 (N = 2487). Për qeverinë vendore: 2015 (N = 1571); 2016 (N = 1633); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1631); 2019 (N = 2487).

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e përcaktimit të kampionit ndryshoi në krahasim me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shinin Kreun “Metodologjia”.

Përhapja e ryshfetit

Shumica e popullsisë rezidente në Shqipëri (64.1%) kishin marrë një shërbim nga një institucion publik në nivel vendor në 2019 dhe 34.8% në nivel qendror. Plot 19.1% e shqiptarëve që kishin marrë një shërbim nga një institucion i nivelit qendror kishin paguar ryshfet, ndërsa 35.8% kishin dhënë ryshfet në nivel vendor. Krahasuar me vitet e mëparshme, përqindja e shqiptarëve që kanë paguar ryshfet për një shërbim në nivel qendror ka rënë, ndërsa dukuria e ryshfetit në nivel vendor është rritur.

Një nga format e korrupsionit të nivelit të ulët është praktika e ryshfetit për marrjen e shërbimeve nga institucionet publike. Të anketuarit u pyetën nëse në vitin 2019 kishin

marrë ndonjë shërbim nga qeveria e nivelit qendror apo vendor dhe nëse kishin paguar ryshfet për marrjen e këtij shërbimi. 34.8% e të anketuarve kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore dhe 19.1% e tyre treguan se kishin paguar ryshfet për shërbimin që morën.

Figura 25. Shërbimet e marra në nivel qendror (2019)





Figura 26. Ryshfet i paguar në nivel qendror (2019)



Në nivel vendor, një numër më i madh të anketuarish që kishin marrë shërbim kishin dhënë ryshfet. Në sondazhin e vitit 2019, 64.1% e të anketuarve kishin marrë shërbim nga bashkia e tyre, nga të cilët 35.8% kishin dhënë ryshfet.

Figura 27. Shërbimet e marra në nivel vendor (2019)






Figura 28. Ryshfet i paguar në nivel vendor (2019)



Një numër më i vogël të anketuarish të moshës mbi 65 vjeç thanë se kishin paguar ryshfet për marrjen e një shërbimi. Vetëm 12% e tyre kishin paguar ryshfet për të marrë një shërbim të nivelit qendror dhe 20.5% kishin paguar ryshfet për një shërbim vendor. Të anketuarit që punojnë në sektorin privat treguan se kishin paguar ryshfet më shpesh për të marrë një shërbim në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin publik. Rreth një e pesta (19.3%) e të anketuarve nga sektori privat thanë se kishin paguar ryshfet për një shërbim të qeverisë qendrore dhe 36.3% për një shërbim në nivel vendor. Si për krahasim, nga të anketuarit që punojnë në sektorin publik 10.9% kishin paguar ryshfet për një shërbim që kishin marrë në nivel qendror dhe 27.9% për një shërbim vendor. Nuk u evidentuan dallime të mëdha mes karakteristikave të tjera social-demografike, si gjinia, niveli arsimor apo niveli i të ardhurave mujore.

Për të dytin vit radhazi, përqindja e të anketuarve që thanë se kishin paguar ryshfet për marrjen e një shërbimi në nivel qendror ka rënë. Në 2017, përqindja e të anketuarve që thanë se kishin paguar ryshfet u rrit me 6 pikë përqindje (p.p.) krahasuar me një vit më parë, por kjo përqindje ra me 9 p.p. në 24% në 2018 dhe më tej me 5 p.p. në 19% në 2019. Në nivel vendor, nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që kanë paguar ryshfet ka qenë në rritje. Në vitin 2016, 29% kishin paguar ryshfet krahasuar me 32% në 2017, 30% në 2018, dhe 36% në 2019 (35.8% e rrumbullakosur në numrin më të afërt).

Figura 29. Përhapja e ryshfetit (2016–2019)



Baza: Niveli vendor: 2016 (N = 838); 2017 (N = 916); 2018 (N = 924); 2019 (N = 1744). Niveli qendror: 2016 (N = 406); 2017 (N = 561); 2018 (N = 648); 2019 (N = 1518).

*Shënim: Në vitin 2019 metoda e përcaktimit të kampionit ndryshoi në krahasim me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shinin Kreun “Metodologjia”.

Të pyetur përse kishin paguar ryshfet gjatë marrjes së një shërbimi publik në nivelin qendror dhe vendor, përgjigja më e zakonshme e të anketuarve ishte se u ishte kërkuar të paguanin (41.3% ose N = 286). 31.2% e të anketuarve që kishin paguar ryshfet - qoftë në nivelin qendror apo vendor - thanë se e bënë këtë për të marrë një shërbim më të mirë herën

tjetër dhe 17.9% paguan si mirënjohje për shërbimin e marrë. Ndërkohë, 9.7% e mbetur (N = 67) u përgjigjën “Arsye tjetër”, nga të cilët shumica (N = 35) treguan se nuk kishin mundësi tjetër përveçse të paguanin ryshfet për të marrë shërbimin. Përgjigjet të tilla si “Nëse nuk jep ryshfet, do të marrësh ose një shërbim të keq ose nuk merr shërbim fare”, “Nëse nuk paguaj, [zyrtarët] të gënjejnë duke të thënë se nuk mund të më ndihmojnë”, ose “Pa paguar nuk të mbarojnë punë brenda ditës” ishin më se të zakonshme. Plot 16 persona të tjerë thanë se ryshfeti është mënyra e vetme për të marrë një shërbim shpejt ose me kohë dhe katër të anketuar treguan se pagimi i ryshfetit për të marrë një shërbim është praktikë e zakonshme në Shqipëri.

Tabela 13: Arsyet e pagimit të ryshfetit (2019)

	Përqindja	Numri
Ma kërkuan ryshfetin	41.3%	286
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	17.9%	124
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	31.2%	216
Tjetër	9.7%	67
Gjithsej	100%	693

Të anketuarit që pranuan se kishin paguar ryshfet u pyetën nëse e kishin raportuar këtë akt tek institucioni apo autoriteti përkatës. Vetëm 5.1% (N = 36) e atyre që kishin paguar ryshfet e raportuan veprimin, që do të thotë se 94.9% nuk e kishin raportuar rastin. Të pyetur për arsyet e mosraportimit të rastit të ryshfetit, shumë prej të anketuarve u përgjigjën se raportimi i ryshfetit është “Është e kotë të raportosh, askush nuk i kushton rëndësi” (43.2%). Përgjigjet e tjera të zakonshme ishin se “Të paguash ryshfet është diçka e zakonshme” (26%), se “Të paguash ryshfet është një shenjë mirënjohje për shërbimin e marrë” (9.9%), se “Kisha frikë nga pasojat e raportimit” (9.7%) ose që “Nuk dija se ku/kujt duhet t’i drejtohesha” (9%). 2.2% e të anketuarve zgjodhën “Arsye tjetër” dhe thanë se nuk raportuan nevojën për të paguar ryshfet për tre arsye kryesore: “ryshfeti është mënyra e vetme për mbaruar punë”, “Jam vetë fajtor për dhënien e ryshfetit”, ose “Nuk e pashë të arsyeshme [për ta raportuar]”. Dy njerëz u përgjigjën se kishin shumë frikë për të raportuar, pasi u ishte kërkuar të paguanin ryshfet.

Për të kuptuar më mirë fenomenin e pagimit të ryshfetit për të marrë shërbime publike, pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet u pyetën pse mendojnë se pagimi i ryshfetit është diçka e zakonshme. Në të gjitha fokus grupet, pjesëmarrësit ofruan përgjigje të ngjashme. Njerëzit mendojnë se nëse nuk paguajnë ryshfet, ata ose nuk do të marrin shërbim të kënaqshëm ose nuk do të marrin shërbim fare. Një nga pjesëmarrësit në fokus grupin me të anketuarit e moshës mbi 55 vjeç tha: “Nuk është se ata (infirmierët, mjekët) na kërkojnë direkt para apo të mos më shërbejnë kur jam në spital, por unë e di se nëse nuk u jap diçka atyre, ata të lënë pas dore. Prandaj, nuk pres që të ma kërkojnë, thjesht jap që në fillim atë që kam mundësi të jap, që të sigurohem se do të më shërbejnë mirë.”

4.4 Ndikimi politik

Ndikimi politik – apo sukcesi në promovimin apo ndryshimin e vendimeve politike për përfitimin e grupeve të interesit – është një dukuri shumëdimensionale që lidhet me procesin e përcaktimit të politikave dhe vendimmarrjes. Ndikimi politik në programin e institucioneve publike është kërcënim për pavarësinë e institucioneve publike dhe funksionimin e shoqërisë demokratike. Kur aktorët politikë ndërhyjnë në vendimmarrjen e këtyre institucioneve, kjo ndërhyrje dëmton funksionimin e tyre, shtrembëron ekuilibrat e strukturës së tyre organizative dhe dëmton besimin që qytetarët kanë te këto institucione. Në këtë kapitull, të anketuarit shprehin perceptimin e tyre për nivelin e ndërhyrjes politike në 9 institucione publike shqiptare. Për të katërtin vit radhazi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej pesë pikësh nga 1 (nuk ndikon aspak) në 5 (ndikon jashtëzakonisht shumë) se sipas mendimit të tyre sa ndikojnë interesat politike në axhendën e institucioneve përkatëse.


Interesat politike në axhendën e institucioneve

Institucionet fetare shihen si institucioni më pak i ndikuar politikisht: vetëm 1 në 10 shqiptarë besojnë se axhenda e institucioneve fetare në vitin 2019 ishte ‘shumë’ ose ‘jashtëzakonisht shumë’ e ndikuar nga interesat politike. Prokuroria dhe gjykatat u konsideruan si institucionet më shumë të ndikuara politikisht: 60.5% e shqiptarëve besojnë se puna e gjykatave është shumë ose jashtëzakonisht shumë e ndikuar nga interesat e politikës, ndërsa 59% e shqiptarëve e perceptojnë prokurorinë si shumë ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar nga politika.

Rezultatet e sondazhit të këtij viti tregojnë se institucionet fetare konsiderohen si më të pavarurit nga ndikimi politik gjatë vitit 2019. Plot 66.9% e të anketuarve raportuan se axhenda e institucioneve fetare ose nuk ndikohen aspak (38.8%) ose ndikohen shumë pak (28.1%) nga interesat politike. Pas institucioneve fetare, institucionet që perceptoheshin si më të pavarurit nga politika ishin organizatat e shoqërisë civile (45.6%), forcat e armatosura (38.1%), institucionet e sistemit të kujdesit shëndetësor (33.9%), dhe institucionet e sistemit arsimor (32.7%).

Prokuroria dhe gjykatat u konsideruan si institucionet më të ndikuara politikisht në vitin 2019 nga të nëntë institucionet. 38.7% e të anketuarve i konsideruan gjykatat shumë të ndikuara dhe 21.8% si jashtëzakonisht të ndikuara nga interesat politike, ndërsa vetëm 14.4% e të anketuarve besuan se gjykatat nuk ndikohen aspak ose ndikohen shumë pak nga politika. Në mënyrë të ngjashme, 38.7% e të anketuarve e konsideruan prokurorinë si shumë të ndikuar, ndërsa 20.3% e të anketuarve mendonin se puna e prokurorisë ndikohet jashtëzakonisht shumë nga interesat politike. Vetëm 14.1% e të anketuarve besonin se prokuroria nuk ndikohet aspak ose ndikohet shumë pak në punën e saj nga politika.

Figura 30: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në axhendën e institucioneve (2019)



Baza: N = 2488 (për të gjitha institucionet)

Krahasimi demografik për perceptimin e ndikimit politik tek institucionet

Shqiptarët me arsim deri 9-vjeçar, studentët, qytetarët pa të ardhura të rregullta mujore, apo ata me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë, prirën t'i konsiderojnë institucionet si shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht të ndikuara nga interesat politike shumë më shpesh se ata nga grupet e tjera demografike. Të punësuarit në sektorin publik apo ata që fitojnë të ardhura mujore në nivelin 24,001 deri në 50,000 lekë, nga ana tjetër, i konsiderojnë në numër më të vogël këto institucione si shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika sesa grupet e tjera demografike.

Kur krahasojmë perceptimet e ndikimit politik tek institucionet publike sipas demografisë, rezultatet tregojnë vetëm dallime shumë të vogla midis gjinisë, grupmoshave, apo vendbanimit (shih Tabela 15 në fund të këtij kapitulli). Dallime të konsiderueshme u evidentuan sipas nivelit arsimor, statusit të punësimit, sektorit të punësimit dhe nivelit të të ardhurave.

Niveli arsimor

Të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar²¹ ishin më pak në përqindje për sa i përket perceptimit për institucionet publike si shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht të ndikuara nga interesat politike në krahasim me të anketuarit me arsim të mesëm apo universitar. Për prokurorinë (53%), gjykatat (55%) dhe policinë (38%) të anketuarit me nivel arsimor më të ulët raportuan më pak në krahasim me të tjerët se puna e këtyre institucioneve ndikohet shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike.

Nga ana tjetër, një përqindje me e lartë e të anketuarve me arsim deri 9-vjeçar (18%) thanë se institucionet fetare ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë nga politika, krahasuar me të anketuarit me arsim të mesëm (8%) apo me arsim universitar (11%). Së fundi, të anketuarit me arsim universitar i perceptojnë institucionet publike arsimore si shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara (38%) në krahasim me të anketuarit me arsim të mesëm (32%) apo me nivel arsimor deri 9-vjeçar (26%).

Statusi i punësimit sipas sektorit

Për të gjitha institucionet, një numër më i vogël të anketuarish që punojnë në sektorin publik e konsiderojnë ndikimin e politikës si të madh ose jashtëzakonisht të madh. Për prokurorinë (42%), gjykatat (43%), policinë (29%), forcat e armatosura (19%), institucionet e sistemit të kujdesit shëndetësor (22%), institucionet e sistemit arsimor (23%), median (35%), institucionet fetare (8%), dhe organizatat e shoqërisë civile (16%),²² përqindja e të anketuarve që besojnë se ato ndikohen shumë apo jashtëzakonisht shumë nga interesat politike ishte më e vogël për të anketuarit që punojnë në sektorin publik sesa për ata që punojnë në sektorin privat. Studentët, më shumë sesa grupet e tjera, raportuan shpesh se institucionet e prokurorisë (68%), gjykatat (67%), institucionet e sistemit të kujdesit shëndetësor (39%), institucionet e sistemit arsimor (40%), media (55%), dhe institucionet fetare (16%), janë shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht shumë të ndikuara nga interesat politike.

Niveli i të ardhurave

Në shumicën e rasteve, të anketuarit që kanë të ardhura të rregullta mujore 24,001 - 50,000 lekë raportuan më pak se institucionet publike ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike në krahasim me të anketuarit me të ardhura mujore nën 24,000 lekë ose mbi 50,001 lekë. Për policinë e shtetit, forcat e armatosura, institucionet e

• • • • •

21 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

22 Përqindjet e përmendura janë shumatore të alternativave 'ndikohen shumë' dhe 'ndikohen jashtëzakonisht shumë'.

sistemit të kujdesit shëndetësor, institucionet e sistemit arsimor, mediat, dhe organizatat e shoqërisë civile, të anketuarit me të ardhura 24,001 - 50,000 lekë raportuan se institucioni përkatës është shumë i ndikuar ose jashtëzakonisht i ndikuar nga politika më rrallë se grupet e tjera sipas nivelit të të ardhurave.

Për prokurorinë dhe gjykatat, përqindja e të anketuarve që besonin se axhenda e këtyre institucioneve është “shumë e ndikuar” ose “jashtëzakonisht shumë e ndikuar” nga interesat politike ishte më e lartë për të anketuarit pa të ardhura (të dyja në total 66%) sesa për grupet e tjera sipas nivelit të të ardhurave. Për këto të fundit, të dhënat tregojnë se sa më i lartë të jetë niveli i të ardhurave, aq më shumë të anketuar besojnë se axhenda e prokurorisë dhe gjykatave ndikohet shumë ose jashtëzakonisht shumë nga politika. Për institucionet fetare rezultatet e sondazhit treguan se sa më të ulëta ishin të ardhurat e të anketuarit, aq më shpesh ai/ajo e perceptonte këtë institucion si shumë të ndikuar ose jashtëzakonisht të ndikuar nga interesat politike. Për të gjitha perceptimet për sa i përket ndikimit politik tek institucionet sipas grupeve demografike, shih Tabelën 15 në fund të këtij kapitulli.

Krahasimi vjetor i ndikimit të interesave politike

Për të katërtin vit radhazi, shqiptarët i perceptojnë institucionet fetare si institucionet më të pavarura nga ndërhyrjet politike. Prokuroria dhe gjykatat, nga ana tjetër, u konsideruan si institucionet më të ndikuara politikisht për të tretin vit radhazi.

Kur krahasojmë rezultatet e këtij viti me ato të viteve të kaluara, të dhënat tregojnë se asnjë nga institucionet nuk ka rritje të konsiderueshme në përqindjen e të anketuarve që e konsiderojnë institucionin si “shumë të ndikuar” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuar” nga interesat politike. Në periudhën 2016-2019, përqindja e të anketuarve që thonë se policia, forcat e armatosura, institucionet fetare dhe organizatat e shoqërisë civile ndikohen shumë ose jashtëzakonisht shumë nga interesat politike kanë mbetur pothuajse e njëjtë. Perceptimi për ndikimin e interesave politike ka rënë në vitet 2016-2017 për institucionet e kujdesit shëndetësor dhe ato arsimore dhe që prej kësaj periudhe ndikimi i perceptuar i interesave politik ka mbetur pothuajse i pandryshuar.

Për prokurorinë dhe gjykatat, perceptimi i ndikimit të interesave politike ra me 7 p.p. në vitet 2017-2018 për të dy institucionet. Në vitin e kaluar, ky perceptim ka mbetur pothuajse i njëjtë. Për të katërtin vit radhazi, shqiptarët i perceptojnë institucionet fetare si institucionet më të pavarura nga ndërhyrjet politike.

Tabela 14: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016–2019)

	2016	2017	2018	2019
Prokuroria	X	67%	60%	59%
Gjykatat	X	70%	63%	61%
Policia	46%	47%	48%	44%
Forcat e armatosura	33%	29%	33%	30%
Sistemi i kujdesit shëndetësor	41%	34%	36%	33%
Sistemi arsimor	38%	29%	34%	33%
Media	45%	37%	39%	45%
Institucionet fetare	9%	9%	12%	10%
Organizatat e shoqërisë civile	20%	26%	24%	23%

Media ishte i vetmi institucion që u perceptua më shpesh si “shumë e ndikuar” ose “jashtëzakonisht shumë e ndikuar” nga interesat politike në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018. Në 2018, 39% e të anketuarve thanë që ata e perceptonin axhendën e mediave si shumë të ndikuar ose jashtëzakonisht shumë të ndikuar nga politika, në krahasim me 45% në 2019 (+ 6 p.p.). Këto gjetje janë në përputhje me gjetjet e disa raporteve të hartuara gjatë viteve të fundit në lidhje me mungesën e pluralizmit në peizazhin mediatik shqiptar. Në mars 2018, Reporterët pa Kufij dhe Rrjeti Ballkanik i Raportimit Investigativ (BIRN), publikuan një raport për Pronësinë e Medias, i cili nxori në pah se në tregun shqiptar, audienca dhe të ardhurat mbesin shumë të përqendruara në duart e grupeve në pronësi të disa familjeve.²³ Këto kompani, argumenton raporti, janë të lidhura me një parti, me një grup të caktuar, me një kryetar partie ose me një person qartësisht të njëanshëm, gjë që shkakton një rrezik të lartë për ndikimin politik tek agjencitë e lajmeve, mediat dhe rrjetet e shpërndarjes.

• • • • •

23 Raporti i pronësisë së Medias në Shqipëri u publikua në një platformë interaktive dhe mund të lexohet në këtë adresë: <http://albania.mom-rsf.org/>

Tabela 15: Ndarrja demografike e institucioneve që ndikohen shumë nga interesat politike sipas të anketuarve (2019)

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor	Media	Institucionet fetare	Organizatat e shoqërisë civile
TOTAL (ndikim i fuqishëm *)	59%	61%	44%	30%	33%	33%	45%	10%	23%
Gjinia									
Meshkuj	59%	61%	46%	31%	33%	33%	46%	10%	23%
Femra	59%	60%	42%	29%	33%	32%	44%	11%	22%
Mosha									
18–25 vjeç	62%	62%	43%	26%	32%	37%	49%	11%	22%
26–35 vjeç	61%	62%	47%	33%	35%	36%	45%	11%	24%
36–45 vjeç	60%	62%	45%	29%	31%	30%	43%	10%	22%
46–55 vjeç	59%	60%	42%	31%	33%	31%	44%	8%	23%
56–65 vjeç	53%	57%	40%	30%	32%	29%	40%	9%	21%
mbi 65 vjeç	53%	56%	43%	29%	32%	30%	48%	12%	22%
Niveli arsimor									
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	53%	55%	38%	27%	30%	26%	43%	18%	25%
Shkollë e mesme	62%	64%	46%	32%	33%	32%	44%	8%	22%
Universitet	59%	60%	46%	29%	35%	38%	48%	11%	21%

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor	Media	Institucionet fetare	Organizatat e shoqërisë civile
TOTAL (ndikim i fuqishëm *)	59%	61%	44%	30%	33%	33%	45%	10%	23%
Statusi i punësimit status									
I/E Gjithsej	56%	58%	41%	27%	30%	30%	44%	9%	21%
punësuar									
Sektori publik	42%	43%	29%	19%	22%	23%	35%	8%	16%
Sektori privat	62%	64%	46%	30%	33%	33%	47%	9%	23%
I/E papunë	63%	65%	48%	33%	37%	36%	44%	11%	24%
Student	68%	67%	48%	30%	39%	40%	55%	16%	25%
Pensionist	52%	55%	42%	30%	32%	30%	40%	10%	22%
Niveli i të ardhurave									
Nuk kam të ardhura	66%	66%	50%	33%	38%	37%	47%	12%	24%
Deri në 24,000 lekë	52%	54%	40%	26%	30%	29%	42%	9%	21%
24,001–50,000 lekë	57%	59%	38%	25%	26%	26%	39%	8%	18%
50,001–70,000 lekë	57%	59%	43%	33%	31%	33%	45%	8%	21%
Mbi 70,001 lekë	63%	65%	58%	49%	37%	37%	58%	7%	21%
Vendbanimi									
Urban	59%	61%	45%	31%	33%	33%	45%	10%	22%
Rural	60%	60%	43%	27%	32%	33%	44%	10%	24%

*Përqindja e ndikimit të fuqishëm politik matet si shumatore e përgjigjeve “shumë i ndikuar” dhe “jashtëzakonisht shumë i ndikuar”. Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

4.5 Pjesëmarrja qytetare

Në Sondazhin e Opinionit 2019, u hoq pyetja për konsultimet përmes internetit. U fut një pyetje e re ku pyeten qytetarët për përdorimin e portalit “Konsultimipublik.gov.al” për t’u informuar apo për të dhënë opinionin e tyre për projektligje apo projekt strategji/plane veprimi.


Angazhimi (apo pjesëmarrja) qytetare është një mekanizëm i rëndësishëm për forcimin e qeverisjes së mirë, demokracisë vendore dhe fuqizimin e komunitetit duke u mundësuar qytetarëve të marrin pjesë në vendimmarrje dhe t’i kërkojnë llogari qeverisë së tyre. Përmirësimi dhe promovimi i një mjedisi që u bën të mundur qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhohen realisht me njëri-tjetrin, me qeverinë dhe grupet e interesit janë kështu të një rëndësie të veçantë (OECD, 2018). Ashtu si në vitet e kaluara, Sondazhi i Opinionit i vitit 2019 bën dallimin e angazhimit të qytetarëve në nivel qendror dhe vendor. Për të kuptuar më mirë pjesëmarrjen e qytetarëve, pyetjet u përqendruan në interesin dhe mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrje, për pjesëmarrjen në proceset dhe takimet konsultuese, përfshirjen në punë vullnetare, pjesëmarrjen në demonstrata/tubime dhe për nënshkrimin e peticioneve. Të anketuarve iu kërkua të japin edhe arsyet për mospjesëmarrje në takime konsultimi dhe për mospërdorimin e portalit online të konsultimeve publike. Në këtë kapitull, të anketuarit u pyetën edhe nëse kanë ndërmend të largohen nga vendbanimi i tyre.

Pjesëmarrja në vendimmarrje

Më shumë se gjysma e shqiptarëve (56.5%) ishin të interesuar të merrnin pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike. Shqiptarët prirën të besojnë se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike në nivel vendor (41.4%) më shumë se në nivel qendror (21.4). Në mënyrë të veçantë, të anketuarit e moshës 18-35 vjeç, të mirë-arsimuarit (67%) dhe ata të punësuar në sektorin publik (71%) thanë se ishin të interesuar të merrnin pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike.

Më shumë se gjysma e të anketuarve thanë se ishin të interesuar të merrnin pjesë në proceset vendimmarrëse të institucioneve publike (56.5%). Kjo kuptohet si qytetari aktive në qeverisjen e vendit.

Figura 31: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike (2019)




Baza: N=2492

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, të dhënat tregojnë dallime mes burrave dhe grave për sa i përket interesit për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. Plot 61% e të anketuarve meshkuj thanë se kishin dëshirë dhe interes për të marrë pjesë krahasuar me 53% të të anketuarve femra që pohuan të njëjtën gjë. Në lidhje me grupet moshore, duket se ka një rënie të interesit për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes me rritjen e moshës: vetëm 35% e të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç treguan një interes të tillë, ndërsa 64% e të rinjve (18-25 vjeç) thanë se ishin të interesuar për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike. Po ashtu, interesi për pjesëmarrje ishte më i lartë tek të anketuarit me arsim universitar (67%), studentët (67%) apo të anketuarit që ishin në marrëdhënie pune gjatë kohës që kryhej ky sondazh (62%). Të anketuarit që punojnë në sektorin publik (71%) apo ata që janë anëtarë të një partie politike (72%) janë më të interesuar të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse sesa grupet e tjera.

Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse ishte më i lartë tek të anketuarit me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë në muaj (66%) krahasuar me të anketuarit me të ardhura deri në 24,000 lekë në muaj (49%). Nuk u vu re ndonjë dallim i madh mes të anketuarve nga zonat urbane dhe rural në lidhje me interesin për pjesëmarrje dhe qytetari aktive. Për një përmbledhje të plotë të të gjithë demografisë, shih Tabelën 18 në fund të këtij kapitulli.

Plot 70.6% e të anketuarve raportuan se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e nivelit qendror. Në një nivel vendor, të anketuarit ishin pak më shumë optimistë për mundësitë për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. 58.6% raportuan se nuk kanë mundësi të mjaftueshme, që do të thotë se sipas 41.4% të të anketuarve ka mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse në nivelin vendor.

Figura 32: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike (2019)



Baza: Për qeverisjen qendrore N=2480; Për qeverisjen vendore N=2463


Një përqindje më e madhe e të anketuarve meshkuj (34%) sesa të anketuarit femra (25%) deklaruan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel qendror. Një dinamikë e ngjashme u vu re edhe në nivelin vendor ku 46% e meshkujve të anketuar mendonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë, përkundër 37% të femrave të anketuara.

Vetëm 15% e të anketuarve mbi 65 vjeç deklaruan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje në nivelin qendror krahasuar me 35% të të anketuarve '26-35 vjeç'. Ndërkohë, vetëm 24% e të anketuarve mbi 65 vjeç deklaruan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje në nivelin vendor krahasuar me gati gjysmën e anketuarve të grupmoshës '26-35 vjeç' (48%).

Po ashtu, të anketuarit ishin më shumë të prirur të raportonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivelin qendror dhe vendor nëse ishin me nivel të lartë arsimor, të punësuar në sektorin publik ose anëtarë të një partie politike. Vetëm 23% e të anketuarve me të ardhura deri në 24,000 lekë në muaj deklaruan se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel qendror, në krahasim me 40% e të anketuarve me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë. Gjithashtu, 24% e të anketuarve me të ardhura mujore deri në 24,000 lekë deklaruan se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e nivelit vendor të qeverisjes, përkundrajt 59% të të anketuarve me të ardhura 50,001-70,000 lekë në muaj. 64% e të anketuarve me të ardhura mujore prej 24,001-50,000 lekë në muaj deklaruan se ishin të interesuar të merrnin pjesë në proceset vendimmarrëse. 47% e tyre raportuan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e qeverisjes vendore në krahasim me 33% që deklaruan të njëjtën gjë për qeverinë qendrore. Nuk kishte ndonjë dallim të konsiderueshëm në perceptimin e mundësive për të marrë pjesë në vendimmarrje në nivelin qendror dhe vendor mes të anketuarve të zonave urbane apo rurale.

Në krahasim me vitet 2016 dhe 2017, kishte një përqindje më të lartë të të anketuarve që mendonin se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen e të dy niveleve të qeverisë. Në vitin 2016, 21% e të anketuarve thanë se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në nivel qendror, në krahasim me 29% në 2019 (+ 8 p.p.). Edhe në nivelin vendor, rritja ishte po 8 p.p., nga 33% në 2016 në 41% në 2019.

Figura 33: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2016–2019)



Baza: Në qeverisjen qendrore, 2016 (N=1633); 2017 (N=1634); 2018 (N=1630); 2019 (N=2480). Në qeverisjen vendore, 2016 (N=1634); 2017 (N=1630); 2018 (N=1638); 2019 (N=2463).


Pjesëmarrësit në fokus grupin e të anketuarve të moshës “nën 30 vjeç” nuk shprehën ndonjë entuziazëm për angazhimin në të ardhmen në proceset vendimmarrëse, siç argumentoi edhe njëri prej tyre: “Sistemi është helmuar; edhe ne jemi helmuar. Kështu që edhe nëse bëhemi pjesë e politikës, do të jemi po si ata, do të jemi të korruptuar, politika nuk do të na lerë të bëjmë ndryshime.” Një nga çështjet që theksuan ata është mungesa e modeleve të roleve pozitive në politikë, veçanërisht për të rinjtë që i futen politikës. Sidoqoftë, ata theksuan nevojën për një kulturë rinie të guximshme në Shqipëri që lufton korrupsionin dhe që nuk e ushqen atë, duke pranuar se një mënyrë për ta bërë këtë është duke rritur interesin dhe pjesëmarrjen në proceset e vendimmarrjes në nivelin vendor dhe qendror.

Proceset e konsultimit

12.8% e shqiptarëve raportuan se ishin ftuar për të marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel qendror dhe 23.8% në një takim konsultimi në nivel vendor. Në nivel qendror, 10.7% e popullatës së anketuar kishte marrë pjesë në një proces konsultimi krahasuar me 24.6% në nivel vendor. Portali i konsultimit publik online ishte përdorur rrallë (8%). Arsyeja kryesore e cituar nga të anketuarit për mospjesëmarrjen e tyre në proceset e konsultimit ishte mungesa e besimit në këto procese.

12.8% e të anketuarve raportuan se ishin ftuar për të marrë pjesë në një takim konsultimi nga institucionet publike në nivel qendror në vitin 2019, ndërsa shumica dërrmuese (87.2%) thanë se nuk ishin ftuar. Një përqindje më e madhe, 23.8%, raportuan se ishin ftuar për të marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel vendor.


Figura 34: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2019)



Baza: Për qeverisjen qendrore N = 2483; Për qeverisjen vendore N = 2482

Kur u pyetën nëse kishin marrë pjesë në procese konsultimi gjatë vitit 2019, një shumicë tejet e madhe prej 89.3% raportuan se nuk kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit në nivel qendror të qeverisjes. Në nivel vendor të qeverisjes, 24.6% e të anketuarve thanë se kishin marrë pjesë në takime konsultimi gjatë vitit 2019.

Figura 35: Pjesëmarrja në takime konsultimi (2019)



Baza: Për qeverisjen qendrore $N = 2233$; Për qeverisjen vendore $N = 2268$

Nga 558 të anketuarit që thanë se kishin marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel vendor dhe 240 të tjerë që kishin marrë pjesë në një takim konsultimi në nivel qendror, shumica raportuan se kishin marrë pjesë në një takim të hapur nga bashkia. Plot 373 të anketuar, ose 14.9% e popullatës së sondazhit, kishin marrë pjesë në një takim të hapur të organizuar nga bashkia dhe 237 të anketuarit kishin ndjekur një seancë konsultimi të organizuar nga këshilli bashkiak. Një numër më i vogël të anketuarish u përgjigjën se kishin marrë pjesë në një konsultim publik të organizuar nga qeveria qendrore ($N = 120$) apo Parlamenti ($N = 19$).

Tabela 16: Llojet e takimeve të konsultimi që kanë marrë pjesë të anketuarit në vitin 2019

Takim i hapur organizuar nga bashkia	14.9% (N = 373)
Seanca këshillimi me bashkësinë organizuar nga këshilli bashkiak	9.5% (N = 237)
Konsultim publik organizuar nga qeveria qendrore	4.8% (N = 120)
Konsultim publik organizuar nga Parlamenti	0.8% (N = 19)
Tjetër (specifiko):	0.9% (N = 23)

**Tjetër: takime elektorale të organizuara nga partitë politike*

Shënim: përqindja e totalit të kampionit, janë marrë parasysh edhe përgjigjet me disa alternative të zgjedhura.


Arsyeja kryesore për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit ishte se të anketuarit “nuk besojnë te këto procese konsultimi” që u raportua nga 35.2% e të anketuarve. Nga ana tjetër, 19.2% thanë se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese dhe 13.1% u përgjigjën “Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët”.

Tabela 17: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2019

Nuk besoj tek këto procese konsultuese	13.1% (N = 210)
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	35.2% (N = 564)
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit	11.6% (N = 186)
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	8.5% (N = 136)
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	19.2% (N = 307)

Shënim: përqindja e totalit të kampionit.

Plot 92% e të anketuarve nuk e kanë përdorur portalin “Konsultimipublik.gov.al” për të kërkuar informacione apo për të dhënë mendimin e tyre për projektligjet apo projekt strategjitë/planet e veprimit. Vetëm 8% thanë se e kishin përdorur portalin online.

Figura 36: Përdorim i portalit “Konsultimipublik.gov.al” në 2019

Baza: N=2438

Kur bëjmë krahasime mes grupeve demografike për ftesën dhe pjesëmarrjen në proceset vendimmarrëse, shohim disa dallime mes gjinive. Të anketuarit meshkuj prirën të jenë ftuar në konsultimet vendore (27%) apo qendrore (15%) më shumë sesa femrat me 21% dhe 11% respektivisht, ndërkohë që po të anketuarit meshkuj ishin në numër më të madh kur thanë se kishin marrë pjesë në takime konsultimi të qeverisë vendore (28%) dhe të qeverisë qendrore (13%) në 2019 krahasuar me femrat me 21% dhe 8% përkatësisht. Për sa i përket moshës, u vu re një dallim i qartë mes të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç dhe atyre që janë në moshë pune: vetëm 14% e të anketuarve të moshës ‘mbi 65 vjeç’ ishin ftuar të merrnin pjesë në procese konsultimi nga institucionet publike në nivel vendor në 2019 përkundër 27% të të anketuarve të moshës ‘26–35 vjeç’. E njëjta tendencë u vu re edhe për pjesëmarrjen faktike në proceset e konsultimit të qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Vetëm 19% e të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç kanë marrë pjesë në takime konsultimi në nivel vendor krahasuar me 33% të atyre të moshës 36-45 vjeç. Për më tepër, vetëm 3% e të anketuarve të grupmoshës ‘mbi 65 vjeç’ kanë përdorur portalin online portal “konsultimipublik.gov.al” përkundër 10% të të anketuarve të grupmoshës ‘26–35 vjeç’.


Po ashtu, niveli i pjesëmarrjes në proceset e konsultimit si në nivelin qendror ashtu edhe në atë vendor të qeverisjes dhe përdorimi i portalit online “konsultimipublik.gov.al” ishte më i lartë nëse të anketuarit ishin me arsim universitar ose të punësuar, veçanërisht në sektorin publik. Sa i përket të ardhurave, 16% e të anketuarve pa të ardhura deklaruan se ishin ftuar të merrnin pjesë në procesin e konsultimit në nivel vendor, përkundrajt 37% të të anketuarve me të ardhura mbi 70,001 lekë në muaj. Po ashtu, 19% e të anketuarve pa të ardhura deklaruan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit në nivel vendor në vitin 2019 në krahasim me 36% të të anketuarve me të ardhura mbi 70,001 lekë në muaj. Dallim

mund të vihet re edhe në përdorimin e portalit online të konsultimit, ku të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë në muaj (14%) që prirën ta përdorin atë më shumë sesa ata pa të ardhura ose me të ardhura deri në 24,000 lekë në muaj (6%). Gjithsesi, statistikën e përdorimit mbeten mjaft të ulëta. Për një ndarje të plotë sipas grupeve demografike shih Tabelën 19 në fund të këtij kapitulli.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit e fokus grupeve me prejardhje të ndryshme nuk ishin të informuar për mundësitë dhe mekanizmat e konsultimit publik. Të mirë-arsimuarit dhe të rinjtë që studiojnë drejtësi dhe ekonomik ishin më të informuar. Pavarësisht kësaj, pjesëmarrja e tyre reale në proceset e konsultimit në nivel qendror dhe vendor ishte relativisht e ulët. Arsyt kryesore që raportuan ata ishin mungesa e besimit në rëndësinë e proceseve të konsultimit; mungesa e besimit në vullnetin e institucioneve publike për të marrë parasysh mendimet e qytetarëve; dhe pamundësia për të marrë pjesë. Lidhur me këtë të fundit, një nga pjesëmarrësit në fokus grupin me të anketuar ‘me të ardhura më të ulëta ose të papunë’ theksoi: “Jam shumë i zënë për të siguruar bukën e gojës dhe thjesht nuk kam kohë të merrem me këto gjëra. Mund të jenë gjëra të mira për t’u bërë, por nuk na lënë problemet e shumta të përditshme.” Gjetjet nga diskutimet në fokus grupe tregojnë se mungesa e besimit në qeverinë qendrore dhe atë vendore është pengesë për pjesëmarrjen dhe interesin e qytetarëve në proceset e konsultimit.

Duket se ka një rënie të vogël prej 3 p.p. në vitin 2019 krahasuar me 2018 në lidhje me ftesën për të marrë pjesë në proceset e konsultimit në nivelin e qeverisjes qendrore, ndërsa nuk vihen re ndryshime në nivelin e qeverisjes vendore.

Figura 37: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2019)



Baza: Për qeverisjen qendrore: 2016 (N=1631); 2017 (N=1635); 2018 (N=1630); 2019 (N=2483).
Për qeverisjen vendore: 2016 (N=1624); 2017 (N=1635); 2018 (N=1629); 2019 (N=2482).

Pohimet për pjesëmarrjen qytetare


Shumica e shqiptarëve besojnë se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq (68.3%), se dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake (66.2%), dhe se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet në përgjithësi, merren në konsideratë (61.6%). Këshilltarët bashkiake në përgjithësi nuk konsiderohen se përfaqësojnë komunitetin vendor dhe të mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake (63.2%).

68.3% e të anketuarve ishin plotësisht dakord ose dakord me pohimin “Një qytetar i zakonshëm ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq.” Ndërkohë, 66.2% e të anketuarve ishin plotësisht dakord ose dakord me pohimin “Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake.”

Nga ana tjetër, 63.2% e të anketuarve në përgjithësi nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me pohimin: “Këshilltarët bashkiake përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake.” 61.6% e të anketuarve në përgjithësi nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me pohimin: “Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë.”

68.5% e të anketuarve në përgjithësi nuk ishin dakord ose nuk ishin aspak dakord me pohimin: “Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve.” Pothuajse 1 në 3 të anketuar ishin plotësisht dakord ose dakord se buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve.

Figura 38: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar (2019)



Baza: N1 = 2496, N2 = 2493, N3 = 2493, N4 = 2492, N5=2491

Sipas ndarjeve demografike, ka dallime për sa i përket përgjigjeve për pohimet. Për një ndarje të hollësishme demografike, shih Tabela 20 në fund të këtij kapitulli. Nuk ka dallime të mëdha mes burrave dhe grave në lidhje me pohimet për angazhimin qytetar. Gjithsesi, 69% e femrave besonin se dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale dhe se kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake, ndërkohë që vetëm një përqindje paksa më e vogël e të anketuarve meshkuj (63%) kishin të njëjtin mendim. Brezi i të rinjve prireshin të ishin më mosbesues në lidhje me angazhimin qytetar krahasuar me brezin e të moshuarve. P.sh., 74% e të anketuarve të grupmoshës ‘mbi 65 vjeç’ besonin se një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq në krahasim me 65% e të anketuarve të grupmoshës ‘18–25 vjeç’.

Dallime të vogla u vunë re edhe me ndryshimin e nivelit arsimor të të anketuarve. Të anketuarit e mirë-arsimuar (40%) prireshin të besonin se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë, përkundër 36% e atyre me arsim deri 9-vjeçar.²⁴ Për më tepër, 72% e atyre që punojnë në sektorin privat besojnë se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë, përkundër 64% e atyre që punojnë në sektorin publik.

55% e të anketuarve me të ardhura mbi 70,001 lekë në muaj besonin se qytetarët e zakonshëm kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq. Vetëm 27% e të anketuarve pa të ardhura apo me të ardhura më shumë se 70,001 lekë në muaj prireshin të besonin se sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë, përkundër 46% të atyre me të ardhura mujore prej 50,001–70,000 lekë. Vetëm 27% e të anketuarve pa të ardhura apo me të ardhura më shumë se 70,001 lekë në muaj besonin se këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin, krahasuar 40% e atyre me të ardhura 24,001–50,000 lekë në muaj. 23% e të anketuarve pa të ardhura besonin se buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve, krahasuar me 35% e të anketuarve me të ardhura 50,001–70,000 lekë në muaj. 38% e të anketuarve që jetojnë në zonat rurale besojnë se këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesat e qytetarëve përballë kryetarit të bashkisë dhe administratës bashkiake, përkundër 33% e atyre që banojnë në zonat urbane.

Është interesante të theksohet se për të gjitha pohimet të anketuarit që janë të punësuar në sektorin publik tregonin më shumë besim te qeveria sesa të anketuarit që punojnë në sektorin privat. Të punësuarit e sektorit publik besonin më shumë se “një qytetar i zakonshëm ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë ose i keq” (74%), se “sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit për projektligjet merren në konsideratë” (59%), që “këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin dhe mbrojnë interesin e qytetarëve para kryetarit dhe administratës së bashkisë” (52%) dhe se “buxheti i bashkisë së tyre në pasqyron prioritetet e qytetarëve” (47%) në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat (përkatësisht 68%, 34%, 31% dhe 27%). Për më tepër, të anketuarit që punojnë në sektorin publik më rrallë besojnë

• • • • •

24 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.


se “dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale, ato kanë ndikim të kufizuar në vendimet e këshillave bashkiake “ (55%) sesa të anketuarit që punojnë në sektorin privat (67%).

Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni

Pjesëmarrja e shqiptarëve në demonstrata, tubime dhe peticion mbetet relativisht e ulët. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç, qytetarët nga zonat urbane dhe qytetarët që janë anëtarë të partive politike prireshin më shumë të merrnin pjesë në një demonstratë/tubim apo të nënshkruanin një peticion sesa grupet e tjera demografike.

Shumica e pjesëmarrësve të këtij sondazhi (76.4%) raportuan se nuk kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion. Në dhjetor të viti 2018 studentët dolën në rrugë për të protestuar kundër cilësisë së arsimit të lartë. Të dhënat e këtij sondazhi që nga viti 2016 deri në 2019 nuk evidentojnë ndonjë ndryshim thelbësor të pjesëmarrjes në një demonstratë/tubim apo të nënshkrimit të ndonjë peticioni. Në vitin 2016, 22% raportuan se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo që kanë nënshkruar një peticion, ndërkohë që në 2017 kjo shifër ishte 20%, dhe në 2018 23%.

Figura 39: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2019



Baza: N = 2479

Arsyeja kryesore e pjesëmarrjes në një demonstratë/tubim apo nënshkrim peticioni ishte interesi i përbashkët i komunitetit ku jeton i anketuari (55.7%), ndjekur nga interesi personal (24.7%). Ndërkohë, 13.9% thanë se kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim

apo kishin nënshkruar një peticion, për shkak të militantizmit (për mbështetje politike) dhe vetëm 2.1% përmendën presionin e shokëve/të njohurve.

Ka vetëm një ndryshim të vogël mes grave dhe burrave në lidhje me pjesëmarrjen në demonstratë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni në vitin 2019: 25% e të anketuarve meshkuj deklaruan se kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim ose kishin nënshkruar një peticion në 2019 krahasuar me 22% të grave të anketuara. Grupmoshat e reja duket se janë më të prirur për të marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo për të nënshkruar një peticion sesa të anketuarit në moshë: 31% e të anketuarve të grupmoshës “18-25 vjeç” kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim ose kishin nënshkruar një peticion në 2019 krahasuar me vetëm 9% e të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç.


30% e të anketuarve me arsim universitar apo pasuniversitar thanë se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo se kanë nënshkruar një peticion në 2019 krahasuar me 14% e të anketuarve me nivel arsimor deri 9-vjeçar. Ashtu siç pritej, përqindja e studentëve që kanë ndjekur një demonstratë/ tubim apo se kanë nënshkruar një peticion në 2019 ishte më e lartë se e grupeve të tjera demografike: 34.7% e studentëve thanë se kanë marrë pjesë në një demonstratë/ tubim apo se kanë nënshkruar një peticion në 2019. Nuk ka dallime mes të anketuarve në marrëdhënie pune dhe të atyre të papunë. Për sa i përket nivelit të të ardhurave, 25% e të anketuarve pa të ardhura thanë se kishin marrë pjesë në një demonstratë/ tubim apo se kanë nënshkruar një peticion në 2019 krahasuar me 39% e të anketuarve me të ardhura mujore më shumë se 70,001 lekë në muaj. Për më tepër, të anketuarit nga zonat urbane (25%) kishin më shumë të ngjarë të marrin pjesë në një demonstratë/tubim ose të nënshkruanin një peticion në krahasim me 19% të të anketuarve nga zonat rurale. Së fundi, 39% e të anketuarve që janë anëtarë të partive politike deklaruan se kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo se kishin nënshkruar një peticion në vitin 2019 krahasuar me 21% të anketuarve që nuk janë anëtarë të asnjë partie politike.

Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare

- *Shqiptarët në përgjithësi janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare, veçanërisht të rinjtë apo qytetarët me arsim universitar.*

Shumica (77.7%) e të anketuarve deklaruan se ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare dhe 22.3% deklaruan se nuk ishin të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare. Të anketuarit meshkuj (80%) ishin pak më të gatshëm për t'u angazhuar në punë vullnetare sesa të anketuarat femra (76%). Sa i takon moshës, shumica (86%) e brezit të ri (18-25 vjeç) raportuan se ata janë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit, në krahasim me një pakicë të të anketuarve mbi 65 vjeç (47%). Gjithashtu, 85% e të anketuarve me arsim universitar ose pasuniversitar ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare për të mirën e komunitetit krahasuar me 48% të atyre që kishin vetëm arsim 9-vjeçar.

84% e të anketuarve që ishin në marrëdhënie pune ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare për të mirën e komunitetit, krahasuar me 77% e atyre që janë të papunë, gjë që është trend i qëndrueshëm në vite.


Figura 40: Gatishmëria për t'u angazhuar në punë vullnetare (2019)

Baza: N=2485

Largimi nga vendbanimi aktual

Pothuajse 1 në 2 shqiptarë duan të largohen nga Shqipëria. Gratë ishin paksa më të predispozuar për t'u larguar nga Shqipëria. Shqiptarët me nivel më të lartë të ardhurash, me arsim universitar apo pasuniversitar ose ata që ishin të papunë kishin më shumë dëshirë për t'u larguar nga Shqipëria.

46.3% e të anketuarve thanë se do të donin të largoheshin nga vendbanimi aktual dhe të iknin nga Shqipëria dhe 4.7% thanë se do të donin të lëviznin brenda Shqipërisë. 49% thanë se nuk donin të largoheshin.

Figura 41: Largimi nga vendbanimi aktual (2019)

Baza: N=2489

48% e grave që morën pjesë në sondazh raportuan se donin të largoheshin jashtë Shqipërisë, krahasuar me 45% të burrave. Një shumicë e madhe (65%) e të anketuarve të grupmoshës 18–25 vjeç raportuan se donin të largoheshin nga Shqipëria krahasuar me 10% të atyre të moshës mbi 65 vjeç. Sa i përket arsimit, 54% e atyre me arsim universitar raportuan se kishin dëshirë të iknin nga Shqipëria krahasuar me 35% të të anketuarve me arsim deri në 9-vjeçar.²⁵ 54% e qytetarëve të papunë që morën pjesë në sondazh raportuan se donin të iknin nga Shqipëria. Pothuajse gjysma e të anketuarve të punësuar (48%) raportuan se donin të largoheshin nga Shqipëria. Është interesante të evidentohet se të anketuarit me nivel të ardhurash më të larta duket se kanë më shumë të ngjarë të kenë dëshirë të largohen nga Shqipëria: 52% e të anketuarve në shkallën e pagave mbi 70,001 lekë në muaj raportuan se donin të largoheshin nga Shqipëria, krahasuar me 35% të atyre me të ardhura minimale (deri në 24,000 lekë në muaj).

Kur u pyetën për arsyen kryesore të dëshirës për t'u larguar nga Shqipëria, përgjigjja më e zakonshme ishte se kërkonin mundësi më të mira jete për veten dhe veçanërisht për fëmijët e tyre. Një arsye tjetër e shpeshtë ishin kushtet e këqija ekonomike dhe shpresa e të anketuarve se jashtë vendit do të gjenin punë më të mirë dhe me pagë më të lartë. Një numër i konsiderueshëm thanë se donin të largoheshin nga vendi për studime ose për t'u bashkuar me anëtarët e familjes që jetonin jashtë vendit. Arsye të tjera që u përmendën nga të anketuarit ishin mungesa e drejtësisë në Shqipëri, pakënaqësia me qeverinë qendrore dhe vendore dhe shërbimet e dobëta të kujdesit shëndetësor. Ata të anketuar që donin të lëviznin brenda Shqipërisë zakonisht synonin të vendoseshin në kryeqytet, Tiranë, qoftë për të gjetur punë më të mirë apo për t'u bashkuar me anëtarët e tjerë të familjes.

Qëllimi për t'u larguar nga vendi dhe motivet që qëndrojnë pas këtij qëllimi ndryshonin tek pjesëmarrësit në fokus grupet e organizuara. Disa pjesëmarrës në fokus grupin me të anketuar të moshës '30 vjeç' raportuan se kishin dëshirë të largoheshin nga vendi, por si akt dëshpërimi një student i drejtësisë tha: *"Nuk ka dritë në fund të tunelit për ne nëse qëndrojmë në Shqipëri"*. Disa pjesëmarrës të tjerë ngurronin të largoheshin nga vendi, sepse kishin frikë se pa familjen dhe rrethin shoqëror që kanë në vendin e tyre do të ishte më shumë e vështirë për ta të jetonin jashtë vendit. Pjesëmarrësit e moshës 'mbi 55 vjeç' kishin të njëjtën dëshirë për të parë që fëmijët e tyre të studionin dhe të punonin jashtë vendit në kërkim të perspektivave më të mira për jetën. Si për kontrast, pjesëmarrësit 'që banonin në zona rurale', të cilët ishin po ashtu mjaft të angazhuar në jetën publike dhe sferën ekonomike në zonat e tyre, treguan entuziazëm për të ardhmen dhe ishin të vendosur për të jetuar në Shqipëri. Pjesëmarrësit në të gjitha fokus grupet argumentuan se perspektiva e tyre personale për t'u larguar nga vendbanimi dhe qëndrimi i tyre në përgjithësi për të ardhmen e tyre në Shqipëri u ndikua negativisht nga mesazhi i përhapur gjerësisht në publik se *"shqiptarët po largohen masivisht nga vendi."* Pjesëmarrësit e fokus grupeve argumentuan se kjo shkaktonte një ndjenjë të përgjithshme ankthi.

.....

25 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Tabela 18: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2019)

		Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes	Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje	
			Qeveria qendrore	Qeveria vendore
Gjithsej		56.5%	29.4%	41.4%
Gjinia				
Femra		53%	25%	37%
Meshkuj		61%	34%	46%
Mosha				
18-25 vjeç		64%	33%	44%
26-35 vjeç		63%	35%	48%
36-45 vjeç		61%	29%	41%
46-55 vjeç		52%	28%	42%
56-65 vjeç		40%	23%	32%
mbi 65 vjeç		35%	15%	24%
Niveli arsimor				
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar		46%	23%	32%
Shkollë e mesme		55%	24%	36%
Diplomë universitare		67%	42%	55%
Statusi i punësimit status				
I/e punësuar	Gjithsej	62%	34%	48%
	Sektori publik	71%	47%	63%
	Sektori privat	58%	29%	42%
I/e papunë		53%	26%	34%
Student		67%	34%	45%
Pensionist		35%	14%	23%
Niveli i të ardhurave				
Nuk kam të ardhura		55%	26%	35%
Deri në 24,000 lekë		49%	23%	34%
24,001–50,000 lekë		64%	33%	47%
50,001–70,000 lekë		66%	40%	59%
Mbi 70,001 lekë		59%	39%	57%
Vendbanimi				
Urban		57%	29%	41%
Rural		55%	30%	42%

* Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 19: Ndarja demografike e procesit të konsultimit në 2019 – vetëm përgjigjet në kategorinë ‘Po’

		Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2019		Pjesëmarrja në konsultime në 2019		Përdorimi i portalit ‘Konsultimi-publik’
		Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor	
Gjithsej		12.8%	23.8%	10.7%	24.6%	8%
Gjinia						
Femra		11%	21%	8%	21%	8%
Meshkuj		15%	27%	13%	28%	8%
Mosha						
18–25 vjeç		9%	19%	8%	19%	10%
26–35 vjeç		14%	27%	12%	25%	10%
36–45 vjeç		15%	29%	13%	33%	9%
46–55 vjeç		15%	27%	12%	27%	6%
56–65 vjeç		11%	19%	8%	19%	4%
mbi 65 vjeç		7%	14%	8%	19%	3%
Niveli arsimor						
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar*		12%	19%	8%	20%	2%
Shkollë e mesme		10%	22%	9%	23%	7%
Diplomë universitare		18%	30%	15%	29%	13%
Statusi i punësimit						
I/e punësuar	Gjithsej	16%	29%	13%	29%	10%
	Sektori publik	28%	46%	27%	48%	16%
	Sektori privat	12%	23%	9%	22%	8%
I/e papunë		9%	17%	8%	19%	5%
Student		6%	19%	10%	22%	12%
Pensionist		8%	16%	6%	17%	2%
Niveli i të ardhurave						
Nuk kam të ardhura		8%	16%	7%	19%	6%
Deri në 24,000 lekë		11%	20%	7%	20%	6%
24,001–50,000 lekë		17%	30%	16%	31%	9%
50,001–70,000 lekë		21%	37%	15%	35%	15%
Mbi 70,001 lekë		23%	37%	21%	36%	14%
Vendbanimi						
Urban		14%	25%	11%	25%	9%
Rural		11%	21%	10%	23%	6%

* Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar..

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

Tabela 20: Ndarrja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar (2019) – të grupuar sipas përgjigjeve ‘plotësisht dakord’ dhe ‘në përgjithësi dakord’

	Njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve
Gjithsej	68.3%	36.0%	66.2%	34.2%	30.0%
Gjinia					
Femra	67%	36%	69%	34%	30%
Meshkuj	70%	36%	63%	34%	30%
Mosha					
18-25	65%	30%	67%	30%	23%
26-35	68%	33%	66%	32%	30%
36-45	69%	40%	68%	38%	32%
46-55	68%	39%	65%	33%	31%
56-65	70%	40%	62%	37%	35%
mbi 65 vjeç	74%	37%	68%	42%	36%
Niveli arsimor					
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	71%	36%	68%	36%	34%
Shkollë e mesme	67%	33%	68%	31%	27%
Diplomë universitare	68%	40%	63%	37%	31%
Statusi i punësimit					
I/e punësuar	69%	40%	64%	36%	32%
Sektori publik	74%	59%	55%	52%	47%
Sektori privat	68%	34%	67%	31%	27%

Njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq		Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët bashkiakë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë reflekton prioritetet e qytetarëve
Gjithsej	68.3%	36.0%	66.2%	34.2%	30.0%
I/e papunë	66%	28%	72%	29%	25%
Student	65%	32%	70%	27%	23%
Pensionist	72%	38%	66%	41%	37%
Niveli i të ardhurave					
Nuk kam të ardhura	66%	27%	72%	27%	23%
Deri në 24,000 lekë	71%	37%	66%	36%	33%
24,001–50,000 lekë	72%	42%	68%	40%	33%
50,001–70,000 lekë	62%	46%	50%	36%	35%
Mbi 70,001 lekë	55%	27%	42%	27%	25%
Vendbanimi					
Urban	68%	35%	67%	33%	29%
Rural	69%	38%	65%	37%	32%
Madhësia e bashkisë					
E vogël	69%	31%	70%	31%	26%
E mesme	67%	44%	64%	38%	33%
E madhe	69%	35%	66%	34%	30%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

4.6 Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

Nënkreu “Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike” ka qenë një pjesë e rëndësishme e Sondazhit “Besimi në Qeverisje” që në fillimet e këtij sondazhi në vitin 2013. Kjo për shkak se besohet në përgjithësi se ka një lidhje mes kënaqësisë së qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike dhe nivelit të përgjithshëm të besimit në qeverisje. Kur qytetarët marrin shërbime të kënaqshme nga institucionet publike, besimi i tyre në sistemin e qeverisjes rritet dhe anasjelltas. Në Shqipëri, ofrimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin u miratuar që në vitin 2014. Reforma synon të transformojë mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike nga administrata publike ndaj qytetarëve duke kaluar nga funksionimi i ndarë sipas drejtorive brenda qeverisë në një qasje më gjithëpërfshirëse me qendër qytetarët. Ky ndryshim drastik ka transformuar marrëdhëniet midis politikëbërësve, ofruesve të shërbimeve dhe qytetarëve dhe ka ndryshuar mënyrën e përjetimit të këtyre shërbimeve nga ana e qytetarëve. Në një mjedis të tillë, ofrimi në mënyrë të vazhdueshme i mendimeve dhe sugjerimeve nga ana e qytetarëve në lidhje me cilësinë dhe efikasitetin e ofrimit të shërbimeve publike ka rëndësi të madhe për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së administratës.

Në këtë kontekst, në këtë sondazh synohej të përcaktohej sa të kënaqur janë qytetarët me ofrimin e shërbimeve publike në dymbëdhjetë muajt e fundit ku u bëhen pyetje për shërbimet kryesore që ofrohen nga institucionet qendrore dhe bashkitë. Këto shërbime kanë të bëjnë me funksionet bazë publike, si kujdesi shëndetësor, arsimi (përfshirë atë parashkollor), furnizimin me ujë të pijshëm, transportin publik, shërbimin e pastrimit, emergjencat civile, policinë dhe gjyqësorin. Po ashtu, në sondazh vlerësohet edhe niveli i kënaqësisë me shërbimet administrative, si në kadastrat dhe pasuritë e patundshme, sigurimet shoqërore dhe asistencën sociale, punësimi, regjistrimi i biznesit dhe licencimi, dhënia e lejeve të ndërtimit. Këtë vit në pyetësor u shtuan tre shërbime administrative për të evidentuar ofrimin e shërbimeve në mënyrë më specifike, d.m.th.: gjendja civile, sigurimet shoqërore, transporti rrugor. Përveç nivelit të përdorimit të këtyre shërbimeve, pjesë e hulumtimit ishin edhe ankesat dhe përgjigja nga institucionet si dhe perceptimet e shqiptarëve për sigurinë e tyre në jetën e përditshme. Pas hapjes së Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) u shtuan edhe dy pyetje që lidhen me sportelet e shërbimit.

Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë

Sipas shqiptarëve, ofrimi i shërbimeve për pjesën më të madhe të shërbimeve bazë publike, si shërbimet gjyqësore, transporti publik, shërbimet e kujdesit shëndetësor nga institucionet publike dhe furnizimi me ujë të pijshëm, nuk është i kënaqshëm. Mesatarisht, 41.5% e të anketuarve e konsiderojnë ofrimin e shërbimeve bazë publike si të kënaqshëm dhe 50.8% e të anketuarve thanë se ofrimi i shërbimeve ishte i pakënaqshëm.

Të anketuarit e sondazhit të opinionit publik u pyetën për të vlerësuar kënaqësinë e tyre me ofrimin e shërbimeve publike në një shkallë nga “shumë i pakënaqur” në “shumë i kënaqur”. Shërbimet publike bazë që u vlerësuan në këtë sondazh janë shërbimet e shëndetit publik, shërbimet e arsimit publik (përfshirë atë parashkollor), furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit), shërbimet e emergjencave (zjarrfikësja, ambulanca etj.), shërbimet gjyqësore, dhe shërbimet e policisë. Të dhënat e sondazhit tregojnë se 41.5% e të anketuarve e konsiderojnë ofrimin e shërbimeve bazë publike si të kënaqshëm.²⁶ Plot 50.8% e të anketuarve ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur me ofrimin e shërbimeve dhe mesatarisht 7.7% e të anketuarve refuzuan të jepnin vlerësimin e tyre për ofrimin e shërbimeve publike bazë. Të anketuarit janë kryesisht të kënaqur me shërbimet e pastrimit (ku 50.5% kishin mendim pozitiv përkundër 46.8% që kishin mendim negativ), shërbimet e arsimit publik (48% me mendim pozitiv dhe 44% me mendim negativ), dhe shërbimet e emergjencave civile (47.2% me mendim pozitiv dhe 40.7% me mendim negativ për këto shërbime).

Për pesë shërbimet e tjera publike bazë, shumica e të anketuarve e vlerësuan ofrimin e shërbimeve të tilla më shumë si të pakënaqshme sesa të kënaqshme. Këtu përfshiheshin shërbimet gjyqësore (63.3% të pakënaqur ose shumë të pakënaqur), transporti publik (59.5%), shërbimet e kujdesit shëndetësor publik (54%) dhe furnizimit me ujë (52.2%). Për sa i përket shërbimit të policisë, të anketuarit ishin më shumë të pakënaqur (45.9%) sesa të kënaqur (41%), edhe pse kjo diferencë është më e vogël se për shërbimet e tjera. Për një vlerësim të plotë të të 16 shërbimeve publike të analizuara në këtë sondazh shihni Figurën 42.


Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve administrative

Në përgjithësi, popullsia mendon se ofrimi i shërbimeve administrative për pjesën më të madhe nuk është i kënaqshëm. Mesatarisht 34.5% e anketuarit mendojnë se ofrimi i shërbimeve administrative në Shqipëri është në nivel të kënaqshëm. Megjithatë, kur të anketuarit kishin përdorur një shërbim administrativ, ata ishin kryesisht të kënaqur me ofrimin e atij shërbimi: 44.1% e përdoruesve kishin mendim pozitiv për ofrimin e shërbimeve administrative që kishin përdorur në vitin 2019.

.....

26 Kjo përqindje është niveli i kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike bazë të marra së bashku.

Figura 42. Kënaqshmëria me shërbimet publike (2019)



Baza: $N = 2446$, $N = 2306$, $N = 2473$, $N = 2376$, $N = 2433$, $N = 2196$, $N = 2070$, $N = 2172$, $N = 2059$, $N = 2123$, $N = 1974$, $N = 2230$, $N = 2103$, $N = 2073$, $N = 1841$, $N = 1828$.

Shërbimet administrative të vlerësuara në këtë sondazh janë shërbimet e asistencës sociale, shërbimet e punësimit (Shërbimi Kombëtar i Punësimit SHKP), shërbimet e pronave (Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK, ish ZRPP dhe ALUIZNI), shërbimet e gjendjes civile (DPGJC), shërbimet e sigurimeve shoqërore (pensioni-Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH), shërbimet e transportit rrugor (patenta-Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor-DPSHTRR), regjistrimi dhe licencimi i biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit QKB) dhe lejet e ndërtimit. Të dhënat e sondazhit tregojnë se mesatarisht 34.5% e të anketuarve janë të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve.²⁷ 46.6% e të anketuarve ishin të pakënaqur ose shumë të pakënaqur. Si mesatare 18.9% e të anketuarve refuzuan për të dhënë një vlerësim të ofrimit të shërbimeve administrative. Të anketuarit ishim më shpesh të kënaqur me shërbimet e gjendjes civile (56.6% të kënaqur ose shumë

.....

27 Kjo përqindje është niveli i kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet administrative të marra së bashku.

të kënaqur), me shërbimet e transportit rrugor (42.6% të kënaqur ose shumë të kënaqur), dhe ato të sigurimeve shoqërore (41.6% të kënaqur ose shumë të kënaqur).

Për pesë shërbimet e tjera administrative, të anketuarit ishin më pak të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike. Për shërbimin e punësimit (63% të pakënaqur ose shumë të pakënaqur), shërbimet e kadastrës (53.4% të pakënaqur ose shumë të pakënaqur), ato të asistencës sociale (52.7%), lejet e ndërtimit (49.4%), dhe regjistrimi e licencimi i bizneseve (39%), të anketuarit kishin më shumë mendim negativ sesa pozitiv për ofrimin e këtyre shërbimeve. Për vlerësimin e të gjitha shërbimeve administrative të përfshira në këtë sondazh, shihni Figurën 42.

Gjithsesi, duke qenë se shërbimet administrative nuk është e thënë të përdoren nga të gjithë qytetarët, vlerësimi i përqindjes së të anketuarve që ishin të kënaqur me ofrimin e shërbimeve²⁸ sipas atyre që e kishin përdorur një shërbim në 2019 dhe atyre që nuk kishin përdorur një shërbim të tillë, duhet theksuar se grupi i parë ishin më të kënaqur me ofrimin e shërbimeve. Si mesatare, 44.1% e të anketuarve që kishin përdorur një shërbim administrative në 2019 ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimit administrativ.²⁹

Përdoruesit ishin veçanërisht më pozitivë për shërbimet e gjendjes civile (70% të kënaqur ose shumë të kënaqur), shërbimet e transportit rrugor (55.7% të kënaqur ose shumë të kënaqur), shërbimet e sigurimeve shoqërore (52.3%), regjistrimin dhe licencimin e biznesit (47.6%), dhe shërbimet e asistencës sociale (32.4%) pas marrjes së shërbimit përkatës në vitin 2019. Është me interes të evidentohet se tre shërbimet të vlerësuara si më pak të kënaqshme nga të gjithë të anketuarit e sondazhit të opinionit publik (shërbimi i punësimit, shërbimi i pronësisë dhe lejet e ndërtimit) kishin nivel të njëjtë kënaqësie me shërbimin nga të anketuarit. Tabela 21 tregon përqindjet e të anketuarve që kishin marrë një shërbim të caktuar dhe krahason nivelin e kënaqëshmërisë të të anketuarve që e kishin përdorur atë shërbim në vitin 2019.

• • • • •

28 Përqindja e të anketuarve që janë të kënaqur llogaritet si shumatore e “i/e kënaqur” dhe “shumë i/e kënaqur”.

29 Kjo përqindje është niveli i kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet administrative të marra së bashku.

Tabela 21. Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve administrative 2019

	Niveli përgjithshëm i kënaqshmërisë	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në 2019	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin
Shërbimi i asistencës sociale	29,6%	32%	34.2%
Shërbimi i punësimit	21,9%	37%	23.5%
Shërbimi i pronësisë	25,6%	31%	28.8%
Shërbimi i gjendjes civile	56,6%	50%	70.0%
Shërbimi i sigurimeve shoqërore	41,6%	39%	52.3%
Shërbimet e transportit rrugor	42,6%	32%	55.7%
Regjistrimi dhe licencimi i bizneseve	34,6%	21%	47.6%
Lejet e ndërtimit	23,7%	21%	22.7%

*Shënim: Ngjyra e gjelbër përfaqëson përmirësim prej >5 p.p. krahasuar me nivelin e përgjithshëm të kënaqshmërisë.

Shërbimet administrative publike që u përdorën më shumë nga të anketuarit gjatë vitit të kaluar ishin shërbimet e gjendjes civile (50%), shërbimet e sigurimeve shoqërore (39%), dhe shërbimi i punësimit (37%). Shërbimet më pak të përdorura ishin lejet e ndërtimit dhe regjistrimi dhe licencimi i biznesit (të dy me nga 21%).

Krahasimi demografik për kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike

Për të gjitha shërbimet publike që u vlerësuan në këtë sondazh të opinionit publik, të dhënat tregojnë se shqiptarët që punojnë në sektorin publik ishin më të kënaqur me shërbimet publike krahasuar me ata që nuk janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, të moshuarit, të anketuarit me arsim të mesëm dhe të punësuarit kishin mendim më pozitiv për ofrimin e shërbimeve publike sesa grupet e tjera demografike. Të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,000 lekë shpesh kishin mendim më negativ për ofrimin e shërbimeve publike.

Kur krahasojmë kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike sipas grupeve demografike, të dhënat tregojnë dallime sipas grupmoshës, nivelit arsimor, statusit të punësimit dhe nivelit të të ardhurave. Nuk u vunë re dallime të mëdha sipas gjinisë

dhe vendbanimit. Për sa i përket moshës, më shpesh të anketuarit e moshuar ishin më pozitivë për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet shqiptare në krahasim me të rinjtë. Për transportin publik, shërbimet e emergjencë, shërbimet e policisë, shërbimet e hipotekës, shërbimet e gjendjes civile dhe shërbimet e asistencës sociale, të dhënat e sondazhit tregojnë se të anketuarit e moshuar e vlerësuan ofrimin e shërbimit publik më shpesh si të kënaqshëm sesa anketuarit në moshë të re. Për shembull, nga grupmosha “mbi 65 vjeç”, 45% ishin të kënaqur me shërbimet e transportit publik, krahasuar me më pak se 31% për grupmoshat nën 35 vjeç. Për më tepër, të dhënat tregojnë se për shërbimin e kujdesit shëndetësor publik, për arsimin, pastrimin, gjendjen civile, asistencën sociale, transportin rrugor, dhe regjistrimin dhe licencimin e biznesit, të anketuarit me një nivel arsimit të mesëm ishin më të kënaqur me ofrimin e shërbimit publik sesa të intervistuarit me një nivel më të ulët të arsimor.

Pjesëmarrësit e fokus grupeve të grupmoshave të ndryshme nxorën në pah që jo vetëm pritshmëritë e tyre ishin të ndryshme për sa i përket shërbimeve publike, por edhe përvojat e tyre personale me ofrimin e atyre shërbimeve ishin të ndryshme. Pjesëmarrësit në moshë të re ishin të interesuar për arsimin, punësimin, policinë dhe regjistrimin e biznesit, ndërsa pjesëmarrësit në moshë u përqendruan te shërbimet e kujdesit shëndetësor, shërbimet sociale, transporti publik dhe furnizimi me ujë të pijshëm apo me energji elektrike. Shumë të anketuar të grupmoshës ‘mbi 55 vjeç’ në fokus grup treguan histori personale me raste nga zhgënjimi me ofrimin e shërbimeve publike. Një pjesëmarrëse nga Skrapari, pronare e një biznesi të vogël, theksoi se: *“Kur bëhet fjalë për mbledhjen e taksave dhe futjen e taksave të reja, zyrtarët e bashkisë dhe të institucioneve të tjera qeveritare më gjejnë shumë lehtë, por kur vjen puna për të ndërtuar një rrugë për të lidhur lagjen time me pjesët e tjera të qytetit, ata nuk mund të më gjejnë dot; unë jam e padukshme për ta, jo vetëm unë por e gjithë lagja.”*

Për të gjitha shërbimet publike që u vlerësuan në sondazhin e opinionit publik, të dhënat tregojnë se të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike në krahasim me ata të punësuar në sektorin privat. Për më tepër, për të 12 shërbimet publike, të dhënat tregojnë se të anketuarit në marrëdhënie pune, pavarësisht sektorit ku janë të punësuar, janë shpesh më të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike sesa të anketuarit e papunë. Kjo është veçanërisht e vërtetë për shërbimet e arsimit dhe të pastrimit. Studentët në mënyrë të veçantë ishin të pakënaqur me ofrimin në përgjithësi të shërbimeve publike. Për 10 nga 16 shërbime publike, një numër më i vogël studentësh e vlerësuan ofrimin e shërbimeve si të kënaqshëm (me diferencë -5 p.p.) në krahasim me grupet e tjera. Pensionistët, nga ana tjetër, ishin më shumë pozitivë për ofrimin e shërbimeve publike nga institucionet shtetërore.

Në fokus grupin me “Individë të moshës nën 30 vjeç”, pjesëmarrësit që ishin kryesisht studentë thanë se nuk i përdornin shumë shërbimet publike dhe kishin shumë pak përvojë me ofrimin e këtyre shërbimeve, sepse marrëdhëniet me administratën publike mbuloheshin kryesisht nga anëtarë të tjerë të familjes. Ja si shprehet një pjesëmarrës: *“Me dokumentet e mia merret më shumë babi ose motra e madhe, plus që nuk është se më duhen shumë këto dokumente. Dokumentacionin për shkollën ma bënë kryesisht anëtarët e familjes.”* Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në fokus grupet me banorë të zonave rurale i vunë theksin hendekut mes ofrimit të shërbimeve në zonat urbane dhe shërbimeve publike që ofrohen në zonat rurale apo të largëta.

Ka pasur dallime për sa i përket nivelit të kënaqësisë me ofrimin e shërbimeve publike në grupe me nivele të ndryshme të ardhurash. Të anketuarit me të ardhura mesatare mujore 24,001- 70,000 lekë ishin më shpesh të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë, ndërsa ata me të ardhura më të ulëta ose më të larta ishin më shpesh të pakënaqur. Për shërbimet administrative, personat me të ardhura 50,000 lekë ose më shumë ishin më shpesh të kënaqur me ofrimin e shërbimit. Në përgjithësi, të anketuarit pa të ardhura të qëndrueshme mujore janë më të pakënaqurit nga të gjitha grupet e të ardhurave. Për të mësuar më shumë për koeficientin e kënaqshmërisë në të gjithë demografinë e 16 shërbimeve publike të vlerësuara në këtë sondazh të Opinioni Publik, shiko Tabelën 24 në fund të këtij kapitulli.

Në fokus grupin e të anketuarve ‘Pa të ardhura apo me të ardhura nën 24,000 lekë’, pjesëmarrësit theksuan se kanë vënë re disa përmirësime në ofrimin e shërbimeve publike, veçanërisht në sistemin e kujdesit shëndetësor. Pjesëmarrësit ndanë histori personale apo të familjarëve të tyre për përvojat në spital. Edhe pse personeli mjekësor, sipas të anketuarve, ka bërë një punë mjaft të mirë, shumë prej tyre mendojnë se infrastruktura në qendrat shëndetësore është me mangësi të mëdha. Cilësia e infrastrukturës vazhdon të jetë problematike, veçanërisht në zonat periferike. Në qytete si Berat, Shkodër dhe Korçë rinovimi i qendrave të shërbimit shëndetësor (poliklinikat) dhe spitalet rajonale mendohej se nxjerr në pah progres me shërbimet shëndetësore. Sidoqoftë, në qytete të vogla si Skrapari dhe Erseka ka mungesë të shërbimeve të specializuara, për të cilat qytetarëve u duhet të shkojnë në spitalet rajonale ose në Tiranë. Sipas pjesëmarrësve nga Kamza, rritja e popullsisë me prejardhje të larmishme ka bërë presion mbi cilësinë e shërbimeve shëndetësore dhe arsimore që ofrohen, kështu që nevojiten më shumë investime.

Tendenca vjetore me kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike

Në katër vitet e fundit, niveli i kënaqësisë me ofrimin e shërbimeve publike bazë ka rënë në mënyrë të konsiderueshme, ndërkohë që të anketuarit në përgjithësi kanë qenë po aq të kënaqur apo më shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve administrative.

Mes viteve 2016 dhe 2019, kënaqësia në përgjithësi e të anketuarve me ofrimin e shërbimeve publike, veçanërisht me shërbimet publike bazë, ka rënë. Kënaqësia me shërbimin e policisë ra me 25 p.p. nga 66% në 2016 në 41% në 2019. Edhe niveli i kënaqësisë me shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm ka rënë me 25 p.p., transporti publik ka rënë me 19 p.p., me shërbimin e pastrimit 10 p.p., dhe kënaqësia me shërbimin e arsimit publik ka rënë me po 10 p.p. Nga ana tjetër, për pjesën më të madhe të shërbimeve administrative, të anketuarit kanë qenë po njësoj të kënaqur ose më të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike. Për shembull, niveli i kënaqësisë për shërbimin e punësimit u rrit me 4 p.p. mes viteve 2016 dhe 2019. Për një përmbledhje të niveleve të kënaqësisë nga 2016 në 2019, shih Tabelën 22.

Tabela 22. Niveli i kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike (2016–2019)

	2016	2017	2018	2019
Shërbimet publike bazë				
Shërbimet e kujdesit shëndetësor	47%	42%	41%	44%
Shërbimet e arsimit publik	58%	54%	50%	48%
Furnizimit me ujë të pijshëm	72%	56%	50%	47%
Transporti publik	55%	50%	37%	36%
Shërbimet e pastrimit	61%	57%	49%	51%
Shërbimet e emergjencave	55%	53%	44%	47%
Shërbimet gjyqësore	21%	15%	19%	20%
Shërbimi i policisë	66%	50%	40%	41%
Shërbimet administrative				
Shërbimi i asistencës sociale	34%	34%	31%	30%
Shërbimi i punësimit	18%	19%	17%	22%
Shërbimi i pronësisë (hipoteka)	X	X	26%	26%
Shërbimet e gjendjes civile	X	X	X	57%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	X	X	X	42%
Shërbimet e transportit rrugor	X	X	X	43%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	35%	36%	32%	35%
Lejet e ndërtimit	X	X	24%	24%


**Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë.*

Vlerësimi i cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia

Shumica e popullsisë shqiptare nuk shihte ndryshime të konsiderueshme në cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018. Gjithsesi, shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç, të anketuarit në marrëdhënie pune, ata me nivel të lartë të ardhurash apo të intervistuarit që punojnë në sektorin publik kishin më shumë gjasa të thonin se ofrimi i shërbimeve sociale nga bashkia e tyre ishte përmirësuar në vitin 2019 në krahasim me grupet e tjera demografike.

Ndonëse kemi bërë një krahasim vjetor për përqindjen e të anketuarve që janë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike (shiko kapitullin e mësipërm), është e rëndësishme të theksohet se pritshmëritë e qytetarëve mund të ndryshojnë. Në një shoqëri në transformim siç është Shqipëria, pritshmëritë e qytetarëve priren të rriten me kalimin e kohës. Si e tillë, të anketuarit u pyetën se si do ta vlerësonin cilësinë e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018. Shumica e të anketuarve (52.8%) raportuan se cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre nuk kishte ndryshuar. 29.1% thanë se shërbimet ishin përmirësuar dhe sipas 18.1% të të anketuarve cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre ishte përkeqësuar në krahasim me një vit më parë.

Figura 43. Cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia (2019)



Baza: $N = 1617$

U vunë re dallime të konsiderueshme në disa grupe demografike, të tilla si grupmosha, punësimi, niveli arsimor dhe niveli i të ardhurave. Të anketuarit mbi 65 vjeç raportuan më shpesh (35.1%) se cilësia e shërbimeve sociale të ofruara nga bashkia e tyre ishte përmirësuar në krahasim me të anketuarit e grupmoshës 18-15 vjeç (27%). Sa i përket nivelit arsimor, të anketuarit me arsim universitar kishin më shumë të ngjarë (35.7%) të deklaronin se ofrimi i shërbimit social të bashkisë ishte përmirësuar nëse do t'i krahasonim me të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar³⁰ (26.2%) ose diplomë të shkollës së mesme (25.4%). Të intervistuarit në marrëdhënie pune mendonin më shumë se cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia ishte përmirësuar (34.9%) sesa të anketuarit e papunë (18.4%). Të anketuarit e punësuar në sektorin publik e perceptuan veçanërisht cilësinë e shërbimeve bashkiake si të përmirësuar (54.6%). Së fundmi, të ndarë sipas nivelit të të ardhurave mesatare mujore, të anketuarit me të ardhura 24,001-50,000 lekë (38.2%), 50,001-70,000 lekë (37%) ose mbi 70,001 lekë (43.2%) mendonin më shumë se cilësia e shërbimeve të bashkisë ishte përmirësuar në krahasim me të anketuarit pa të ardhura (16.2%) ose me të ardhura mujore deri në 24,000 lekë (29.7%). Nuk u vunë re dallime sipas gjinisë apo vendbanimit rural/urbane.


Paraqitja e ankesave

Të dhënat e sondazhit tregojnë se, ndonëse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shqiptare nuk ishte e kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike në vitin 2019, vetëm 1 në 6 shqiptarë kishin bërë ankesë kur shërbimet nuk përmbushnin pritshmëritë e tyre. Ndonëse të anketuarit me të ardhura më shumë se 70,001 lekë kishin më shumë të ngjarë të bënin një ankesë në krahasim me grupet e tjera demografike, ata të moshës mbi 65 vjeç kishin më pak të ngjarë të paraqisnin një ankesë tek institucioni përkatës në vitin 2019.

Edhe pse përqindja e të anketuarve që ishin të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve shqiptare është rritur nga viti 2018 në 2019, gjithsesi ishte një numër i konsiderueshëm të anketuarish që nuk ishin të kënaqur me ofrimin e shërbimeve nga ana e një ose më shumë institucioneve. Prandaj, të anketuarit u pyetën nëse kishin bërë ndonjë ankesë për një shërbim që kishin marrë në një nga gjashtëmbëdhjetë institucionet për ato raste kur shërbimi nuk përmbushte pritshmëritë e tyre. 17% e të anketuarve treguan se kishin bërë ankesë, ndërsa 83% nuk kishin bërë asnjë ankesë. Në krahasim me vitet e kaluara, përqindja e të anketuarve që kanë bërë ankesë është rritur. Në vitin 2018, vetëm 11% e të anketuarve thanë se kishin bërë ankesë krahasuar me 15% në 2017 dhe 16% në 2016.

• • • • •

30 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Figura 44. Të anketuarit që kishin paraqitur ankesë tek institucionet (2016–2019)

Baza: 2016 (N = 1627); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1628); 2019 (N = 2491)

**Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë*


Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç në mënyrë të veçantë nuk kishin gjasa të bënin ankesë: vetëm 10.8% e tyre thanë se kishin paraqitur një ankesë në 2019. Për sa i përket nivelit arsimor, të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar (12.9%) apo me diplomë të shkollës së mesme (16.3%) kishin më pak të ngjarë të bënin ankesë tek një institucion në krahasim me të anketuarit me arsim universitar (21.7%). Të anketuarit me të ardhura mujore mesatare më shumë se 70,001 lekë, nga ana tjetër, prireshin më shumë për të bërë ankesë për një shërbim që kishin marrë nga institucioni përkatës (29.5%) sesa grupet e tjera demografike. Nuk u vunë re dallime të konsiderueshme mes grupeve të tjera demografike, si gjinia apo vendbanimi rural/urban.

Platforma e bashkëqeverisjes shqiperiaqeduam.al

Që me prezantimin e saj në vitin 2017, shqiptarët kanë përdorur përherë e më shumë platformën e re të bashkëqeverisjes shqiperiaqeduam.al. Në vitin 2018, 14% e të anketuarve kishin përdorur platformën. Shqiptarët me të ardhura mesatare mujore mbi 70,001 lekë apo anëtarët e partive politike – pavarësisht se cilës – ishin më shumë të prirur të kishin bërë ankesë në portalin www.shqiperiaqeduam.al.

Në vitin 2017, u prezantua një platformë e re online www.shqiperiaqeduam.al e bashkëqeverisjes, ku qytetarët mund të paraqisnin ankesat që kishin në lidhje me institucionet publike apo ofrimin e shërbimeve publike. Në vitin 2019, 13.9% e të anketuarve e kishin përdorur platformën për të paraqitur një ankesë. Të anketuarit mbi 65 vjeç dhe ata me arsim deri 9-vjeçar nuk kishin gjasa të kishin bërë ankesë nëpërmjet portalit shqiperiaqeduam.al. Përkatësisht, vetëm 7.4% e të anketuarve mbi 65 vjeç dhe 8.5% e atyre me arsim deri 9-vjeçar kishin bërë ankesë në platformë në vitin 2019. Si për krahasim, të anketuarit me të ardhura mesatare mujore mbi 70,001 lekë apo të anketuarit që janë anëtarë të partive politike, pavarësisht se cilës parti i përkasin, kishin më shumë mundësi të kishin bërë një ankesë nëpërmjet platformës në 2019, përkatësisht 22.7% dhe 21.5%.

Figura 45. A keni bërë ndonjë ankesë tek Platforma e Bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’? (2019)



Baza: N = 2482

Të anketuarit që kishin bërë ankesë nëpërmjet platformës shqiperiaqeduam.al u pyetën më pas nëse ishte trajtuar apo zgjidhura ankesa e tyre. Nga të anketuarit që kishin bërë ankesë, vetëm 37% thanë se u ishte zgjidhur problemi, ndërsa 63% deklaruan se ankesa e tyre nuk ishte trajtuar fare.


Ankesat e femrave të anketuara ishin trajtuar më shumë (38.4%) në krahasim me ato të anketuarve meshkuj (35.3%). Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit në marrëdhënie pune treguan më shpesh se ankesa e tyre ishte trajtuar (40.7%) në krahasim me të anketuarit e papunë (30.8%). Të anketuarit që punojnë në sektorin publik treguan se ankesa e tyre ishte trajtuar (60%) më shumë sesa të intervistuarit që punojnë në sektorin privat (34.4%). Po ashtu, të anketuarit që ishin anëtarë të një partie politike, ankesat e të cilëve ishin trajtuar, ishin në përqindje më të madhe (44.6%) sesa të anketuarit që nuk ishin anëtarë të partive politike (36.6%). Së fundi, të anketuarit me të ardhura mesatare mujore mbi 70,001 lekë ishin më të pakët në numër për sa i përket ankesave të bëra në shqiperiaqeduam.al që ishin trajtuar (20%) nëse i krahasojmë me të anketuarit me nivele më të ulëta të ardhurash.

Institucionet shqiptare “i dëgjojnë” qytetarët

Në 2019, afërsisht 1 në 4 shqiptarë besonin se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve, krahasuar me 2 në 4 që thonë se institucionet nuk ‘i dëgjojnë’ dhe nuk i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. Njerëzit që punojnë në sektorin publik (47.3%) prireshin më shumë të besonin se institucionet ‘i dëgjojnë’ qytetarët në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat (22.6%) apo të papunët (16.3%).

Llogaridhënia publike është një element i rëndësishëm për një vend në transformim si Shqipëria që kërkon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve. Ajo konsiderohet shpesh si shenja dalluese e qeverisjes moderne demokratike. Nëse ata që janë në pushtet nuk japin llogari dhe nuk mbajnë përgjegjësi, qeverisja demokratike katandiset në thjesht një procedurë ku ata që janë në pushtet mund të abuzojnë me pushtetin e tyre pa pasur frikë se mund të përballen me pasojat e veprimeve të tyre. Në këtë kontekst, të anketuarit u pyetën nëse besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. 24% e anketuarve u përgjigjën se ata besojnë se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. 48% e tyre menduan se institucionet nuk i dëgjojnë ankesat e qytetarëve dhe nuk i trajtojnë më vëmendjen e duhur shqetësimit e tyre, ndërsa 28% nuk ishin të sigurt nëse institucionet publike punojnë mirë për të trajtuar sugjerimet dhe ankesat e qytetarëve. Në krahasim me vitin 2018, nuk ka pasur ndryshime të mëdha. Sidoqoftë, në 2018 dhe 2019 të anketuarit mbeten pak më pesimistë sesa në vitet e kaluara, kur 28% (në 2016) dhe 29% (në 2017) e të anketuarve besonin se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët.

Figura 46. A mendoni se institucionet “i dëgjojnë” dhe adresojnë si duhet ankesat që vijnë nga qytetarët? (2019)



Baza: 2016 (N = 1259); 2017 (N = 1599); 2018 (N = 1565); 2019 (N = 2464)

**Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë.*

Gjatë krahasimit sipas grupeve demografike nuk u gjetën dallime mes gjinive. Për sa i përket nivelit arsimor, të anketuarit me arsim universitar kishin disi më shumë të ngjarë (27.4%) të besonin se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët në krahasim me të anketuarit me diplomë të shkollës së mesme (22.7%) apo ata me nivel arsimor deri 9-vjeçar³¹ (20.1%). Sa i përket nivelit të të ardhurave, të anketuarit që nuk kishin të ardhura të rregullta kishin më pak të ngjarë (15.6%) nga të gjitha grupet e të ardhurave të besonin se institucionet ‘dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. Të anketuarit me nivel të ardhurash mes 24,001 lekë dhe 70,000 lekë

• • • • •


31 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

mendojnë më shumë se institucionet ‘i dëgjojnë’ qytetarët: 31.3% e grupit të të anketuarve me të ardhura 24,001-50,000 lekë dhe 33.9% të grupit me të ardhura 50,001-70,000 lekë thanë se besonin që institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët. Për më tepër, të anketuarit në marrëdhënie pune kishin më shumë të ngjarë (29%) të besonin se institucionet ‘i dëgjojnë’ dhe trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët sesa të anketuarit e papunë (16.3%). Të anketuarit që punojnë në sektorin publik kanë shumë të ngjarë (47.3%) të raportojnë se institucionet i dëgjojnë qytetarët nëse do të bënim krahasim me të intervistuarit që punojnë në sektorin privat (22.6%). Së fundmi, të anketuarit me aftësi të kufizuara (13%) ose të anketuarit që janë anëtarë të një grupi pakicë (15.2%) ishin shumë më të pakët në numër për të besuar se institucionet japin llogari në krahasim me të anketuarit që nuk kanë aftësi të kufizuara (24.4%) apo që nuk janë anëtarë të një grupi pakicë (24.2%).

Sportelet e shërbimit në ADISA

23.9% e shqiptarëve të anketuar kishin vizituar një sportel shërbimit të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) në vitin 2019. Shumica e shqiptarëve që kishin vizituar një sportel të ADISA-s ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me shërbimin e ofruar. Në mënyrë të veçantë, të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (78.3%), ata që punojnë në sektorin publik (82.8%), me arsim universitar (76.2%), apo me të ardhura mesatare mujore 50,001–70,000 lekë (83.3%), ishin të kënaqur me shërbimin që kishin marrë në sportelet e shërbimit tek ADISA.

Në kuadër të reformës së shërbimeve publike me qendër qytetarin të ndërmarrë nga qeveria shqiptare, Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) është ngarkuar me detyrën e zbatimit të ndarjes së sportelit nga zyra në prapavijë për ofrimin e shërbimeve publike dhe u caktua si autoriteti për vlerësimin e standardeve dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara. Si pjesë të veprimtarisë së saj, ADISA administron sportele të shërbimeve të integruara me një ndalesë. Deri në periudhën e realizimit të sondazhit të vitit 2019, ADISA kishte 7 qendra (në Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër, Tirana Kombinat dhe Tirana 1), si dhe gjashtë zyra të përbashkëta me njësitë vetëqeverisjes vendore në Maliq, Belsh, Patos, Librazhd, Divjakë dhe Malësi e Madhe. Po ashtu, ADISA boton pasaporta informative të plota për shërbimet publike dhe ka vënë në dispozicion një numër telefoni (0800 0118) ku qytetarët mund të kërkojnë informacione për shërbimet publike. Në vitin 2019, 23.9% e të anketuarve kishin vizituar një sportel shërbimi të ADISA-s për të marrë shërbime (qoftë në zyrë qendrore apo në një zyrë të përbashkët me njësitë e vetëqeverisjes vendore).

Figura 47. Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2019

Baza N = 2500


Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, të dhënat tregojnë se përqindja e të anketuarve që kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2019 ishte më e vogël për të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç, me nivel të ulët arsimor, që banojnë në zonat rurale apo në bashki të vogla në krahasim me të anketuarit e tjerë. Nuk u vunë re dallime sipas ndarjeve gjinore. Nga të anketuarit mbi 65 vjeç, 13.1% kishin vizituar në qendër shërbimi ADISA krahasuar me mbi 28% të të anketuarve të moshës 26-45 vjeç (26-35: 28%, 36-45: 28.8%). Për sa i përket nivelit arsimor, nga të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar, 13.8% kishin vizituar sportele apo zyra shërbimi të ADISA-s, krahasuar me 23.6% e të anketuarve me diplomë të shkollës së mesme 30.9% të të anketuarve me arsim universitar. Nga të anketuarit që banojnë në zonat rurale, 20.6% kishin vizituar sportele apo zyra shërbimi të ADISA-s, krahasuar me 25.4% të të anketuarve që banojnë në zonat urbane. Po ashtu, një numër më i vogël të anketuarish që banojnë në bashkitë e vogla (me më pak se 50,000 banorë) kishin vizituar një sportel apo zyrë shërbimi të ADISA-s, krahasuar me të anketuarit që jetojnë në bashki të mesme (me 50,000-100,000 banorë) (21.4%) apo me bashki më të mëdha që kanë mbi 100,000 banorë (27.2%). Ka shumë mundësi që këto diferenca të kenë lidhje me shpërndarjen e sporteleve të para të shërbimit të ADISA-s teksa zgjerimi i tyre është në proces e sipër.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave, të anketuarit me nivel të lartë të ardhurash mujore pre 50,001–70,000 lekë (37.7%) apo më shumë se 70,001 lekë (38.6%) ishin më shumë të prirur të kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA sesa nëngrupet e tjera të të ardhurave. Nga të anketuarit që punojnë në sektorin publik, 34.1% thanë se kishin vizituar sportelet e shërbimit ADISA krahasuar me 24.9% të atyre që punojnë në sektorin privat.

Të anketuarit që kishin vizituar sportelet e shërbimit ADISA u pyetën se sa të kënaqur

ishin me ofrimin e shërbimeve në këto sportele. Mes tyre, 69.3% e të anketuarve që kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA thanë se ishin “të kënaqur” ose “shumë të kënaqur” me shërbimin e ofruar. Vetëm 4.8% ishin “shumë të pakënaqur”.

Figura 48. Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit me një ndalesë në zyrat e ADISA në 2019



Baza: $N = 598$

Sipas të dhënave demografike, 71.6% e të anketuarve meshkuj dhe 66.8% e të anketuarve femra ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me vizitën e tyre në sportelet e shërbimit ADISA. Për sa i përket moshës, të anketuarit e moshës 46 e sipër regjistruan nivele të kënaqshmërie nga 73.3% deri në 78.3%, dhe të anketuarit e rinj në moshë në 67%. Për më tepër, të anketuarit që punojnë në sektorin publik (82.8%), me arsim universitar (76.2%), ose me të ardhura mesatare mujore 50,001–70,000 lekë (83.3%) ishin më të shumtë në numër për të shprehur se ishin (shumë) të kënaqur me vizitën e tyre në sportelet e shërbimit ADISA, ndërsa të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar (58.7%) apo ata që nuk janë në marrëdhënie pune (55.7%) kishin më pak gjasa të thoshin se ishin të kënaqur me këto shërbime. Së fundi, të anketuarit që banojnë në zonat rurale (72.3%) ishin më shumë të kënaqur sesa të anketuarit që banojnë në zonat urbane (68.2%).


Siguria në jetën e përditshme

Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare (65%) nuk ndjeheshin të sigurt në jetën e përditshme. Të anketuarit nën 35 vjeç, ata që punojnë në sektorin privat, të anketuarit e papunë apo ata me aftësi të kufizuar prireshin më shumë për të raportuar se nuk ndjeheshin të sigurt në jetën e përditshme. Arsytet e përmendura më shpesh për ndjenjën e pasigurisë janë kriminaliteti, problemet e kujdesit shëndetësor, mungesa e drejtësisë, dhe pasiguria e vendit të punës.

Në përgjithësi, a ndjeheni të sigurt në jetën tuaj të përditshme?

Përveç nevojave bazë si ushqimi, uji dhe strehimi, siguria është një tregues tjetër i rëndësishëm i cilësisë së jetës. Zyra e Statistikave e Bashkimit Evropian e ka identifikuar sigurinë fizike dhe ekonomike si një nga nëntë treguesit kryesorë të cilësisë së jetës (Eurostat, 2018).³² Në këtë kontekst, në këtë sondazh u pyetën të anketuarit për ndjenjën e sigurisë në jetën e tyre të përditshme. Pjesa më e madhe e të anketuarve (65%) u përgjigjën se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme, gjë që do të thotë se vetëm 35% e të anketuarve ndjehen të sigurt në jetën e përditshme. Në krahasim me vitet e kaluara, përqindja e të anketuarve që ndjehen të sigurt është në rënie. Në 2017, 51% e të anketuarve thanë se ndjeheshin të sigurt, krahasuar me 41% në 2018 dhe 35% këtë vit.

Figura 49. Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016 –2019)



Baza: 2016 (N = 1608); 2017 (N = 1615); 2018 (N = 1629); 2019 (N = 2500)

**Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë*

Të anketuarit nën 45 vjeç, të anketuarit që punojnë në sektorin privat, të anketuarit e papunë dhe ata me aftësi të kufizuara ka të ngjarë të raportojnë se nuk ndjehen të sigurt në jetën e përditshme. Të anketuarit meshkuj (36.4%) tregojnë më shpesh se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme sesa të anketuarat femra (33.6%). Për sa i përket grupmoshave, të anketuarit në grupmoshat 18-25, 26–35, dhe 36–45 treguan më rrallë (31.1%, 29.2% dhe 33.7% respektivisht) se ndjeheshin të sigurt në krahasim me grupmoshat e tjera. Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit e papunë treguan më rrallë se ndjehen të sigurt (30.9%) sesa të anketuarit në marrëdhënie pune (36.7%). Një numër më i vogël të anketuarish që punojnë në sektorin privat (30.8%) thanë se ndjehen të sigurt në jetën e përditshme në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin publik (54.5%). Për më tepër, të anketuarit që banojnë

• • • • •

32 Shih Eurostat, Treguesit e cilësisë së jetës, në adresën https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Quality_of_life_indicators

në zonat urbane kishin më pak të ngjarë të ndjeheshin të sigurt (32.8%) sesa të anketuarit që banonin në zonat rurale (40.1%). Së fundmi, përqindja më e ulët e të anketuarve që ndjeheshin të sigurt në jetën e përditshme i përket atyre që janë anëtarë të një pakice (28.3%) ose që janë me aftësi të kufizuara (23%).

Të anketuarit që thanë se nuk ndjeheshin të sigurt në jetën e përditshme u pyetën për të evidentuar tre faktorët kryesorë që i bënin të ndjeheshin të pasigurt. Pjesa më e madhe e të anketuarve thanë se kriminaliteti (67%), shëndetësia pa cilësi e standard (49%), padrejtësia (36%), pasiguria për punën (36%) ishin shqetësime të përditshme. Faktorët të tjerë të përmendur më shpesh ishin politika (28%), ndotja e mjedisit (17%), dhe pabarazia në pasuri (16%). Për të gjitha përgjigjet që dhanë të anketuarit si arsye për ndjenjën e pasigurisë shih Tabelën 23.

Tabela 23. Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2019)

Faktorët për ndjenjën e pasigurisë	2016	2017	2018	2019
Kriminaliteti	49%	58%	71%	67% (n = 1084)
Shëndetësia pa cilësi e standard	11%	30%	50%	49% (n = 791)
Padrejtësia	11%	32%	45%	36% (n = 581)
Pasiguria e vendit të punës	X	42%	52%	36% (n = 576)
Politika	5%	29%	45%	28% (n = 459)
Ndotja e mjedisit	3%	12%	20%	17% (n = 270)
Pabarazia në pasuri	3%	23%	23%	16% (n = 259)
Përdorimi i lëndëve narkotike	6%	23%	29%	15% (n = 250)
Trafiku	7%	11%	13%	13% (n = 204)
Dhuna në familje	3%	15%	19%	7% (n = 108)
Mungesa e lirisë së fjalës	1%	5%	11%	4% (n = 64)
Diskriminimi në bazë të gjinisë, besimit fetar, pasurisë, etj.	X	5%	7%	3% (n = 44)
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	1%	6%	12%	3% (n = 48)

Baza: 2016 (N = 1608); 2017 (N = 1615); 2018 (N = 1629); 2019 (N = 1613)

Shënim: Lejohen disa zgjedhje; përqindjet nuk arrijnë totalin 100%. Për më tepër, në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

Duke qenë se në vitet e shkuara të anketuarit shpesh zgjidhnin të gjitha ose shumë prej alternativave, në sondazhin e vitit 2019 numri i përgjigjeve alternative për t'u përzgjedhur u caktua tre. Edhe pse kjo na jep një tregues më të mirë që atyre që të anketuarit i konsiderojnë si faktorët më të rëndësishëm që i bëjnë të ndjehen të pasigurt, kjo gjë nuk ndikon në aftësinë tonë për të bërë krahasime me vitet e mëparshme. Gjithsesi, krahasuar me vitet e kaluara, të njëjtat pesë përgjigjet ishin arsyet e përmendura më shpesh për ndjesinë e pasigurisë që kanë të anketuarit. Ashtu si në vitet 2018 dhe 2017, të anketuarit thanë se kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standard, padrejtësia, pasiguria për vendin e punës dhe politika janë faktorët kryesorë për ndjenjën e pasigurisë. Përdorimi i lëndëve narkotike, e përmendur nga 29% e të anketuarve në vitin 2018, u përmend më pak si faktor për ndjenjën e pasigurisë në vitin 2019 (15%). Ndotja e mjedisit dhe trafiku, nga ana tjetër, u përmendën përherë me më shumë si arsye për ndjenjën e pasigurisë. Në vitin 2016, vetëm 3% e të anketuarve thanë se ndotja e mjedisit u shkakton ndjenjën e pasigurisë në jetën e përditshme, krahasuar me 12% në vitin 2017, 20% në 2018 dhe 17% në 2019. Për trafikun, 7 % e të anketuarve thanë se ai ishte shqetësim i përditshëm në vitin 2016, krahasuar me 11% në 2017 dhe 13% në 2018 dhe 2019.

Tabela 24. Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike sipas ndarjeve demografike (2019)

Shërbimet publike bazë (të gjithë të anketuarit)										Shërbimet administrative (të anketuarit që përdorën shërbimin në 2019)						
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimit me ujë	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencat	Gjyqësori	Policia	Asistenca sociale	Punësimi	Pronësia	Gjendja civile	Sigurimet shoqërore	Transporti rrugor	Regjistrimi i biznesit dhe licencimi	Lejet e ndërtimit
Gjithësej (të kënaqur*)	44%	48%	47%	36%	51%	47%	20%	41%	34%	26%	29%	70%	52%	56%	48%	23%
Gjinia																
Femra	44%	50%	47%	35%	52%	47%	21%	42%	32%	24%	26%	68%	53%	57%	46%	21%
Meshkuj	43%	47%	47%	36%	49%	47%	18%	40%	35%	23%	30%	72%	51%	55%	48%	23%
Mosha																
18-25	42%	45%	44%	30%	52%	43%	16%	34%	32%	21%	26%	69%	57%	54%	44%	23%
26-35	41%	44%	43%	31%	49%	44%	18%	38%	32%	22%	28%	68%	50%	59%	48%	19%
36-45	47%	55%	52%	38%	51%	51%	21%	43%	36%	26%	30%	70%	54%	59%	49%	24%
46-55	47%	49%	47%	39%	52%	49%	20%	44%	33%	22%	29%	72%	48%	49%	49%	24%
56-65	42%	51%	49%	39%	49%	49%	22%	47%	31%	22%	30%	73%	52%	51%	48%	18%
mbi 65 vjeç	46%	47%	47%	45%	53%	52%	23%	47%	46%	39%	30%	70%	53%	50%	38%	34%
Niveli arsimor																
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	39%	43%	47%	36%	41%	48%	22%	44%	31%	21%	21%	60%	38%	33%	24%	18%
Shkollë e mesme	44%	49%	45%	37%	51%	48%	18%	39%	31%	21%	27%	70%	51%	55%	46%	23%
Me arsim universitar	47%	50%	50%	33%	56%	46%	20%	41%	43%	28%	35%	76%	64%	64%	61%	26%

Shërbimet publike bazë (të gjithë të anketuarit)										Shërbimet administrative (të anketuarit që përdorën shërbimin në 2019)								
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimit me ujë	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencat	Gjyqësori	Policia		Asistenca sociale	Punësimi	Pronësia	Gjendja civile	Sigurimet shoqërore	Transporti rrugor	Regjistrimi i biznesit dhe licencimi	Lejet e ndërtimit	
Gjithësej (të kënaqur*)	44%	48%	47%	36%	51%	47%	20%	41%		34%	26%	29%	70%	52%	56%	48%	23%	
Statusi i punësimit																		
I/e punë-suar	Gjithsej	48%	53%	49%	36%	56%	49%	22%	44%		37%	29%	31%	72%	58%	59%	53%	23%
	Sektori publik	64%	64%	61%	45%	66%	59%	32%	56%		52%	46%	45%	82%	66%	75%	59%	35%
I/e papunë	Sektori privat	42%	49%	44%	33%	52%	45%	18%	39%		33%	23%	28%	69%	55%	55%	54%	20%
		36%	36%	41%	44%	34%	38%	45%	14%		25%	13%	18%	63%	36%	45%	30%	17%
Student	43%	43%	44%	42%	35%	51%	43%	13%		30%	20%	36%	73%	42%	59%	47%	33%	
Pensionist	42%	42%	46%	46%	40%	52%	50%	26%		43%	32%	32%	71%	52%	44%	32%	33%	
Niveli i të ardhurave																		
Nuk kam të ardhura	37%	42%	43%	34%	41%	44%	14%	34%		22%	12%	19%	62%	35%	45%	30%	16%	
Deri në 24,000 lekë	42%	47%	46%	37%	53%	45%	21%	42%		40%	26%	25%	68%	49%	50%	37%	23%	
24,001–50,000 lekë	51%	57%	51%	39%	57%	54%	25%	47%		37%	29%	36%	74%	59%	57%	52%	32%	
50,001–70,000 lekë	47%	53%	51%	37%	55%	53%	24%	41%		48%	41%	46%	74%	76%	74%	66%	13%	
Mbi 70,001 lekë	43%	34%	34%	32%	45%	36%	11%	32%		56%	40%	26%	64%	70%	71%	65%	9%	
Vendbanimi																		
Urban	44%	48%	47%	36%	52%	46%	19%	40%		35%	24%	29%	68%	51%	54%	43%	21%	
Rural	44%	48%	46%	34%	48%	49%	21%	44%		32%	23%	28%	74%	53%	59%	54%	25%	

* Përqindja llogaritet si shumatore e përgjigjeve 'i kënaqur' dhe 'shumë i kënaqur'.

Shënim: Për shërbimet bazë, ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve. Për shërbimet administrative, ngjyrat përfaqësojnë diferencën prej >10 p.p. me totalin e përgjigjeve.

4.7 Performanca e institucioneve publike

Perceptimet e qytetarëve për performancën e institucioneve publike është një tregues kryesor për besueshmërinë e këtyre institucioneve. Për këtë arsye, ky kapitull është i ndërlidhur me dy kapituj të tjerë të këtij raporti, pra, me vlerësimin e besimit dhe kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve, veçanërisht për institucionet qeveritare në nivel qendror e vendor. Së bashku, të tre vlerësimet na japin një panoramë të qartë të perceptimit të publikut për qeverisjen në Shqipëri.

Performanca e institucioneve publike në 2019


Në 2019 popullsia rezidente shqiptare e shihte performancën e institucioneve fetare (43.7%) dhe forcat e armatosura (35.7%) më pozitivisht se të institucioneve të tjera. Performanca e gjykatave (23.6%), prokurorisë (22.1%), partive politike (30%), dhe Parlamentit (21.1%) u konsideruan si pozitive në shkallën më të ulët.

Për të matur performancën e institucioneve publike, të anketuarit u pyetën për të renditur 11 institucione në një shkallë nga 1 (performancë e shkëlqyer) deri në 5 (performancë shumë e dobët). Institucionet fetare (43.7%) dhe forcat e armatosura (35.7%) ishin institucionet që u vlerësuan më shumë si me performancë të mirë. 15.1% e të anketuarve e konsideruan performancën e institucioneve fetare si “të shkëlqyer”, ndërkohë që 28.6% e të anketuarve i konsiderojnë ato si me performancë shumë të mirë. Për forcat e armatosura, 11.6% e të anketuarve mendonin se performanca e këtij institucion ishte e shkëlqyer dhe se 24.1% e anketuarit mendonin se kjo performancë ishte shumë e mirë.

Institucionet që vlerësoheshin më shpesh si me performancë “shumë të dobët” ishin partitë politike (30%), gjykatat (23.6%), prokuroria (22.1%) dhe parlamenti (21.1%). Më shumë se gjysma e të anketuarve mendonin se partitë politike (54.4%), gjykatat (62.8%), prokuroria (62.3%), parlamenti (62%) dhe presidenti (55.1%) kanë performancë të dobët në përgjithësi (duke përmblodhur vlerësimin ‘të dobët’ dhe ‘shumë të dobët’).

Qeveria vendore (20.5%) u perceptua se punon më mirë se qeveria qendrore (18.3%). 17.8% e të anketuarve e vlerësonin performancën e qeverisë vendore si ‘shumë të mirë’, ndërsa 15.6% kishin të njëjtin mendim për qeverinë qendrore. 26.4% e të anketuarve e vlerësonin performancën e policisë si ‘shumë të mirë’ ose ‘të shkëlqyer’. Vetëm 10.5% e vlerësonin performancë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si ‘shumë të mirë’ ose ‘të shkëlqyer’.

Figura 50: Performanca e institucioneve publike (2019)



Baza: N = 2485

Analiza social-demografike e performancës e institucioneve publike

Në përgjithësi, perceptimet e qytetarëve shqiptarë për performancën e institucioneve publike nuk ndryshon shumë sipas ndarjeve demografike. Performanca e qeverisë vendore dhe qendrore perceptohet si më e mirë nga qytetarët shqiptarë, që janë të punësuar në sektorin publik, që kanë arsim universitar, që banojnë në zonat urbane apo që janë mbi 65 vjeç. Performanca e gjyqësorit, prokurorisë dhe gjykatave, shihet si e dobët apo shumë dobët në të gjitha grupet demografike.

Nuk u evidentuan dallime të mëdha mes të anketuarve femra dhe meshkuj në vlerësimin e performancës së 9 institucioneve publike nga 11 gjithsej. Performanca e institucioneve

fetare u konsiderua paksa më pozitive nga të anketuarit femra (46%) në krahasim me të anketuarit meshkuj (42%). Burrat kishin më shumë të ngjarë ta perceptonin performancën e forcave të armatosura si pozitive në krahasim me gratë: 37% e burrave, krahasuar me 34% të grave të anketuara. Për sa i përket dallimeve të moshës, të anketuarit ‘mbi 65 vjeç’ priren ta perceptojnë performancën e qeverisë qendrore dhe asaj vendore më pozitive sesa grupmoshat e reja: 21% e të anketuarve ‘mbi 65 vjeç’ e vlerësuan performancën e qeverisë qendrore si pozitive dhe 26% atë të bashkive si pozitive, ndërsa vetëm 13% e atyre ‘18-25 vjeç’ e perceptuan performancën e pushtetit qendror si pozitive dhe 16% atë të qeverisë vendore si pozitive..

Vetëm dallime të vogla u evidentuan në lidhje me perceptimet e grupmoshave të ndryshme për performancën e Presidentit, Parlamentit, Prokurorisë, gjykatave dhe partive politike, të cilat u konsideruan nga shumica dërrmuese e të anketuarve se kishin performancë të dobët. Të anketuarit në grupmoshën mbi 65 vjeç priren ta perceptojnë performancën e policisë dhe ushtrisë më pozitivisht sesa grupmoshat e reja: 31% e të anketuarve ‘mbi 65 vjeç’ e vlerësuan performancën e policisë si pozitive, por vetëm 20% e të anketuarve të grupmoshës ‘18-25 vjeç’ deklaruan të njëjtën gjë. Po ashtu, 43% e të anketuarve ‘mbi 65 vjeç’ vlerësuan performancën e forcave të armatosura si ‘të shkëlqyer’ ose ‘shumë të mirë’, ndërkohë që vetëm 31% e të anketuarve të grupmoshës ‘18 - 25 vjeç’ e konsideruan performancën e forcave të armatosura si pozitive .

Për sa i përket arsimit, të anketuarit me arsim universitar e konsideruan performancën e qeverisë qendrore si më pozitive (23%) në krahasim me të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar³³ (15%). E njëjta tendencë vihet re edhe për performancën e qeverisë vendore, ku të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar ishin më të prirur të konsideronin performancën e qeverisë vendore si pozitive (26%) në krahasim me të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar (18%). Nuk u vunë re dallime të mëdha për sa i përket nivelit arsimor kur vjen fjala për performancën e parlamentit dhe të presidentit, të cilët u konsideruan se kanë performancë të dobët nga pjesa më e madhe e të anketuarve.

Performanca e qeverisë qendrore, qeverisjes vendore, presidentit dhe parlamentit prirej të konsiderohej negative nga të anketuarit e papunë. E njëjta prirje vërehet në vlerësimin e performancës së gjykatave dhe prokurorisë. Të anketuarit që punojnë në sektorin publik kanë më shumë të ngjarë ta konsiderojnë performancën e qeverisë vendore dhe qendrore si dhe atë të institucioneve të tjera publike si pozitive në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat. Për shembull, 39% e anketuarve që punojnë në sektorin publik vlerësuan punën e qeverisë qendrore si “të shkëlqyer” ose “shumë të mirë” në krahasim me 17% të atyre që punojnë në sektorin privat. Performanca e partive politike në përgjithësi shihej si negative në të dy sektorët e punësimit, në mënyrë të veçantë nga sektori privat, ku vetëm 8% e vlerësuan performancën e partive politike si pozitive.

.....

33 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Vetëm 9% e të anketuarve pa të ardhura e konsideronin performancën e qeverisë qendrore si pozitive krahasuar me 30% të të anketuarve me të ardhura 50,001–70,000 lekë në muaj. E njëjta tendencë mund të vihet re edhe për performancën e perceptuar të qeverisë vendore, ku 10% e të anketuarve pa të ardhura e vlerësojnë performancën e qeverisë vendore si pozitive krahasuar me 28% e atyre me të ardhura 50,001–70,000 lekë në muaj. 17% e të anketuarve pa të ardhura e konsideronin performancën e policisë si pozitive krahasuar me 35% të atyre me të ardhura më shumë se 70,001 lekë në muaj. 45% e të anketuarve me të ardhura mujore në fashën 24,001-50,000 lekë në muaj e konsideronin si pozitive performancën e institucioneve fetare. Vetëm 8% e të anketuarve me të ardhura mujore prej 24,001-50,000 lekësh e vlerësonin performancën e presidentit si pozitive. Të anketuarit me të ardhura 24,001-50,000 lekë në muaj e konsideronin performancën e qeverisë vendore (27%) si më pozitive sesa atë të qeverisë qendrore (22%).

Të anketuarit që banojnë në zonat urbane priren ta perceptojnë performancën e qeverisë vendore dhe qendrore si më pozitive krahasuar me ata që banojnë në zonat rurale. Nuk ka dallime të mëdha në perceptimin e publikut për institucionet e tjera nga këndvështrimi i ndarjes zonë urbane dhe zonë rurale. Për një përmbledhje të dallimeve sipas ndarjes demografike shih Tabelën 26 në fund të këtij kapitulli.

Gjetjet nga diskutimet në fokus grupe tregojnë se qytetarët janë më të shqetësuar për punën e qeverisë vendore dhe qendrore, parlamentit, presidentit, prokurorisë, gjykatave dhe policisë sesa të institucioneve të tjera të marra në këtë vlerësim. Shqetësimi kryesor në lidhje me punën e këtyre institucioneve ishte shpërdorimi i burimeve dhe abuzimi me pushtetin. Pjesëmarrësit, veçanërisht në fokus grupin e të anketuarve “mbi 55 vjeç” dhe fokus grupi i të anketuarve “me arsim universitar dhe pasuniversitar” ia atribuon pakënaqësinë e tyre performancës së këtyre institucioneve me praktikën e klientelizmit, nepotizmit dhe korrupsionit. Perceptime të tilla buronin nga përvojat personale veçanërisht me gjyqësorin lidhur me tokën dhe pronën, raportimet e mediave për skandale politike dhe pretendimet e ndryshme për korrupsionin e qeverisë në lidhje me shumë projekte të mëdha.

Performanca i institucioneve në vite

Me kalimin e viteve, nga sondazhi i opinionit publik vihet re një rënie në perceptimin për performancën pozitive të qeverisë vendore dhe qendrore. 28% e të anketuarve e perceptonin performancën e qeverisë qendrore si pozitive në 2017, përkundër 22% në 2018 dhe 18% në 2019. 32% e të anketuarve e perceptonin performancën e qeverisë vendore si pozitive në 2017, përkundër 23% në 2018 dhe 21% në 2019.

Pas tre vitesh të matjes së perceptimit të performancës së institucioneve publike, të dhënat tregojnë se vlerësimet për performancën pozitive³⁴ të një pjese të madhe të institucioneve publike ra në vitet 2017-2018, por qëndroi pothuajse e pandryshuar në periudhën 2018-2019. Ndryshimet më të mëdha ishin për institucionet fetare dhe forcat e armatosura: vlerësimi për institucionet fetare ra me 14 p.p. në periudhën 2017-2018, por më pas u rrit në 2019. Përqindja e vlerësimit pozitiv për forcat e armatosura ra me 12 p.p. nga 2017 në 2018, por u rrit me 2 p.p. në 2019.

Pesë institucione patën një rënie të vazhdueshme të performancës së tyre pozitive, përfshirë qeverinë vendore (-11 p.p. mes viteve 2017 dhe 2019), qeveria qendrore (-10 p.p.), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (-9 p.p.), presidenti (-5 p.p.), dhe partitë politike (-4 p.p.). Për vlerësimin e performancës së të gjitha institucioneve të renditura në sondazhin e opinionit publik, shih Tabelën 25.

Tabela 25: Performanca e institucioneve (2017–2019)

	Performancë pozitive			Neutral			Performancë negative		
	2017	2018	2019	2017	2018	2019	2017	2018	2019
Qeveria qendrore	28%	22%	18%	27%	29%	32%	46%	49%	49%
Qeveria vendore	32%	23%	21%	28%	34%	32%	40%	43%	47%
Presidenti	14%	10%	9%	37%	39%	35%	49%	51%	55%
Parlamenti	13%	9%	10%	33%	32%	28%	55%	58%	62%
Prokuroria	8%	9%	9%	24%	26%	28%	69%	64%	62%
Gjykatat	7%	9%	8%	21%	24%	28%	62%	65%	63%
Policia	29%	30%	26%	30%	34%	38%	40%	36%	35%
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	20%	12%	11%	52%	46%	39%	28%	35%	46%
Institucionet fetare	57%	43%	44%	33%	34%	36%	11%	16%	13%
Forcat e armatosura	46%	34%	36%	38%	41%	41%	16%	19%	16%
Partitë politike	13%	10%	9%	30%	26%	24%	57%	61%	64%

Baza: 2017 (N = 1647); 2018 (N = 1647); 2019 (N = 2485).

• • • • •

34 Performanca pozitive llogaritet si shumatore e përgjigjeve “performancë e shkëlqyer” dhe “performancë shumë e mirë”


Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri

Rreth gjysma e popullsisë shqiptare ishte e kënaqur ose shumë e kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj. Të anketuarit me arsim universitar, ata të punësuar në sektorin publik apo nga zonat urbane shpreheshin më shumë të kënaqur.

Në 30 vitet e fundit Shqipëria ka marrë asistencë financiare dhe teknike nga donatorët e huaj, veçanërisht në lidhje me reformat madhore politike, zhvillimin ekonomik, demokratizimin, të drejtat e njeriut dhe shoqërinë civile. Në këtë pjesë të sondazhit do të matim sa të kënaqur janë qytetarët me asistencën (donatorët) e huaj në Shqipëri.

43.2% e të anketuarve ishin të kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj në Shqipëri dhe 8% ishin shumë të kënaqur. 38.5% ishin të pakënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj në Shqipëri dhe 10.4 ishin shumë të pakënaqur.

Figura 51: Kënaqshmëria me ndikimin e donatorëve të huaj në Shqipëri (2019)



Baza: N=2470

Të anketuarat femra (46%) ishin pak më të kënaqura me ndikimin e asistencës (donatorëve) të huaj në Shqipëri në krahasim me të anketuarit meshkuj (41%). Të anketuarit me arsim universitar ose pasuniversitar (45%) kishin më shumë të ngjarë të ishin të kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaj në Shqipëri në krahasim me të anketuarit me arsim deri

9-vjeçar³⁵ (41%). Disa dallime u vunë re në perceptimin për donatorët e huaj sipas statusit të punësimit. Për shembull, një pjesë më e vogël e të anketuarve të papunë (40%) ishin të kënaqur me ndikimin e donatorëve në Shqipëri në krahasim me të anketuarit që janë në marrëdhënie pune (45%). Të anketuarit nga zonat rurale dukeshin se ishin më pak të kënaqur me ndikimin e donatorëve në Shqipëri (39%) sesa banorët e zonave urbane (45%).

• • • • •

35 Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Tabela 26: Ndarrja demografike – performanca e institucioneve publike (2019)

	Qeveria qendrore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	KQZ	Institucionet fetare	Forcat e armatosura	Partitë politike
Gjithsej (performancë pozitive)	18.3%	20.5%	9.0%	9.5%	8.7%	8.2%	26.4%	10.5%	43.7%	35.7%	9.2%
Gjinia											
Femra	17%	19%	8%	9%	9%	9%	27%	10%	46%	34%	9%
Meshkuj	19%	22%	10%	10%	9%	8%	26%	11%	42%	37%	10%
Mosha											
18–25 vjeç	13%	16%	7%	8%	8%	7%	20%	8%	39%	31%	7%
26–35 vjeç	19%	20%	8%	8%	8%	7%	25%	10%	40%	30%	9%
36–45 vjeç	20%	21%	11%	11%	10%	10%	29%	11%	50%	41%	13%
46–55 vjeç	20%	22%	9%	9%	9%	8%	28%	12%	48%	39%	8%
56–65 vjeç	20%	22%	8%	12%	7%	8%	31%	12%	44%	39%	11%
mbi 65 vjeç	21%	26%	11%	14%	12%	12%	31%	10%	44%	43%	7%
Niveli arsimor											
Me nivel arsimor deri 9-vjeçar	15%	18%	7%	9%	8%	8%	25%	11%	47%	35%	9%
Shkollë e mesme	16%	18%	10%	8%	8%	7%	25%	9%	44%	36%	8%
Diplomë universitare	23%	26%	9%	12%	10%	9%	29%	12%	41%	35%	11%
Statusi i punësimit											
I/e punë-suar	23%	26%	10%	11%	10%	9%	31%	12%	45%	38%	11%
Sektori publik	39%	43%	12%	22%	15%	15%	39%	19%	50%	43%	17%
Sektori privat	17%	19%	10%	8%	9%	7%	27%	10%	43%	36%	8%

	Qeveria qendrore	Qeveria vendore	Presidenti	Parlamenti	Prokuroria	Gjykatat	Policia	KQZ	Institucionet fetare	Forcat e armatosura	Partitë politike
Gjithsej (performancë pozitive)	18.3%	20.5%	9.0%	9.5%	8.7%	8.2%	26.4%	10.5%	43.7%	35.7%	9.2%
I/e papunë	11%	12%	7%	6%	5%	6%	19%	8%	43%	31%	7%
Student	13%	13%	6%	5%	8%	9%	16%	7%	40%	25%	6%
Pensionist	20%	22%	11%	14%	12%	12%	31%	13%	44%	42%	11%
Niveli i të ardhurave											
Nuk kam të ardhura	9%	10%	7%	5%	5%	5%	17%	7%	43%	29%	6%
Deri në 24,000 lekë	22%	23%	11%	12%	11%	10%	29%	13%	48%	40%	11%
24,001–50,000 lekë	22%	27%	8%	11%	10%	10%	31%	11%	45%	37%	10%
50,001–70,000 lekë	30%	28%	10%	13%	11%	11%	29%	14%	42%	38%	17%
Mbi 70,001 lekë	21%	16%	9%	12%	7%	5%	35%	7%	42%	33%	12%
Vendbanimi											
Urban	18%	21%	9%	9%	8%	8%	25%	10%	41%	33%	9%
Rural	19%	18%	9%	12%	11%	10%	29%	13%	51%	42%	9%

*Përgjigje e kombinuar e kategorive me përgjigje “performancë e shkëlqyer” dhe “performancë shumë e mirë”.

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë diferencat prej >5 p.p. me totalin e përgjigjeve.

4.8 Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

Dixhitalizimi i shërbimeve publike apo “e-qeverisja” është bërë trend botëror në dekadën e fundit. Dixhitalizimi i shërbimeve publike i bën këto shërbime më të lehta për t’u përdorur, më efikase dhe transparente për qytetarët, të cilët mund ta marrin informacionin pa iu dashur të dalin nga shtëpia. Një tjetër avantazh i portaleve të qeverisjes elektronike është se ato e bëjnë procesin e ofrimit të shërbimit më të drejtë dhe më pak të predispozuar për korrupsion.³⁶ Eliminimi i ndërveprimit njerëzor në procesin e qeverisjes bën që të pakësohen mundësitë dhe rastet për ryshfet dhe forma të tjera të korrupsionit.

Në Shqipëri në vitin 2012 u hap platforma e qeverisjes elektronike e-Albania. Platforma synon të bëhet kanali kryesor për të marrë shërbimet publike, ndërkohë që ul kohën e shërbimit, kufizon burokracinë dhe zvogëlon korrupsionin, teksa, nga ana tjetër, u jep njerëzve mundësinë për të përmirësuar shërbimet publike dhe politikat qeveritare. Platforma po zgjeron vazhdimisht gamën e shërbimeve elektronike dhe informacionit në lidhje me shërbimet publike.³⁷ Sipas faqes së internetit të portalit, e-Albania ofron 1,799 shërbime për individë dhe biznese.³⁸ Në këtë pjesë, të anketuarit iu përgjigjën pyetjeve në lidhje me njohuritë, përdorimin dhe përshtypjet e tyre për faqet e internetit të bashkive dhe qeverisë qendrore dhe për shërbimet elektronike.

Faqja e internetit e bashkisë

Për herë të parë këtë vit, shumica e shqiptarëve të anketuar ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti. Gjithsesi, popullsia në moshë kishte shumë pak njohuri për platformën online të bashkive të tyre. Vetëm 1 në tre shqiptarë që ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti e kishin përdorur faqen ueb të bashkisë në 2019.

Sot pothuajse të gjitha bashkitë në Shqipëri kanë një faqe në internet ku ofrohet informacioni për strukturën e tyre organizative, legjislacionin vendor, buxhetin dhe raportet për veprimtarinë e tyre. Ndonëse disa nga bashkitë e mëdha, si Tirana, kanë faqe

• • • • •


36 Shih raportin, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (mars 2018) Embracing Digitalisation: How to use ICT to strengthen Anti-Corruption, gjendet në adresën: https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng_ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf

37 E-Albania. (n.d.). ‘Rreth portalit, marrë nga adresa: <https://e-albania.al/Pages/eAlbania.aspx>

38 E-Albania. (n.d.). Statistika për shkurt 2020. marrë nga adresa: <https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>

ueb të strukturuar dhe me shumë rubrika, bashki më të vogla si ajo e Tepelenës apo e Fushë Arrëzit kanë faqe më të thjeshta interneti. Kur u pyetën, 54.2% e të anketuarve ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti, ndërkohë që 42.5% nuk ishin të sigurt nëse bashkia e tyre kishte faqe interneti dhe vetëm 3.3% thanë se bashkia e tyre nuk ka faqe funksionale interneti.

Figura 52. A ka Bashkia juaj një faqe interneti? (2019)




Baza N = 1638

Kur i krahasojmë sipas ndarjeve demografike, të dhënat nuk evidentojnë dallime të konsiderueshme sipas grupeve gjinore apo nivelit të të ardhurave. Dallime thelbësore u regjistruan për moshën. Nga ana tjetër, nga të anketuarit e moshës 18-45 vjeç, shumica ishin në dijeni të faqes ueb të bashkisë së tyre (60%), ndërsa vetëm 17.1% e të anketuarve mbi 65 vjeç menduan se bashkia e tyre ka një faqe ueb. Të anketuarit me arsim universitar kanë më shumë të ngjarë të jenë në dijeni që bashkia e tyre të ketë faqe interneti (72.1%), ndërsa të anketuarit me diplomë të shkollës së mesme (51.3%) ose ata që kanë përfunduar deri arsimin e mesëm (33.5%), ishin më pak në dijeni për prezencën e bashkive të tyre në internet. Për më tepër, të anketuarit e punësuar në sektorin publik (74.6%) ishin më të informuar për ekzistencën e faqes së internetit të bashkisë së tyre në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat (56.3%). Të anketuarit nga zonat urbane raportuan më rregullisht se bashkia e tyre ka një faqe interneti (57.6%) sesa të anketuarit që jetojnë në zona rurale (45.7%).

Po të krahasojmë rezultatet e këtij viti me ato të viteve të kaluara, ndërgjegjësimi për faqen ueb të bashkive të tyre është rritur ndjeshëm. Në vitin 2015, 43% e të anketuarve ishin në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti. Pasi përqindja e anketuarit që ishin në dijeni

se bashkia e tyre ka një faqe interneti është ulur për tre vite me radhë, nga 43% në 2015 në 38% në 2018, sondazhi i opinionit publik i vitit 2019 tregon se, për herë të parë, më shumë se gjysma e të anketuarve ishin në dijeni se bashkia kishte faqe interneti.

Figura 53: A e dinit se bashkia juaj ka faqe interneti? (2015–2019)




Baza: 2015 (N = 1565); 2016 (N = 1618); 2017 (N = 1640); 2018 (N = 1638); 2019 (N = 2493)

**Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë*

Gjithsesi, mes të anketuarve që thanë se bashkia e tyre ka një faqe ueb funksionale, vetëm 35.7% deklaruan se e kanë vizituar këtë faqe gjatë vitit 2019. Asnjë dallim i konsiderueshëm nuk u evidentua sipas karakteristikave socio-demografike siç janë gjinia apo niveli i të ardhurave. Të anketuarit me arsim universitar kanë më shumë të ngjarë të kenë përdorur faqen e internetit të bashkive të tyre (43.4%) në krahasim me të anketuarit me diplomë të shkollës së mesme (29.6%) ose të anketuarit që kishin përfunduar nivel arsimor deri në 9-vjeçar (32.6%). Të anketuarit në marrëdhënie pune (40.6%) kanë më shumë të ngjarë të përdorin faqen e internetit të bashkisë së tyre sesa të anketuarit e papunë (29.6%). Të anketuarit që punojnë në sektorin publik kishin shumë më shumë gjasa të përdorin faqen e internetit (58%) sesa të anketuarit që punojnë në sektorin privat (33%). Të anketuarit e

moshës mbi 65 vjeç ishin më pak të predispozuarit nga të gjitha grupet demografike për të vizituar faqen e internetit të bashkisë së tyre (14%).

Figura 54: Përqindja e të anketuarve që kanë përdorur faqen e internetit të bashkisë (2019)



Baza: N = 1556

Cilësia dhe arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

Shqiptarët që kishin përdorur faqen e internetit të bashkisë së tyre në vitin 2019 në përgjithësi e kishin vizituar faqen për të marrë informacione për programe apo aktivitete në vendbanimin e tyre apo për të marrë informacione mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato. Në tre vitet e fundit, pjesa më e madhe e shqiptarëve e vlerësonin faqen e bashkisë së tyre si të saktë, të përditësuar vazhdimisht dhe të pasur me informacione.

Gjatë vitit 2019, të anketuarit e përdorën faqen e bashkisë së tyre për të marrë informacione për programe apo aktivitete në qytetin e tyre (11.9%) apo për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen (9.5%). Një numër më i vogël të anketuarish thanë se e kishin përdorur faqen e internetit të bashkisë së tyre për të ndjekur vendimet e këshillit bashkiak (4.5%) apo për të dërguar ankesa, komente te një drejtori / staf i bashkisë (2.2%). Nuk u vunë re dallime mes grupeve demografike në përdorimin e faqes së internetit të bashkive.


Tabela 27: arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë (2019)

	Përqindja e të anketuarve
Kontrolloj programet / aktivitetet në qytetin tim	11.9% (N = 297)
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	4.5% (N = 113)
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak	2.2% (N = 54)
Për të marrë informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	9.5% (N = 238)
Tjetër*:	0.6% (N = 16)

*Tjetër: p.sh., mësoj për projektet në zbatim në bashkinë time, aplikoj për një vend pune.

Shumica e të anketuarve që përdorën faqen e internetit të bashkisë së tyre në vitin 2019 panë që informacioni dhe shërbimet e ofruara ishin të sakta (81%), të plota/të pasura (62%) dhe të përditësuara vazhdimisht (62%). Edhe pse shifrat tregojnë në përgjithësi nivel kënaqësie me cilësinë e faqeve të internetit të bashkisë, përqindja e të anketuarve që i vlerësuan faqet e internetit si të sakta, të pasura me informacion dhe të përditësuara vazhdimisht është ulur në vitin 2019 në krahasim me vitet e kaluara. Në vitin 2017, të anketuarit e vlerësuan faqen e internetit të bashkisë së tyre veçanërisht pozitive: 91% e anketuarve thanë që faqja e internetit e bashkisë së tyre ishte e saktë, 79% se ishte e plotë / e pasur me informacione, dhe 72% se përditësohej vazhdimisht. Që atëherë, përqindja e të anketuarve që e vlerësojnë faqen e internetit të bashkisë si “të saktë” ose që “përditësohet vazhdimisht”, ranë që të dyja me 10 p.p., ndërsa përqindja e të anketuarve që e perceptuan faqen e internetit të bashkisë si të pasur me informacione u ul me 17 p.p.

Figura 55: Cilësia e informacionit në faqen e internetit të bashkisë (2016–2019)



Baza: 2016 (N = 266); 2017 (N = 205); 2018 (N = 205); 2019 (N = 537).


*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

E-qeverisja në Shqipëri

71.2% e popullsisë në Shqipëri thanë se ishin në dijeni se shërbimet elektronike në vend ofroreshin nëpërmjet portalit e-Albania. Megjithatë, ende evidentohet mungesë ndërgjegjësimi mes shqiptarëve të moshuar, veçanërisht atyre mbi 65 vjeç. Pjesa më e madhe e njerëzve që kanë përdorur portalin e-Albania e konsideruan atë si funksional dhe të lehtë për t'u përdorur. 60% e të anketuarve thanë se platforma ofron mundësi të mjaftueshme që qytetarët të shprehin komentet dhe/ose sugjerimet e tyre.

Ndërkohë që portali e-Albania po konsolidon pozicionin e tij si instrument i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve elektronike të qeverisë, shqiptarët janë bërë përherë e më të informuar për ekzistencën e platformës dhe funksionimin e saj. Pyetjes “A jeni në dijeni nëse qeveria (administrata) ofron shërbime elektronike përmes portalit e-Albania?” 71.2% e të anketuarve u përgjigjën ‘po’, përkundër 28.8% të të anketuarve që nuk kishin dijeni për ekzistencën e platformës. Krahësuar me vitin e kaluar, ka pasur një rritje të ndërgjegjësimit për platformën e-Albania. Në 2018, vetëm 54% e të anketuarve ishin në dijeni për ekzistencën e portalit e-Albania.

Figura 56: Dijenia për portalin e-Albania (2019)



Baza: $N = 2468$

Ashtu siç ndodh shpesh me mediat e reja, ndërgjegjësimi dhe përdorimi i platformës bie me rritjen e moshës së të anketuarit. Si pasojë, përgjigjet pozitive për pyetjen “A jeni në dijeni nëse qeveria (administrata) ofron shërbime elektronike përmes portalit e-Albania?”

u dhanë nga 84.5% e individëve të moshës 18-25 vjeç, por vetëm 36.8% e të anketuarve mbi 65 vjeç. Për më tepër, të anketuarit më arsim universitar (85.4%) raportuan më shpesh se ishin në dijeni për portalin e-Albania sesa të anketuarit që kishin nivelin arsimor deri në 9-vjeçar³⁹ (51%).

Gjetjet nga fokus grupet e tregojnë se arsyeja kryesore për ndryshimet në nivelin e ndërgjegjësimit në lidhje me e-Albania sipas grupeve demografike ishte ajo e aksesit në internet dhe aftësisë për të përdorur teknologjinë e informacionit dhe komunikimit. Të dy fokus grupet e moshës “nën 30 vjeç” dhe “mbi 55 vjeç” treguan se të rinjtë kanë akses më të mirë në internet dhe në platformat e tjera TIK dhe janë më të aftë t’i përdorin këto teknologji sesa qytetarët e moshuar. Për më tepër, disa pjesëmarrës të fokus grupeve me studentë përmendën se ata kanë studiuar në lidhje me qeverisjen elektronike dhe anti-korrupsionin dhe e kanë përdorur portalin e-Albania si rast studimor. Për më tepër, pjesëmarrësit në fokus grupin moshës “mbi 55 vjeç” që kishin përdorur portalin e-Albania raportuan një përvojë negative për shkak të mospërputhjeve në të dhënat e regjistruara, siç janë ndryshimet në emrin e familjes ose datën e lindjes. Kështu, këto çështje duhej të zgjidheshin nga institucioni përkatës, gjë që merrte shumë kohë. Në fokus grupin e të anketuarve “Pa të ardhura ose me të ardhura nën 24,000 lekë”, pjesëmarrësit treguan se ishin shumë pak të informuar për portalin e-Albania. Ata pretenduan se ishin mësuar me një lloj të caktuar shërbimesh dhe preferuan kontaktin personal me zyrtarët publikë për të kuptuar më mirë procedurat. Të tjerët vunë në dukje kufizimet që kishin për aksesin në teknologjinë e informacionit dhe në internet, si dhe njohuri shumë të kufizuara për t’i përdorur ato.


Nga të anketuarit që ishin në dijeni për portalin online e-Albania, 53.1% kishin marrë shërbime elektronike nga platforma gjatë vitit 2019. Të anketuarit e rinj në moshë kishin më shumë gjasa të kishin marrë shërbime elektronike nga portali e-Albania në krahasim me të anketuarit e moshuar. Mbi 61% e të anketuarve të moshës 18–35 kishin marrë shërbime me anë të portalit, ndërkohë që vetëm 14.1% e të anketuarve mbi 65 vjeç kishin marrë një shërbim nëpërmjet portalit.

Nga krahasimi sipas nivelit arsimor, të anketuarit me arsim universitar (67.7%) kishin më shumë gjasa të kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania sesa të anketuarit me arsim të mesëm (46.9%) apo me arsim deri 9-vjeçar (33.5%). Po ashtu, të anketuarit në marrëdhënie pune (59.5%) kishin marrë më shumë shërbime elektronike sesa të anketuarit e papunë (47.1%), dhe nga të anketuarit që janë në marrëdhënie pune, ata që punojnë në sektorin publik kishin marrë më shpesh shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (69.9%) se të anketuarit që punojnë në sektorin privat (54.3%). Për më

39 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

tepër, të anketuarit që banojnë në zonat urbane raportuan më shpesh (55.8%) se kishin përdorur shërbimet elektronike në krahasim me të anketuarit që jetojnë në zonat rurale (46%). Nuk u evidentuan dallime të mëdha sipas karakteristikave social-demografike të gjinisë apo nivelit të të ardhurave.


Figura 57: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik gjatë vitit 2019 nëpërmjet e-Albania? (2019)



Baza: $N = 1758$

Të anketuarit që kishin marrë shërbime elektronike gjatë vitit 2019 ishin në përgjithësi pozitivë për sa i përket cilësisë së portalit e-Albania. Shumica dërrmuese prej 94.6% që e kishin përdorur këtë portal për të marrë shërbime thanë se shërbimet elektronike ishin funksionale, 80.1% i konsideronin këto shërbime si të lehta për t'u përdorur, dhe 60% thanë se shërbimet elektronike u dhanë atyre mundësinë për të bërë komente apo sugjerime. Të anketuarit mbi 55 vjeç, nga ana tjetër, nuk mendonin se portali u jepte mundësi të mjaftueshme për të bërë komente apo sugjerime: të anketuarit 56–65 vjeç (43.6%) apo mbi 65 vjeç (55.6%) raportuan më pak se portali e-Albania u jep qytetarëve mundësinë për të bërë komente dhe/ose sugjerime. Së fundi, në numër më i vogël të anketuarish me arsim deri 9-vjeçar (50.6%) apo me diplomë të shkollës së mesme (54.3%) thanë se portali e-Albania ka mekanizma të mjaftueshëm për thithjen e sugjerimeve krahasuar me të anketuarit me arsim universitar (65.7%). Nuk u evidentuan dallime të konsiderueshme mes grupeve të tjera social-demografike.

Figura 58: Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (2019)



Baza: $N_1 = 914$; $N_2 = 919$; $N_3 = 897$

4.9 Gjinia dhe përfshirja sociale

Shoqëria shqiptare karakterizohet nga një ndarje tradicionale e roleve gjinore, ku gratë shpesh janë shtëpiake dhe burrat janë siguruesit e bukës. Sipas një studimi të kryer në vitin 2010, gratë shpenzojnë mesatarisht 5 orë e 43 minuta në ditë me punë të papaguar në shtëpi, ndërsa burrat kalojnë mesatarisht 2 orë e 6 minuta. Ndërkohë, burrat kanë më shumë të ngjarë të mendojnë se ka ndarje të barabartë të punëve të shtëpisë, ndërsa gratë në përgjithësi tregojnë se nuk marrin mbështetje nga burrat.⁴⁰ Veçanërisht në familjet me fëmijë ose në ato familje që ndodhen në zonat rurale, gratë bëjnë pjesën më të madhe të detyrave për rritjen e fëmijëve dhe për kujdesin për familjen dhe punë shtëpie si gatimi, pastrimi, larja dhe hekurosja e rrobave (Dauti dhe Zhllima, 2016).⁴¹ Në zonat urbane dhe mes çifteve që kanë ardhur nga emigracioni, kjo ndarje e detyrave në familje po ndryshon drejt një ndarje më të barabartë të punëve.

Gjithsesi, gratë po ndjekin gjithnjë e më shumë studimet pasuniversitare. Gjatë pesë viteve të fundit, 6 nga 10 studentë universiteti ishin femra dhe në universitete shqiptare po diplomohen një numër përherë e më i madh femrash se kurrë më parë (INSTAT, 2019).⁴² Po ashtu, është rritur edhe më shumë pjesëmarrja e grave në proceset e vendimmarrjes në krahasim me vitet 1990-2000. Shumë ndryshime ligjore hapën rrugën për rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Shqipërisë (pjesëmarrje që në vitin 2018 ishte 29%), më shumë femra në postin e kryetarit të bashkisë (15% pas zgjedhjeve 2015), dhe për rritjen e numrit të këshilltareve femra në këshillat bashkiakë (36.9% në 2017).⁴³ Në vitin 2018, gratë zinin 57% të posteve ministrore të qeverisë qendrore,⁴⁴ përqindja më e lartë e anëtarëve femra të një kabineti në rajon. Megjithatë, ky progres i rëndësishëm është i nevojshëm edhe në sektorë të tjerë, përfshirë këtu rangje më të larta në polici, ku gratë mbeten ende të nënpërfaqësuar. Në këtë pjesë të sondazhit hulumtohet perceptimi i shqiptarëve në lidhje me barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale. Në krahasim me vitet e mëparshme, u hoq një pyetje në këtë pjesë për numrin e grave në këshillat bashkiakë, sepse qytetarët në përgjithësi nuk kanë dijeni për përbërjen e këshillit bashkiak dhe anëtarëve të këtij këshilli pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019.

.....

40 Dauti, M. dhe Zhllima, E. (2016). Perceptimi publik dhe qëndrimet për barazinë gjinore në Shqipëri. Tiranë: UNDP. http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_eng.pdf

41 *Po aty*.

42 Instituti i Statistikave INSTAT. (2019). Gratë dhe burrat në Shqipëri 2019. f. 55–57. Marrë nga adresa: http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf

43 *Po aty*. f. 102–103.

44 *Po aty*. f. 128.

Perceptimi për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare


Një shumicë e vogël e popullsisë rezidente shqiptare mendojnë se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave. Burrat kishin më shumë gjasa të ishin dakord për ekzistencën e barazisë gjinore në krahasim me gratë. Shqiptarët e moshës 18-25 vjeç ishin më pak dakord se ekziston barazi gjinore, ndërsa shqiptarët e moshës mbi 65 vjeç kishin më shumë gjasa të shpreheshin se ekziston barazi gjinore në shoqërinë shqiptare. Shqiptarët e punësuar në sektorin publik kanë më shumë të ngjarë të mendojnë se ekziston barazi gjinore në krahasim me të anketuarit e punësuar në sektorin privat.

Duke qenë se pjesa e parë e këtij seksioni “Gjinia dhe përfshirja sociale” përbëhet nga tre pohime për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare, aksesit tek shërbimet publike dhe ofrimi i shërbimeve sipas gjinisë, këto pohime synojnë të nxjerrin në pah qëndrimet e shqiptarëve në lidhje me barazinë mes burrave dhe grave.

“Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave.”

Në lidhje me pohimin e parë, 54.3% e të anketuarve ishin dakord ose shumë dakord me pohimin. Të anketuarat femra ishin më pak të prirura (48.5%) të mendonin se ka barazi gjinore në Shqipëri në krahasim me të anketuarit meshkuj (60.4%). Kjo gjetje sugjeron se gratë janë më pak të bindura për ekzistencën e barazisë gjinore mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare në krahasim me burrat.

Figura 59: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2019)




Baza: N = 2487

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, të dhënat nxjerrin në pah dallime mes grupmoshave edhe pse nuk ka një trend të evidentueshme për moshën. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç ishin më pak të predispozuar për të rënë dakord me pohimin (46%), ndërsa të anketuarit e moshës 35-45 vjeç (60.2%) apo mbi 65 vjeç ishin më të prirur të binin dakord me pohimin se grupmoshat e tjera. Për më tepër, të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më të gatshëm (61.7%) (të binin dakord me pohimin sesa të anketuarit e punësuar në sektorin privat (53.6%). Ndryshe nga vitet e kaluara, ku të anketuarit nga zonat rurale ishin më të prirur të mendonin se ka barazi gjinore në shoqërinë shqiptare, këtë vit të anketuarit që banojnë në zonat urbane ishin më të predispozuar të binin dakord me pohimin (56.5%) sesa të anketuarit në zonat rurale (49.3%).

Po të krahasojmë rezultatet e këtij viti me ato të viteve të mëparshme, asnjë trend i qartë nuk vihet re në lidhje me perceptimin për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare, përveçse faktit që çdo vit një numër më i madh të anketuarish meshkuj mendojnë se ka barazi gjinore në shoqërinë shqiptare në krahasim me femrat e anketuara. Në vitin 2017, viti i pikëve më të larta për barazinë gjinore nga sondazhi i opinionit publik, 71% e të anketuarve meshkuj dhe 60% e të anketuarve femra ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”. Në vitin 2016, nga ana tjetër, vetëm 39% e femrave të anketuara dhe 55% e të anketuarve meshkuj menduan se ka barazi mes gjinive në shoqërinë shqiptare, një proporcion shumë më i ulët.

Figura 60: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare (2016–2019)



Baza: 2016 (N = 1636); 2017 (N = 1623); 2018 (N = 1636); 2019 (N = 2487)

*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë


Aksesi te shërbimet publike sipas gjinive

Shumica e shqiptarëve raportuan se gratë dhe burrat kanë të njëjtin akses te shërbimet publike. Gratë ishin paksa më pak të bindura për të rëndë dakord se ka barazi në aksesin te shërbimet publike në krahasim me burrat. Të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç, ata me nivel arsimor universitar, të anketuarit që punojnë në sektorin publik apo që banojnë në zonat urbane ishin më të prirur të besonin se gratë dhe burrat kanë të njëjtin akses te shërbimet publike në krahasim me grupet e tjera demografike.

Pohimi 2: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike.”

Për pohimi “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”, 68.8% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që vetëm 4.7% e të anketuarve nuk ishin aspak dakord. Të anketuarit meshkuj ishin më të prirur të raportonin se të dy gjinitë kanë të njëjtin akses te shërbimet publike. 71.1% e të anketuarve meshkuj ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, krahasuar me 66.4% e grave.

Figura 61: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2019)




Baza: N = 2487

Kur bëjmë krahasime sipas grupeve demografike, të dhënat tregojnë se të anketuarit me arsim universitar (70.3%) apo me arsim të mesëm (70.6%) ishin më të prirur të binin dakord me pohimin: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”

sesa të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar⁴⁵ (62.7%). Për sa i përket statusit të punësimit, të anketuarit në marrëdhënie pune (70.5%) dhe veçanërisht ata të punësuar në sektorin publik (75.6%) kishin më shumë gjasa të ishin dakord me pohimin sesa të anketuarit e papunë (64.1%) apo të anketuarit që punojnë në sektorin privat. (69.5%). Së fundi, të anketuarit që banojnë në zonat urbane ishin më shumë dakord me pohimin (70.4%) sesa të anketuarit që jetojnë në zonat rurale (65.1%).

Në vitin 2016, përqindja e të anketuarve që ishin dakord me pohimin “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike” ishte më e ulët se në vitet 2017, 2018 dhe 2019. Në 2016, vetëm 55% të anketuarve femra dhe 63% e të anketuarve meshkuj thanë se gratë dhe burrat kanë të njëjtin akses te shërbimet publike. Në vitin 2017, kjo përqindje rritet në 71% për fermat dhe 79% për të anketuarit meshkuj. Që prej asaj periudhe, përqindja e të anketuarve që janë dakord me pohimin ka rënë pak, por gjithsesi mbetet më e lartë se ajo e vitit 2016. Po ashtu, çdo vit një numër më i madh meshkujsh sesa femrash të anketuar në sondazhin e opinionit publik mendojnë se “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”.

Figura 62: Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike (2016–2019)



Baza: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1619); 2018 (N = 1624); 2019 (N = 2487)

*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

• • • • •

45 Grupi ‘me nivel arsimor deri 9-vjeçar’ përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.


Ofrimi i shërbimeve publike sipas gjinive

Shumica e shqiptarëve raportuan se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave. Gratë ishin paksa më pak të gatshme të binin dakord me pohimin sesa burrat. Të anketuarit e moshës mbi 35 vjeç, ata që janë në marrëdhënie pune dhe të anketuarit që punojnë në sektorin publik ishin më të predispozuar të thonin se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.

“Pohimi 3: “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.”

Të anketuarve iu kërkua të jepnin opinionin e tyre për pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave”. 67.5% e të anketuarve ishin dakord ose plotësisht dakord me pohimin, ndërkohë që 4.7% nuk ishin aspak dakord. Të anketuarit meshkuj ishin më të gatshëm (70.8%) të ishin dakord me pohimin në krahasim me femrat e anketuara (64.3%).

Figura 63: Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2019)




Baza: N = 2487

Sipas ndarjeve demografike, të dhënat tregojnë dallime sipas moshës, statusit të punësimit dhe sektorit të punësimit. Të anketuarit e vjetër në moshë prireshin më shumë të binin dakord me pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave” në krahasim me të anketuarit e rinj në moshë. Nga të anketuarit

e moshës 65 vjeç, 77.7% ishin dakord me pohimin, nga të anketuarit 46–65 vjeç 70% ishin dakord me këtë pohim, dhe nga të anketuarit 36–45 vjeç 71.2% ishin dakord. Nga të anketuarit në moshë të re, 59.2% e kategorisë moshore 18–25 ishin dakord së bashku me 65.3% e të anketuarve që ishin 26–35 vjeç. Për sa i përket statusit të punësimit, të anketuarit në marrëdhënie pune ishin dakord më shumë (69.1%) me pohimin “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave” në krahasim me të anketuarit e papunë (62.9%). Së fundi, të anketuarit e punësuar në sektorin publik (75.4%) ishin dakord më shumë me këtë pohim sesa të anketuarit e punësuar në sektorin privat (67.6%).

Njësoj si me pohimet 1 dhe 2, të anketuarit në mënyrë të konsiderueshme ishin më pozitivë për shërbimin e njësojtë të nëpunësve publikë për të dy gjinitë në vitin 2017 sesa në vitin 2016. Në 2016, të anketuarit kishin mendim negativ ndaj pohimit, ku vetëm 56% e të anketuarve femra dhe 66% e të anketuarve meshkuj thanë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave. Që nga viti 2017, 69% e të anketuarve femra dhe 80% e të anketuarve meshkuj ishin dakord me pohimin, përqindja e të anketuarve që mendojnë se në Shqipëri nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave. Për sa i përket dy pohimeve të para, çdo vit një numër më i madh të anketuarish meshkuj sesa femra mendojnë se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.

Figura 64: Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave (2016–2019)



Baza: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1614); 2018 (N = 1636); 2019 (N = 2487)

*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

Diskriminimi nga institucionet apo nëpunësit publikë

Rreth 1 në 8 shqiptarë raportuan se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik në 2019 për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për diçka tjetër. Nga popullsia shqiptare që kishte vuajtur diskriminimin në 2019, shumica ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës (35.6%) apo gjinisë së tyre (27.1%).

Pas vlerësimit të tre pohimeve për barazinë gjinore, në këtë pjesë vazhdohet me disa pyetje për përfshirjen sociale dhe qeverisjen gjithëpërfshirëse. Të anketuarit u pyetën nëse ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik në 2019 për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar apo për diçka tjetër. Shumica e të anketuarve (86.8%) thanë se nuk ishin trajtuar ndryshe nga asnjë institucion apo nëpunës publik. Nga të anketuarit që thanë se ishin trajtuar ndryshe, ata deklaruan se ishin diskriminuar për shkak të moshës (4.5% ose N = 113) apo gjinisë (3.4% ose N = 86).

Tabela 28: Diskriminim nga institucioni (2019)

Jam trajtuar ndryshe për shkak të:	12.6%	N = 317
Gjinisë	3.4%	N = 86
Moshës	4.5%	N = 113
Përkatësisë etnike	2%	N = 50
Orientimit seksual	0.2%	N = 5
Aftësisë së kufizuar	0.9%	N = 22
Tjetër*	1.6%	N = 41
Nuk jam trajtuar ndryshe	86.8%	N = 2169

Baza: N = 2486

*Tjetër: gjendja ekonomike, varfëria, përkatësia politike, apo paraqitja fizike.

Në varësi të karakteristikave (gjinia, mosha, përkatësia etnike, orientimi seksual, apo aftësia e kufizuar) për shkak të të cilave qytetarët ishin trajtuar ndryshe, kishte dallime në raportimin mes grupeve të ndryshme demografike në lidhje me diskriminimin në 2019. Për diskriminimin për shkak të gjinisë, të anketuarit femra raportuan më shpesh (5.2% ose N = 66) se ishin diskriminuar përkundër të anketuarve meshkuj (1.6% ose N = 20). Për më tepër, të anketuarit në kategorinë moshore 18–25 vjeç (4.8% ose N = 23), të kategorisë moshore 26–35 vjeç (4.7% ose N = 31), dhe të anketuarit me arsim universitar (5% ose N = 41) raportuan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë së tyre.

Në lidhje me diskriminimin për shkak të moshës, të anketuarit e grupmoshës 18-25 vjeç (8.4% ose N = 40) dhe të anketuarit mbi 65 vjeç (9.7% ose N = 17) raportuan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të moshës së tyre. Të anketuarit që kanë aftësi të kufizuara (9.3% ose N = 15) kishin, po ashtu, më shumë të ngjarë të raportonin se ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës në krahasim me të anketuarit që nuk kanë aftësi të kufizuara (4.2% ose N = 96).

Për sa i përket diskriminimit për shkak të përkatësisë etnike, të anketuarit kishin më shumë të ngjarë të raportonin se ishin diskriminuar nëse i përkisnin një grupi minoritar. 26.3% (N = 40) e të anketuarve që i përkisnin një grupi minoritar mendonin se trajtoheshin ndryshe për shkak të përkatësisë etnike, krahasuar me 0.3% (N = 8) të të anketuarve që nuk i përkisnin asnjë grupi minoritar. Së fundi, në lidhje me diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, nga të gjithë vetëm dy të anketuar me aftësi të kufizuara thanë se në vitin 2019 ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në fokus grupin me individë “me arsim universitar apo pasuniversitar”, pjesëmarrësit diskutuan rreth rasteve të diskriminimit në ofrimin e shërbimeve publike. Sipas pjesëmarrësve me arsim të lartë, grupe të caktuara, siç është komuniteti rom apo grupet e tjera të marginalizuara, diskriminoheshin në ofrimin e shërbimeve publike. Pjesëmarrësit që punojnë në fushën e përfshirjes sociale me komunitetet e marginalizuara treguan se komuniteti rom dhe grupet e tjera të marginalizuara kanë akses të kufizuar te shërbimet publike.

Gratë në procesin e vendimmarrjes

Një shumicë e konsiderueshme e të anketuarve shqiptarë mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik. Megjithatë, përqindja e shqiptarëve që mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik po rritet me ritëm të ngadaltë. Gratë, të anketuarit e moshës nën 45 vjeç dhe shqiptarët me arsim universitar ishin më të gatshëm të besonin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.

Pas ndryshimeve në Kodin Zgjedhor në vitin 2008, numri i grave që marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare dhe bëhen pjesë e strukturave të qeverisjes vendore është rritur. Ndërkohë që në vitin 2008 vetëm 7% e deputetëve ishin femra, në vitin 2018 përqindja e deputeteve femra është rritur në 29%.⁴⁶ Po ashtu, në vitin 2015, ndryshimet në Kodin Zgjedhor u bënë për të rritur pjesëmarrjen e grave edhe në qeverisjen vendore. Atë vit,


• • • • •

46 Instituti i Statistikave INSTAT. (2019), Gratë dhe burrat në Shqipëri 2019, fq. 102–103. Marrë nga adresa http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf

10% e kandidatëve që garonin për kryetar bashkie ishin gra dhe 49% të kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiakë ishin gra.⁴⁷

Të anketuarit u pyetën se sa të afta i perceptojnë gratë për të mbajtur poste publike. 76.5% e të anketuarve u përgjigjën se ata mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat janë për të mbajtur poste publike, ndërsa 13.5% thanë që gratë nuk janë aq të afta për të mbajtur poste publike dhe 9.9% e të anketuarve nuk ishin të sigurt. Në krahasim me vitet e kaluara, ka pasur një rritje të vogël por graduale në përqindjen e të anketuarve që nuk mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike. Në vitin 2016, vetëm 4% iu përgjigjën 'Jo' kësaj pyetjeje, ndërsa në vitin 2017 përqindja u rrit në 9%, në 2018 shkoi në 10%, dhe në 2019 arriti nivelin e 13%. Kështu, përqindja e të anketuarve që mendojnë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike është në rënie.

Figura 65: Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik (2016-2019)



Baza: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1628); 2018 (N = 1632); 2019 (N = 2486)


*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

• • • • •

47 Po aty.

Kur shohim dallimet te përgjigjet e të anketuarve meshkuj dhe femra, shohim se të anketuarit femra ishin më të prirur të raportonin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike në krahasim me të anketuarit meshkuj. Plot 80.8% e të anketuarve femra thanë se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike, krahasuar me 72.2% të meshkujve që kanë të njëjtin mendim.

Figura 66: Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike (2019)



Baza: $N = 2486$

Për më tepër, të anketuarit nën 45 vjeç ose të anketuarit me nivel arsimor universitar kishin më shumë gjasa të deklarorin se besojnë që gratë dhe burrat janë njësoj të aftë për të mbajtur poste publike. Të anketuarit e moshës 18-25 vjeç (79,4%), 26-35 vjeç (80,8%) dhe 36-45 vjeç (78,8%) raportuan më shpesh se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur poste publike sesa të anketuarit në kategoritë e moshave 46-55 vjeç, 56-65 vjeç, dhe mbi 65 vjeç (respektivisht 70,3%, 71,8% dhe 69,1%). Në mënyrë të ngjashme, të anketuarit me arsim universitar (82,8%) ose me diplomë të shkollës së mesme (76,8%) kishin më shumë të ngjarë të raportonin që gratë dhe burrat janë njësoj të aftë të mbajnë çdo post publik sesa të anketuarit me arsim deri 9-vjeçar⁴⁸ (66,9%). Nuk u vunë re diferenca të konsiderueshme të të anketuarit sipas statusit të punësimit apo vendbanimit (urban përkundër rural).

• • • • •


⁴⁸ Grupi 'me nivel arsimor deri 9-vjeçar' përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim 4 vjeçar, dhe ata që kanë përfunduar arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar.

Ndikimi i grave në qeverisjen vendore

Gjashtë në 10 shqiptarë mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. gratë, të anketuarit e moshës nën 45 vjeç, ata me arsim universitar, apo shqiptarët që punojnë në sektorin publik ishin më të predispozuar për të raportuar se gratë do të kenë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore në krahasim me grupet e tjera demografike. Përqindja e popullatës rezidente shqiptare që mendojnë se rritja e përfaqësimit të grave nuk do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore po rritet shumë pak.

Së fundi, të anketuarit u pyetën nëse mendojnë se rritja e përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë një ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 60.9% e të anketuarve thanë se mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të jenë pozitive në qeverisjen vendore, ndërsa 18.6% thanë se kjo rritje nuk do të ketë ndikim pozitiv dhe 20.5% e të anketuarve nuk ishin të sigurt. Në krahasim me tre vitet e mëparshme, një pjesë më e vogël e të anketuarve mendojnë se rritja e pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiakë do të ndikonte pozitivisht në qeverisjen vendore.

Figura 67: Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë (2016–2019)



Baza: 2016 (N = 1635); 2017 (N = 1631); 2018 (N = 1633); 2019 (N = 2486)

*Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit ka ndryshuar krahasuar me vitet e mëparshme. Për më shumë informacion, shihni kapitullin e metodologjisë

Të anketuarit femra (68.9%) ishin më të predispozuara se të anketuarit meshkuj (52.7%) për t'u përgjigjur se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të kishte ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Po ashtu, më shumë se 68% e të anketuarve nën 45 vjeç raportuan se rritja e përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë do të kishte ndikim pozitiv në qeverisjen vendore, krahasuar me 54.7% të të anketuarve 46–55 vjeç, 57.4% të të anketuarve të grupmoshës 56–65 vjeç dhe 58.3% të të anketuarve të moshës mbi 65 vjeç. Për më tepër, një përqindje më e madhe e të anketuarve me arsim universitar (65.9%) raportuan se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të kishte ndikim pozitiv në qeverisjen vendore, në krahasim me të anketuarit me arsim të mesëm (59.2%) apo me arsim deri 9-vjeçar (57.2%). Së fundi, të anketuarit që punojnë në sektorin publik prireshin më shumë (70.1%) të raportonin se gratë kanë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore në krahasim me të anketuarit që punojnë në sektorin privat (60.5%). Përgjigjet nuk ndryshonin shumë sipas vendbanimit rural apo urban të të anketuarve.

5. Bibliografia

- BIRN & Reporterët pa kufij. (2018). Monitorimi i Pronësisë Medias në Shqipëri. Gjendet në adresën: <http://albania.mom-rsf.org/>
- Dauti, M. dhe Zhllima, E. (2016), *Perceptimet dhe qëndrimet e publikut ndaj barazisë gjinore në Shqipëri*. Tirana: UNDP. http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_eng.pdf
- Diagne, M. F., Ringold, D., dhe Zaidi, S. (2012), *Governance and Public Service Delivery in Europe and Central Asia*. p. 2. Marrë nga adresa: <http://documents.worldbank.org/curated/en/685021468015003609/pdf/WPS5994.pdf>
- E-Albania (n.d.), Rreth portalit. Marrë nga adresa: <https://e-albania.al/Pages/eAlbania.aspx> [aksesuar për herë të fundit në datën 22.01.2019]
- E-Albania. (n.d.), Lajme, Marrë nga adresa: <https://e-albania.al/Pages/News.aspx> [aksesuar për herë të fundit në datën 22.01.2019]
- Eurofound (2018), *Societal change and trust in institutions*, Publications Office of the European Union, Luxembourg, gjendet në adresën <https://www.eurofound.europa.eu/publications/report/2018/societal-change-and-trust-in-institutions> [aksesuar për herë të fundit në datën 03/02/2020].
- Hosking, G. (2017), 'Trust in the trustworthy: a key to social cohesion?' in Prange-Gstöhl H. (ed.) *Trust at risk? Implications for EU policies and institutions*, Publications Office of the European Union, Luxembourg, fq. 8–16
- Instituti i Statistikave INSTAT (2019), *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2019*. Marrë nga adresa http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf
- Instituti i Statistikave INSTAT (Maj, 2014), *Klasifikimi i ri urban-rural i popullsisë shqiptare*. Marrë nga adresa: <http://www.instat.gov.al/en/themes/general-and-regional-statistics/cities-and-degree-of-urbanization/publication/2014/a-new-urban-rural-classification-of-albanian-population-may-2014/> [aksesuar për herë të fundit në datën 20.01.2019]
- Kombet e Bashkuara (2019), *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm*, gjendet në adresën <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/> [vizituar më 09.02.2020]
- Komisioni Evropian, (2019), 'Raporti për Shqipërinë 2019, gjendet në adresën <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf> [aksesuar për herë të fundit në datën 03/02/2020].

- Kossow, N. & Dykes, V. (2018), *Embracing Digitalisation: How to use ICT to strengthen Anti-Corruption*. Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. gjendet në adresën: https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng_ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf
- Levi, M. dhe Stoker, L. (2000), 'Political trust and trustworthiness', *Annual Review of Political Science*, 3(1), fq. 475–507.
- Moreira, P. (January 2019), *cituar në: How Corruption weakens Democracy*. Transparency International. Marrë nga adresa: https://www.transparency.org/news/feature/cpi_2018_global_analysis
- OECD (2013), 'Trust in government, policy effectiveness and the governance agenda', gjendet në adresën https://www.oecd-ilibrary.org/governance/government-at-a-glance-2013/trust-in-government-policy-effectiveness-and-the-governance-agenda_gov_glance-2013-6-en [aksesuar për herë të fundit në datën 03/02/2020].
- Transparency International. (n.d.), 'What Is Corruption?', Marrë nga adresa: <https://www.transparency.org/what-is-corruption> [aksesuar për herë të fundit në datën 16.01.2020]

6. Shtojca 1.

Karakteristikat e kampionit 2013–2019

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Gjinia							
Meshkuj	45%	49%	50%	43%	51%	52%	49%
Femra	55%	50%	50%	57%	49%	48%	51%
Grupmoshat							
18–25	14%	23%	22%	18%	19%	16%	19%
26–35	14%	22%	25%	23%	23%	23%	26%
36–45	14%	18%	16%	19%	19%	19%	20%
46–55	19%	18%	17%	18%	19%	20%	16%
56–65	20%	10%	11%	13%	11%	13%	12%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%	9%	7%
Vendbanimi							
Urban			81%	51%	50%	50%	70%
Rural			19%	49%	50%	50%	30%
Niveli arsimor							
Pa arsim + Mbaruar shkollën fillore - 4 vjeçare	1%	1%	3%	6%	5%	7%	4%
Mbaruar shkollën 8/9 - vjeçare	14%	15%	12%	19%	17%	23%	18%
Mbaruar shkollën e mesme	40%	41%	40%	50%	50%	46%	44%
Me diplomë universitare/ më lart	44%	42%	43%	24%	28%	24%	33%
Statusi i punësimit							
I/e punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%	54%
I/e papunë	20%	25%	28%	35%	34%	32%	25%

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%	7%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%	11%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%	3%
Sektori i punësimit							
Sektori publik				32%	29%	28%	25%
Sektori privat				64%	71%	69%	72%
Tjetër				4%		3%	3%
Të ardhurat e rregullta mujore individuale (Neto)							
Nuk kam të ardhura			34%	33%	37%	32%	29%
Deri në 24,000 lekë			21%	25%	24%	28%	25%
24,001–50,000 lekë			29%	28%	25%	28%	28%
50,001–70,000 lekë			6%	4%	5%	4%	7%
Mbi 70,001 lekë			2%	1%	2%	<1%	2%
A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?							
Po					9%	7%	6%
Greke					3.2%	2.7%	1.5%
Maqedonase					1.6%	1.1%	0.9%
Arumune					<0.1%	0.2%	0.2%
Rome					2.3%	2.4%	1.5%
Egjiptiane					0.9%	0.2%	0.9%
Malazeze					0%	0%	0.1%
Boshnjake					0.2%	<0.1%	0.2%
Serbe					0%	0%	<0.1%
Bullgare					<0.1%	0.1%	0.3%
Jo					90%	92%	93%
A jeni simpatizant i ndonjë partie politike?							
Po					40%	36%	35%
Partia Socialiste					15.5%	16.1%	12.3%

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Partia Demokratike					8.5%	9.2%	8.1%
Lëvizja Socialiste për Integrim					3.4%	1.2%	2.1%
Tjetër					0.7%	0.4%	0.3%
Jo					52%	58%	60%
A jeni anëtar i ndonjë partie politike?							
Po					16%	12%	13%
Partia Socialiste					6.9%	6.6%	4.6%
Partia Demokratike					2.6%	3%	2.9%
Lëvizja Socialiste për Integrim					2.2%	0.8%	0.9%
Tjetër					0.6%	<0.1%	0.2%
Jo					75%	81%	82%

Shënim: Nuk janë përfshirë refuzimet. Përqindjet mund të mos jenë shumatore e 100%.

